

PLANI I PËRGJITHSHËM (GJENERAL) URBANISTIK PRIZRENI 2003-2013

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1	Hyrje, Konteksti dhe Qëllimi	faqe K1	1-15	
KAPITULLI 2	Parashikimi i Zhvillimit Të Qëndrueshëm	faqe K2	1-15	
KAPITULLI 3	Zonimi Strategjik i Qytetit	faqe K3	1-25	
KAPITULLI 4	Modeli i Qytetit	faqe K4	1-15	
KAPITULLI 5	Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore	faqe K5	1-49	
KAPITULLI 6	Përbushja e Kërkesave Të Komunitetit	faqe K6	1-48	
KAPITULLI 7	Sigurimi i Vitalitetit Ekonomik	faqe K7	1-24	
KAPITULLI 8	Promovimi i Trafikut Të Integruar	faqe K8	1-15	
KAPITULLI 9	Promovimi i infrastrukturës së integruar komunale	faqe K9	1-	
KAPITULLI 10	Plani për Mbrojtjen e Mjedisit	faqe K10	1-12	
KAPITULLI 11	Arritja e Kualitetit	faqe K11	1-7	
KAPITULLI 12	Implementimi	faqe K12	1-21	
	Pasthënie	faqe Psth.	1-	
SHTOJCAT			shtojca	1-24
Shtojca 1	Kriteret për ndërtimin dhe rindërtimin/renovimin e objekteve në zonën e mbrojtur	sh	1-4	
Shtojca 2	Standardet E Pjeseve Te Hapura Publike	sh	5-7	
Shtojca 3	Standardet E Parkimit Publik	sh	8-17	
Shtojca 4	Kriteriumi për Madhësi dhe Intimitet të Kopshteve	sh	18-21	
Shtojca 5	Klasët E Destinimeve - Në Kuadër Të Planifikimit Të Qytetit	sh	22-24	

KAPITULLI 1		Hyrje, Konteksti Dhe Qëllimi	k₁ 1
I	Morfologjia E Strukturës Së Qytetit Të Vjetër		k₁ 2
II	Përgaditja E Planit Te Ri Për Qytetin E Prizrenit		k₁ 3
III	Konteksti I Orientimeve		k₁ 6
	– Konteksti Ndërkombëtar		k₁ 7
	– Konteksti Kosovar		k₁ 7
	– Konteksti Komunal		k₁ 8
	– Konteksti i Qytetit		k₁ 9
IV	Çka Synon Ky Plan		k₁ 10
V	Vizioni Për Prizrenin		k₁ 12
VI	Qëllimet Dhe Synimet E Këtij Plani		k₁ 14
VII	Vlerësimi i Qëndrueshmërisë		k₁ 15
KAPITULLI 2		Parashikimi i Zhvillimit Të Qëndrueshëm	k₂ 1
Orientimi ZhQ 1	Lokacionet e Qëndrueshme Për Zhvillim të Ri		k₁ 2
Orientimi ZhQ 2	Gjetja E Lokacionit në Mënyrë që të Redukohet Nevoja Për Udhëtim		k₁ 5
Orientimi ZhQ 3	Limitimi në Madhësinë e Lokacioneve të Reja për Zhvillimin Të Përzier		k₁ 7
Orientimi ZhQ 4	Intensifikimi (Dendësia) i Zhvillimeve		k₁ 7
Orientimi ZhQ 5	Promovimi i Lokacioneve me Destinim të Perzier		k₁ 10
Orientimi ZhQ 6	Ndarja e Ndërtimit dhe e Zhvillimit në Faza		k₁ 15
KAPITULLI 3		Zonimi Strategjik i Qytetit	k₃ 1
	Zonimi Urb-Territorial		k₃ 2
	Zonimi Administrativ		k₃ 3
	Zonimi Territorial - Historik		k₃ 3
3.a	Zonimi Urb-Territorial		k₃ 4
Orientimi ZS 1	Tërësia Qëndrore Orientuese dhe Tërësia Qarkore Orientuese		k₃ 6
Orientimi ZS 2	Sipërfaqet Orientuese Për Zhvillime Të Reja		k₃ 12
3.b	Zonimi Administrativ		k₃ 14
Orientimi ZS 3	Ridizajnimi i Zonave Administrative		k₃ 15
3.c	Zonat e Veçanta		k₃ 16
Orientimi ZS 4	Qendra E Vjetër E Qytetit		k₃ 16
Orientimi ZS 6	Propozimi Për Qendrën e Re Të Prizrenit		k₃ 17
Orientimi ZS 7	Korridorori I Qarkores Dhe Brezi I Gjellbër I Qytetit		k₃ 17

Orientimi ZS 8	Zona E Propozuar Për Kompleks Të Rekreimit	k3 19
Orientimi ZS 9	Zona E Propozuar Për Terminalin Kryesor	k3 20
Orientimi ZS 10	Keji i Lumit Lumbardh	k3 21
Orientimi ZS 11	Zonat e Propozuara Për Industri	k3 22
Orientimi ZS 12	Kompleksi i Spitalit	k3 24
Orientimi ZS 13	Varrezat	k3 25

KAPITULLI 4 Modeli i Qytetit K4 1

4.1	Pozita Gjeografike Dhe Karakteristikat Natyrore	k4 2
4.1.1	Karakteristikat Pedologjike Të Tokës	k4 2
4.1.2	Kushtet Klimatike	k4 3
4.1.3	Ujërat	k4 8
4.2	Demografia	k4 9
4.3	Modeli i Qytetit	k4 11
Orientimi MQ 1	Perimetri i Qytetit	k4 11
Orientimi MQ 2	Struktura Urbane	k4 11
Orientimi MQ 3	Rrugët, Rrugicat dhe Udhëkryqet e Sheshet	k4 12
Orientimi MQ 4	Zhvillimi i Ri Longitudinal i Qytetit	k4 13
Orientimi MQ 5	E Reja Në Të Vjetrën Brenda Bërthamës Së Qytetit	k4 13
Orientimi MQ 6	E Reja Pranë Së Vjetrës Përfaqar Bërthamës Së Qytetit	k4 14

KAPITULLI 5 Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore K5 1

5.1	Zhvillimi Historik i Qytetit	k5 1
Orientimi MTK 1	Ruajtja dhe Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore	k5 5
Orientimi MTK 2	Plani i Veprimeve në Trashëgiminë Kulturore	k5 6
Orientimi MTK 3	Zonat nën Mbrojtje	k5 8
Orientimi MTK 4	Metodat dhe Kriteret e Intervenimit në Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore	k5 10
Orientimi MTK 5	Komplekset e Mbrojtura	k5 12
Orientimi MTK 6	Kompleksi Memorial Gryka e Lumbardhit	k5 14
Orientimi MTK 7	Kompleksi i Marashit	k5 16
Orientimi MTK 8	Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit	k5 17
Orientimi MTK 9	Kalaja e Prizrenit	k5 18
Orientimi MTK 10	Kompleksi Nënkalaja	k5 19
Orientimi MTK 11	Kompleksi Pantella	k5 21
Orientimi MTK 12	Kompleksi i Shatërvanit	k5 22
Orientimi MTK 13	Kompleksi i Katedrales Katolike	k5 25
Orientimi MTK 14	Kompleksi i Hamamit Gazi Mehmed Pasha	k5 25
Orientimi MTK 15	Bazhdarana (Rruga Adem Jashari)	k5 26

Orientimi MTK 16	Kompleksi i Teqes Halveti, Rruga e Saraçëve dhe Ansambli i Banimit	k5 27
Orientimi MTK 16	Kompleksi i Shën Prendës	k5 29
Orientimi MTK 17	Lumbardhi Përgjatë Tërësisë Qëndrore Orientuese	k5 30
Orientimi MTK 18	Kompleksi i Tabakhanes	k5 31
Orientimi MTK 19	Karabashi	k5 32
Orientimi MTK 20	Kompleksi i Gjmnazit "Gjon Buzuku"	k5 33
Orientimi MTK 21	Bylbylderja	k5 34
Orientimi MTK 22	Ndërtesat dhe Komplekset Nën Mbrojtje	k5 34
Orientimi MTK 23	Lokalitetet Arkeologjie	k5 36
Orientimi MTK 24	Lokalitetet Arkeologjie Jashtë Arealit të Qytetit	k5 37
Orientimi MTK 25	Monumentet Historike	k5 37
Orientimi MTK 26	Punët e Pejshazit Në Zonat e Mbrojtura	k5 38
Orientimi MTK 27	Rrërimi i Ndërtesave në Zonat e Mbrojtura	k5 39
Orientimi MTK 28	Zhvillimi i Oborreve Ekzistuese	k5 39
	Lista e Monumenteve	k5 41

KAPITULLI 6 Përmbushja e Kërkesave të Komunitetit k6 1

6.a	BANIMI	k6 2
Orientimi KOM 1	Banimit Ekzistues	k6 2
Orientimi KOM 2	Zhvillimet e Reja të Banimit	k6 3
Orientimi KOM 3	Banimit Ekonomik	k6 4
Orientimi KOM 4	Banimit i Kombinuar	k6 5
Orientimi KOM 5	Banimit me Qasje të Mira / Personat me Aftësi të Kufizuara	k6 5
Orientimi KOM 6	Pjesët e Hapura Publike në Kuadër të Banimit të Ri	k6 6
Orientimi KOM 7	Parandalimi i Krimet	k6 6
6.b	INSTITUCIONET DHE SHËRBIMET PUBLIKE	k6 7
Orientimi KOM 8	Rizhvillimi i Shërbimeve Publike Ekzistuese	k6 7
Orientimi KOM 9	Qasja e Barabartë Për të Gjithë	k6 8
6.b.1	INSTITUCIONET EDUKATIVE ARSIMORE	k6 8
Orientimi KOM 10	Institucionet Ekzistuese Edukative Arsimore	k6 9
Orientimi KOM 11	Rizhvillimi i Institucioneve Edukative Arsimore Ekzistuese	k6 10
Orientimi KOM 12	Ndërtimi dhe Shtrirja e Institucioneve Edukative Arsimore	k6 11
Orientimi KOM 13	Entet Parashkollore dhe Niveli Parafillor	k6 12
Orientimi KOM 14	Arsimi Fillor	k6 14
Orientimi KOM 15	Arsimi i Mesëm i Lartë – Arsimi Profesional	k6 17
Orientimi KOM 16	Arsimi Special	k6 20
Orientimi KOM 17	Arsimi Privat	k6 21
Orientimi KOM 18	Arsimi i Lartë	k6 21
6.b.2	INSTITUCIONET SHËNDETËSORE	k6 22
Orientimi KOM 19	Institucionet Ekzistuese Shëndetësore	k6 22

Orientimi KOM 20	Rizhvillimi I Institucioneve Ekzistuese Shëndetësore	k6 23
Orientimi KOM 21	Ndërtimi Dhe Shtrirja E Institucioneve Shëndetësore	k6 24
Orientimi KOM 22	Shëndetësia Primare	k6 24
Orientimi KOM 23	Rizhvillimi i Spitalit të Qytetit	k6 26
6.b.3	SPORTI DHE REKREIMI	k6 27
Orientimi KOM 24	Objektet Ekzistuese të Sportit	k6 29
Orientimi KOM 25	Rizhvillimi i Pjesëve të Hapura Publike, Fushave Private për Sport dhe Rekreim Në Të Mbyllur dhe Qendrat Sportive	k6 30
Orientimi KOM 26	Zhvillimet e Reja Për Sport dhe Rekreim	k6 30
Orientimi KOM 27	Kombinimet Park-Shkollë	k6 36
6.b.4	INSTITUCIONET KULTURORE	k6 38
Orientimi KOM 28	Objektet Ekzistuese Të Kulturës dhe Rizhvillimi i Tyre	k6 38
Orientimi KOM 29	Zhvillimet E Reja Të Objekteve Të Kulturës	k6 39
Orientimi KOM 30	Arti Publik	k6 43
6.2.5	SHËRBIMET PUBLIKE (KOMUNALE)	k6 44
Orientimi KOM 31	Shërbimet Ekzistuese Publike (Komunale)	k6 44
Orientimi KOM 32	Rizhvillimi i Shërbimeve Ekzistuese Publike (Komunale)	k6 46

Aneks Tabelar

AT 1

1	Ndarja e përgjithshme sipas Destinimit - Shpërndarja nëpër TQO	2
2	Ndarja e përgjithshme sipas Destinimit - Ndarja sipas TQO-ve	
3	Tërësia Orientuese - QENDËR	
4	Tërësia Orientuese - LINDJE	
5	Tërësia Orientuese - VERI	
6	Tërësia Orientuese - PERËNDIM	
7	Tërësia Orientuese - JUG	
8	Njësitë Territoriale - Gjithsej Territori Urban Prizreni 2003-2013	

KAPITULLI 7 Sigurimi i Vitalitetit Ekonomik

k7 1

Orientimi VE 1	Konsolidimi i Strukturave Të Krijuara Urbane dhe Zhvillimore	k7 3
Orientimi VE 2	Zhvillimi i Qëndrueshëm i Aglomeracionit Urban	k7 4
7.a	INDUSTRIA – SEKTORI SEKUNDAR	k7 6
Orientimi VE 3	Industria Ekzistuese	k7 6
7.b	SEKTORI TERCIAR DHE KVARTAR	k7 9
Orientimi VE 4	Rizhvillimi i Sektorit Terciar dhe Kvaratar	k7 9
7.c	TREGËTIA DHE ZEJTARIA– BIZNESI FAMILIAR	k7 11

Orientimi VE 5	Rizhvillimi i Sektorit të Tregëtisë dhe Zejtarisë	K7 12
Orientimi VE 6	Frontet e Shoppingut në Zonat e Banimit	K7 13
Orientimi VE 7	Frontet e Shoppingut në Tërësitë Qarkore Orientuese	K7 15
Orientimi VE 8	Front i Sektorit të Shoppingut Primar	K7 16
Orientimi VE 9	Front i Shërbimeve Përcjellëse të Sektorit të Shoppingut	K7 17
7.d	TURIZMI	K7 19
Orientimi VE 10	Inkurajimi i Lokacioneve dhe Veprimtarive Turistike	K7 20
Orientimi VE 11	Hotelet me 10 e më shumë dhoma	K7 22
Orientimi VE 12	Shtëpitë për Mysafirë, Akomodimi i tipit "Shtrat e Mëngjes" dhe Hotelet me Më Pakë Dhoma Aneks SVE.1	K7 23
		K7 24

KAPITULLI 8 Promovimi i Trafikut Të Integruar K8 1

Orientimi TI 1	Vlerësimi i Trafikut	K8 1
Orientimi TI 2	Promovimi i Qasjes për Në Zhvillime të Reja	K8 2
Orientimi TI 3	Analiza Hapsinore E Infrastruktues Rrugore Të Qytetit	K8 3
Orientimi TI 4	Analiza E Strukturës Fizike Të Qytetit	K8 5
Orientimi TI 5	Hierarkia e Modaliteteve Të Lëvizjes	K8 6
Orientimi TI 6	Shtigjet e Reja për Këmbësorë	K8 7
Orientimi TI 7	Shtigjet e Reja për Çiklizëm	K8 8
Orientimi TI 8	Transporti Publik	K8 8
Orientimi TI 9	Faktoret Teknik Te Ngecjes Së Zhvillimit Normal Te Lëvizjes Së Automjeteve Në Qytet	K8 10
Orientimi TI 10	Masat Dhe Aktivitet Për Menaxhimin E Trafikut	K8 11
Orientimi TI 11	Parkimi Publik	K8 13
Orientimi TI 12	Prioritetet, Përfshirja Në Sipërfaqet Ndërtimore	K8 14
Orientimi TI 13	Qarkullimi i Mallit	K8 15

KAPITULLI 9 Promovimi i infrastrukturës së integruar teknike K9 1

KAPITULLI 10 Plani për Mbrojtjen e Mjedisit K10 1

Orientimi MA 1	Vlerësimi mbi Ndikimin në Mjedis	K10 2
Orientimi MA 2	Rajonet e Mbrojtura	K10 3

Orientimi MA 3	Mbrojtja E Llojeve Të Shtazëve Dhe Bimëve, Drunjëve Dhe Gjellbërimit Rrethues/ Mbrojtës	K10 3
Orientimi MA 4	Promovimi I Ekosistemit Në Lokacionet E Zhvillimit	K10 5
Orientimi MA 5	Mbrojtja E Tokës Agrare	K10 5
Orientimi MA 6	Shfrytëzimi Ekonomik I Resurseve Natyrore, Menaxhimi I Hedhurinave	K10 6
Orientimi MA 7	Hapësira E Lirë Planifikuese Dhe Ndotja	K10 6
Orientimi MA 8	Ndotësit E Mjedisit	K10 7
Orientimi MA 9	Deponitë E Mbeturinave	K10 8
Orientimi MA 10	Riciklimi Lokal Dhe Industria E Procesimit Te Hedhurinave Lokale	K10 9
Orientimi MA 11	Ndriçimi I Rrugëve Dhe Ndriçimet Tjera Të Jashtme	K10 9
Orientimi MA 12	Ndriçimi Me Reflektorë I Qendrave Sportive	K10 10
Orientimi MA 13	Ndërtimet Ne Afërsi Të Ujit Të Rrjedhshëm	K10 10
	<i>Aneks 1/ K10</i>	K10 12

KAPITULLI 11 Arritja E Kualitetit K11 1

Orientimi AK 1	Projektimi në Përputhmëri me Kontekstin	K11 2
Orientimi AK 2	Zonat Urbane të Reja si Mjedisë të Suksesshme	K11 3
Orientimi AK 3	Përbushja e Kërkesave Funkcionale	K11 4
Orientimi AK 4	Projektimi i Peizazhit	K11 5
Orientimi AK 7	Madhësia dhe Intimiteti i Kopshteve	K11 6
Orientimi AK 8	Projektimi i Destinimeve Joresidenciale	K11 6
Orientimi AK 9	Deklarata mbi Projektin	K11 7

KAPITULLI 12 Implementimi K12 1

Orientimi IM 1	Kontrolli i Zhvillimit	K12 1
Orientimi IM 2	Planifikimi I Humbjeve	K12 3
Orientimi IM 3	Përfshirja E Banorëve Në Proces Të Planifikimit	K12 3
Orientimi IM 4	Monitorimi	K12 3
Orientimi IM 5	Shqyrtimi, Verifikimi	K12 4
Orientimi IM 6	Propozimet Implementuese Për Tërësitë Orientuese	K12 5
Orientimi IM 7	Implementimi Në Tërësinë Qëndrore Orientuese	K12 5
	I Kvadranti [D5]	K12 6
	II Kvadranti [D6]	K12 9
	III Kvadranti [D7]	K12 11
	IV Kvadranti [E5]	K12 12
	V Kvadranti [E6]	K12 15
	VI Kvadranti [E7]	K12 16

VII	Kvadranti [F5]	K12	18
VIII	Kvadranti [F6]	K12	19
VIII	Kvadranti [F7]	K12	20

Shtojcat		shtojca	1
Shtojca 1	KRITERET PËR NDËRTIMIN DHE RINDËRTIMIN E OBJEKTEVE NË ZONAT E MBROJTURA	shtojca	2
	1 Zona e Parë e Mbrojtur	shtojca	2
	2 Zona e Dytë e Mbrojtur	shtojca	4
	3 Zona e Kontaktit	shtojca	4
Shtojca 2	STANDARDET E PJESËVE TE HAPURA PUBLIKE	shtojca	5
	1 Parqet Lokale	shtojca	5
	2 Zonat Joformale Të Lojës Për Fëmijët	shtojca	6
	3 Zonat Joformale - Loja Për Të Rinjë	shtojca	7
	4 Hapësira e Lirë Planifikuese	shtojca	7
	5 Fushat e Sportit (Joformal) Dhe Fushëlojat	shtojca	7
Shtojca 3	STANDARDET E PARKIMIT PUBLIK	shtojca	8
	1 Aplikimi i Standardeve Për Parkim Të Veturave	shtojca	8
	2 Standardet Maksimale Për Parkim Të Veturave	shtojca	10
	3 Standardet Tjera	shtojca	13
	4 Standardet Për Parkim Të Bicikletave	shtojca	13
	5 Standardet Për Parkim Të Motocikletave	shtojca	14
	6 Parkimi Për Të Hendikepuar	shtojca	15
	7 Projekti dhe Shtrirja	shtojca	16
	8 Shtrirja e Zonave Parkuese	shtojca	16
Shtojca 4	KRITERIUMI PËR MADHËSI DHE INTIMITET TË KOPSHTEVE	shtojca	18
	Shënimet Shpjeguese	shtojca	21
Shtojca 5	KLASËT E DESTINIMEVE - në kuadër të planifikimit të qytetit	shtojca	22

Pasthënie

Deklarata e Hartuesit të Planit të Përgjithshëm (Gjeneral),
Prizren 2003-2013
Literatura

EKIPI PUNUES

Udhëheqës dhe përgjegjës i projektit

Lulëzim NIXHA, ark.ing. dipl.

Grupi Qëndror Profesional

Vlora NAVAKAZI, ark. cand. Mr.

Florina JERLIU, ark. MA

Behar DYLA, ark. ing. dipl.

Astrit NIXHA ark. ing. dipl.

Shqipe NIXHA, ark. Mr. Sc.

Edi SHUKRIU, Prof. Dr.

Halim GJERGJIZI, Mr. Ecc.

Agron NAGAVGCI, ing. hidro.

Ramë QUPEVA, inxh. dipl. transport

Baton BEGOLLI, Mr. ambient.

Xhelal ORANA, ing. dipl.

Myzhdet Gjini, ing. elektro.

Gëzim PULA, ing. elektro.

Rasim MJEKIQI, ing. dipl. makin.

Grupi përkrahës Profesional

Ahmet ALIJAH, ing. hidro

Ramadan MAZREKAJ, ing.dipl

Nol DEDAJ, ing.dipl, specialist

Emsale LIMANI, tek. ndërt., IMM Prizren

Jusuf FISHEKXHIU, tek. ndërt.

**Grupi profesional për grumbullimin dhe
përpunimin e të dhënave**

Kreshnik FERIZI, cand.ark.
Ideal VEJSA, cand. ark.
Krenar SINANI, cand. ark.
Agon BASHA, cand. ark.
Daver DAPKO, ark. Ing.dipl.
Driton KRYEZIU, ing.dipl. ndërtimit
Petrit MORMORINA, cand.ark.
Shpresa OSMANOLLAJ, cand.ark.
Besnik HOXHA, cand.ark.
Veron ALIU, cand.ark.

**Udhëheqës i Projektit pranë KK Prizren
Kujtim RADA, ark. Ing.dipl.**

Monitorimi, Verifikimi - KK Prizren

Ragip GAJRAKU, Udhëheqës
i Bordit të Drejtorëve KK Prizren
Hamit Bojnik, Drejtor
Drejtorati për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësiror



KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
PLANI I PËRGJITHSHËM (GJENERAL)
PRIZRENI 2003-2013

Draft i Dytë
Për Shqyrtim dhe
Diskutim Publik



KAPITULLI 1

HYRJE, KONTEKSTI DHE QËLLIMI

“Qyteti është një mjedis në të cilin zhvillohet procesi i jetës së kondenzuar njerëzore. Ky mjedis kushtëzohet nga klima natyrore, ekonomike, teknike, sociale estetike dhe intelektuale. E VIETRA dhe E REIA formojnë proces unik të klimës një mjedis të tillë. ... Qyteti krijohet dhe lëviz, përjeton tensione. Bëhet ideal, symbol, dhe frymëson. Prizreni si i tillë është një nga anëtarët e qyteteve POLISA me vlerë”. (B. Fehmiu, “Prizreni – Kryevepër e mjeshtërive të panjohur”)



I. MORFOLOGJIA E STRUKTURËS SË QYTETIT TË VJETËR TË PRIZRENIT

Prizreni bën pjesë në grupin e qyteteve me lumin në mes – Lumbardhin i cili përben kurrizin e tij. Brigjet e Lumbardhit janë të lidhura me 9 (nëntë) ura të vogla dhe të mëdha. Përgjatë brigjeve të lumit, në të dy anët e tij, janë të shpërndara strukturat funksionale arkitektonike të cilat shtrihen në mënyrë të barabartë për nga rëndësia por të pabarabartë për nga sasia .



Përgjatë bregut të majtë janë formësuar grupet e strukturave të dyqaneve që sot përbëjnë qendrën (zembrën) e qytetit – Shatërvanin, dhe vazhdojnë me ansamble shtëpishë të cilat ngriten drejtë kodrave të pjerrta të Nënkalasë, Pantelisë, Mëhallës së Potokut, Tususit etj. për të humbur me pastaj nën vreshtat e Prizrenit e më tej tërë kjo pamje e butë dhe e këndëshme qetësisht përfundon nën kornizat e mjegulluara të Cvilenit.

Në mesin e këtij konfiguracioni dominon Kalaja e vjetër e cila me shekuj sikur kujdeset për fatin e qytetit.

Në bregun e djathtë të Lumbardhit strukturat e ansambleve urbanistike arkitektonike vazhdojnë të zhvillohen qetë pa pengesa në teren të sheshtë drejtë fushës së Prizrenit përgjatë rrugëve dalëse Prizren-Gjakovë, Prizren – Therandë si elemente determinuese të strukturës urbanistike të Prizrenit.

Kjo strukturë morfologjike e Prizrenit ka pësuar transformime të dukshme, sidomos pjesa qendrore e saj, me rrënimin e komplekseve të çarshisë (arasta, terzive, tufekxhive, biçakxhive, makazxhive, mehanxhive, kirajtanxhive, saraçëve një pjesë e kujunxhive, kompleksit të Marashit dhe shumë ndërtesa të tjera) për të vendosur sheshin e ri me ndërtesa gjigante të Kuvendit të komunës, Kontabilitetit, Hotelit, Bankës, Postës, Shtëpisë së Kulturës, Kinemasë, Shtëpisë së mallrave dhe shumë ndërtesave tjera afariste tregëtare dhe banesore.

Përkunder veprimeve të tilla të cilat kanë çenuar harmoninë dhe bukurinë e ambienteve dhe atmosferës me të cilën Prizreni ka qenë i njohur dhe i çmuar, mendojmë se është akoma e mundur të punohet në mbrojtjen e siluetës të qytetit të vjetër e cila do të reflektonte me qasje të mirëfilltë në strategjinë dhe taktiken për ruajtjen e Prizrenit si venbanim me vlera monumentale arkitektonike dhe urbanistike



II. PËRGADITJA E PLANIT TE RI 2003-2013 PËR QYTETIN E PRIZRENIT

- 1.1 Kuvendi Komunal i Prizrenit, me ligj, është i detyruar të ketë Plan i cili mbulon gjithë hapësirën e komunës dhe i cili ofron orientimet detale për udhëzim të zhvillimit. Plani ekzistues i Prizrenit është aprovuar ne vitin 1981 dhe mbulon periudhën deri ne vitin 1991. Ne tani ofrojmë planin i cili do te vlejë për periudhën 2003 deri në 2013.
- 1.2 Si fazë e parë në përgatitjen e këtij plani, prezentohet Drafti i Parë në qershor të vitit 2003, në të cilin identifikohen problemet kryesore për zhvillimin e mëtejme të Prizrenit. Ndërkaq kjo fazë e planifikimit, përcakton orientimet dhe parimet për zhvillimin e Prizrenit mbështetur mbi traditën dhe karakteristikat e këtij qyteti si duke dhënë kështu orientime të reja për zhvillimin e ardhshëm të qytetit. Plani identifikon të gjitha lokacionet ekzistuese si dhe propozon lokacione potenciale për zhvillim madhor. Në procesin e finalizimit të këtij Plani, gjithashtu planifikohen prezentime publike. Pas prezentimit publik të Draftit të Parë të organizuar në korrik 2003, komentet individuale dhe të palëve tjera të interesuara që janë pranuar, kanë ndihmuar zhvillimin e orientimeve dhe propozimeve të këtij plani, si dhe përcaktimeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit¹⁾.



¹⁾ Firma kontraktuese "NIXHA&PARTNERS" është hartuese e këtij dokumenti dhe nga ky pozicion propozon orientime dhe procedura për KK të Prizrenit;

Qëllimi i firmës "NIXHA&PARTNERS" është që përmes të shprehurit në vetë të parë të ofrojë një version të dokumentit që të jetë teknikisht lehtë i revidueshëm për përvetësim nga ana e KK Prizrenit, në rastin kur i njëjti diskutohet, adaptohet dhe pranohet nga KK e Prizrenit

Në këtë dokument "NIXHA&PARTNERS" shprehet në emër të KK të Prizrenit, duke i parashtruar përcaktimet e KK të Prizrenit për Plan të Përgjithshëm të Qytetit të Prizrenit, konform konditave të përcaktuara me kontratë.

- 1.3 Ky dokument paraqet fazën e dytë të legalizimit të procesit të përgatitjes së planit të ri për qytetin e Prizrenit, në pajtim me dispozitat ligjore.
- 1.4 Kuvendi Komunal i Prizrenit dëshiron që në këtë plan të përfshihen diskutimet publike, në mënyrë që t'i pranojë komentet e banorëve të Prizrenit. Kjo do të mundësonte që të njejtat të studiohen dhe ato të arsyeshmet të diskutohen me propozuesit. Nëse Kuvendi Komunal i Prizrenit dëshiron ta ndryshojë planin në bazë të komenteve të pranuar, drafti i ndryshuar do të publikohej me ndërrimet e cekura në këtë draft. (Drafti i parë, me këtë rast, nuk ndryshon në aspektin e vërejtjeve dhe propozimeve meqë si i tillë është pranuar dhe është formuar baza për hartimin e këtij Plani).
- 1.5 Një mori faktorësh janë marë në konsiderim gjatë punimit të këtij Plani, e në veçanti faktorët e cekur më poshtë:
- **Mbrojta e vlerave urb-arkitektonike** të Prizrenit është pikësynim dhe parametër i cili qëndron në shërbim jo vetëm të ruajtjes së këtyre vlerave por edhe të profilimit të ardhshëm të qytetit të Prizrenit.
 - **Banimi i ri** është i nevojshëm për shkak të rritjes së popullsisë dhe për shkak se është shtuar numri i familjeve të reja me kërkesa për banim të ri;
 - **Ekonomia e Prizrenit** është zhvilluar në drejtime të ndryshme në vend se të jetë e bazuar në industrinë prodhuese, ndërsa ekonomia shërbyese duhet të transformohet në një ekonomi të suksesshme për arsye të rritjes së madhe të kërkesave në sektorin e arsimit, shëndetësisë, rekreimit dhe të tregëtisë.
 - **Trafiku i integruar** brenda një njësie, si i ndërsjellë në mes të njërive, dhe ai i të gjitha njërive me trafikun qëndror të qytetit, përmes të gjitha modaliteve brenda distancave të propozuara, do të mundësonte funksionim cilësor të trafikut të qytetit të Prizrenit.
 - **Ngritja e vetëdijes** për mbrojtjen e rrethinës.
- 1.6 Ky draft plan përcakton orientimet e planit që Kuvendi Komunal i Prizrenit i konsideron të jenë udhëzues për zhvillimin e Prizrenit deri dhe pas viti 2013, së bashku me propozimet për zhvillim. Secili orientim ose grup orientimesh mbështetet në arsyeshmëri.



- Kapitulli 1- "**Hyrje, Konteksti Dhe Qëllimi**" - përcakton kontekstin e orientimeve për Planin. Përshkruan vizionin e Kuvendit Komunal, caqet dhe synimet. Gjithashtu përcakton vlerësimet e qëndrueshmërisë së Planit.
- Kapitulli 2 - "**Parashikimi i Zhvillimit Të Qëndrueshëm**" - përmbledh orientimet që janë kyçe për strategjinë zhvillimore të Kuvendit Komunal.
- Kapitulli 3 - "**Zonimi Strategjik i Qytetit**" - përmban orientimet që përcaktojnë zonimin strategjik të qytetit në kontekstin territorial, administrativ dhe historik, si dhe të zonave të karakterit të veçantë.
- Kapitulli 4 - "**Modeli i Qytetit**" - përmban të dhënat dhe orientimet relevante të cilat janë kyçe për prezentimin e modelit të ri të qytetit.
- Kapitulli 5 - "**Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore**" - përmban orientimet që janë kyçe për ruajtjen dhe avancimin e vlerave të karakterit historik dhe kulturor duke promovuar konzervimin e integruar si mjet për mbrojtje dhe planifikim.
- Kapitulli 6 - "**Përmbushja e Kërkesave Të Komunitetit**" - përmban orientimet që mirren me nevojat e komunitetit, e që janë të lidhura me progresin social dhe që përfshin nevojat e të gjithëve.
- Kapitulli 7 - "**Sigurimi i Vitalitetit Ekonomik**" përshkruan orientimet që kanë të bëjnë me vitalitetin ekonomik, e që janë të lidhura me konsolidimin, respektivisht, ristrukturimin si dhe avancimin e ekonomisë locale përmes zhvillimit të qëndrueshëm duke u bazuar në koncepte të reja për zhvillim të ekonomisë bashkëkohore.
- Kapitulli 8 - "**Promovimi i Infrastrukturës Komunale të Integruar**"- përshkruan orientimet që kanë të bëjnë me përmirësimin e gjithëmbarshtëm të infrastrukturës ekzistuese (*uji, kanalizimi fekal dhe atmosferik, energjia elektrike, gasifikimi dhe fjetet optike të telekomunikacionit*) duke u bazuar në propozime të reja e që nënkupton ndërrimin e kapaciteteve, modernizimin e tyre si dhe krijim e një infrastrukture të re dhe të integruar, për zhvillime të reja.
- Kapitulli 9 - "**Promovimi i Trafikut Të Integruar**"- përmban orientimet për promovimin e trafikut të integruar, e që janë të lidhura me koordinimin dhe integrimin e të gjitha llojeve të trafikut, në të mirë të qëndrueshmërisë, qasjes dhe sigurisë në trafik.
- Kapitulli 10 - "**Mbrojtja Dhe Avancimi i Mjedisit**" - përmbledh orientimet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe avancimin e rrethit, e që janë të lidhura me eksploatimin e të mirave natyrore dhe ruajtjen e mjedisit.
- Kapitulli 11 - "**Arritja E Kualitetit**" - përshkruan orientimet e dizajnuara për arritjen e kualitetit, e që janë të lidhura ngusht me kualitetin e lartë të ndërtimeve për banorët e Prizrenit.

- Kapitulli 12 – “**Implementimi**” - mirret me implementimin dhe identifikon propozimet specifike të Kuvendit Komunal për lokacionet e identifikuara dhe lokacionet brenda Prizrenit, të dedikuara për zhvillim, në përputhshmëri me qëllimet dhe synimet e këtij Plani.

1.7 Kapitujt 1-12 dhe Shtojcat (Apendikset) e përbëjnë pjesën tekstuale të Planit të Përgjithshëm të Qytetit të Prizrenit 2003-2013, i cili gjithashtu përmban Pjesën Grafike të Planit.

III. KONTEKSTI I ORIENTIMEVE



Në pregaditje të këtij Plani, janë marë në konsiderim edhe planifikimet në kontekst më të gjërë.

a) Konteksti ndërkombëtar

1.8 Profili fizik i Prizrenit mundëson lidhje me regionet fqinje: Shqipëri, Mal i Zi dhe Maqedoni. Kuvendi Komunal i Prizrenit njih faktin se lidhja me regionet fqinje është një nga qëllimet kryesore të strategjisë zhvillimore për qytetin e Prizrenit.

1.9 Autostrada Durrës- Kukës- Prishtinë- Mirdare si dhe mundësia e rrugës së re Prizren-Tetovë, si rrugë të nivelit ndërkombëtar kanë rëndësi esenciale për përfshirjen e Kosovës në korridoret ndërkombëtare të rrugëve. Kjo është e vetmja zgjidhje afatgjate dhe është rruga më e shkurtër për inkuadrimitin e Kosovës në rrjetin e rrugëve me rëndësi ndërkombëtare.



1.10 Hekurudha si potencial i posaçëm në modernizim dhe vazhdim të aksit në drejtim të Shqipërisë, ka rëndësi esenciale për zhvillimin ekonomik të tërë rajonit dhe në veçanti të Prizrenit, si dhe për integrimin e Kosovës në rrjetin hekurudhor të Evropës Juglindore.

b) Konteksti Kosovar

1.11 Plani Hapësiror i Kosovës, i Plani Hapësiror i Kosovës, i aprovuar në vitin 1978, e mbulonte periudhën kohore 1975-2000 dhe tashmë është i skaduar. Plani i ri Hapësiror i Kosovës do të duhej të reflektonte situatën e re politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë, dhe si i tillë, do të përcaktonte kontekstin kosovar edhe të Komunës, rrjedhimisht, qytetit të Prizrenit.

1.12 Në mungesë të PH të Kosovës, Komuna e Prizrenit harton Planin e vet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësiror (viti 2003). Kuvendi Komunal i Prizrenit i konsideron Orientimet e këtij Plani të jenë udhëzues për zhvillimin e Prizrenit deri dhe pas viti 2013. Me publikimin e udhëzuesit qeveritar të cilin Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësiror, (MAPH) në “Raportin mbi Gjendjen Ekzistuese në Planifikim dhe Menaxhim Urban në Komunat e Kosovës”, e radhit si fazë të tretë të planit për veprim emergjent nëpër komuna (Fazë e parë: Grumbullimi i Informatave, Fazë e dytë: Raporti mbi gjendjen Ekzistuese), Kuvendi Komunal i Prizrenit do t'a konsiderojë harmonizimin e Orientimeve të këtij plani konform udhëzuesit për veprime të mëtutjeshme bazuar në ligjet në fuqi, pasi që i njëjti të jetë publikuar nga ana e MAPH.

1.13 Sipas Planit të vjetër hapësiror, Prizreni i takon kategorisë së qendrave rajonale falë strukturës komplekse të shërbimeve publike dhe të pozitës që ka si zonë ku gravitojnë komunat tjera si Rahoveci, Suhareka, Shtërpca dhe Dragashi. Sipas të dhënave të, në vitin , Komuna e Prizrenit (sipas Profilin socio ekonomik dhe fizik I Komunës së Prizrenit) ballafaqohet me një numër prej 220.776 banorësh, prej të cilëve, në zonën urbane jetojnë 110.000 banorë, derisa sipas Entit Statistikor të Prizrenit 2000 (demografia nga statistika e vitit 1991, Komuna e Prizrenit ballafaqohet me numër të banorëve prej 178.679 kurse në qytetin e Prizrenit 93.035 banorë). Zhvendosja e popullatës nga zonat rurale në ato urbane (posaçërisht pas luftës) ka ndodhur paralelisht me ndryshimet shoqërore-ekonomike në Kosovë. Si rrjedhojë, sot ballafaqohemi me një rritje të pakontrolluar të hapësirës së banueshme, edhe në qytetin e Prizrenit.


1.14 Rëndësia e Prizrenit në raport me komunat kadastrale në rrethinë vazhdon të jetë e nivelit të lartë, jo vetëm për shkak të pozitës së vulltshme që ka Prizreni si zonë gravituese, ofrimit të shërbimeve publike në sektorët kyç si dhe numrit të madh të banorëve që jetojnë në këtë komunë, por edhe falë vlerave kulturore-historike dhe shoqërore që ky qytet i ka.

1.15 Konteksti kosovar i qytetit të Prizrenit do të avancohej përmes:

- riafirmimit të rolit ndër-regjional të Prizrenit si qendër kulturore dhe ekonomike, duke e avancuar paralelisht karakterin turistik të Prizrenit falë pozitës së volitshme si dhe vlerave shekullore të trashëgimisë kulturore-historike të këtij qyteti.
- zhvillimit dhe avancimit të rrjetit të trafikut me potencim në rrugët të niveleve të ndryshme në drejtim të Prishtinës, Gjakovës, Kukësit dhe Tetovës.
- hapjes së Prizrenit ndaj tregut botëror përmes integritit në korridoret ndërkombëtare, falë pozitës së volitshme gjeostrategjike që e vendos Prizrenin në pikëshkëmbimin kyç të trafikut rajonal - ndërkombëtar.

c) Konteksti Komunal

1.16 Komuna e Prizrenit karakterizohet me relief të ndryshueshëm që në vete përmbledh pjesën malore të Malit Sharr, me pjesën kodrinore dhe atë fushore të territorit të Prizrenit. Fshatrat e komunës së Prizrenit janë kultivues dhe prodhues me traditë të hardhisë së rrushit dhe të perimeve, grurit dhe misrit si dhe të kulturave tjera bujqësore. Pjesa malore rreth Zhupës karakterizohet me kullosa të pasura dhe me ujë të mjaftueshëm, me fshatra të njohura për nga tradita blegtorale.



1.17 Sipërfaqet e përgjithshme bujqësore në Komunën e Prizrenit janë 34864 ha prej të cilave rreth 12000 Ha janë të punueshme ndërsa pjesa tjetër është kullosa dhe livadhe. Kjo komunë poashtu posedon rreth 28000 ha pyje. Prej 12000 Ha sipërfaqe bujqësore: rreth 33 % janë me sistem të ujitjes, rreth 15.5% janë të mbjellura me hardhi të rrushit, rreth 10.5% me perime, dhe rreth 41% janë grurë dhe pjesa tjetër me kultura tjera.¹⁾

1.18 Konteksti komunal i Prizrenit do të avancohej përmes:



- hartimit të strategjisë për zhvillimin e fshatrave të komunës së Prizrenit që do të siguronte krijimin e një tërësie rajonale duke e barazpeshuar zhvillimin e gjithëmbarshëm të komunës së Prizrenit. sipas skemave zhvillimore për nënrajonet përkatëse të komunës .

¹⁾ Të dhënat e KK Prizrenit "Profili Socio Ekonomik dhe Fizik i Komunës së Prizrenit"

- Përvetësimin të qasjes adekuate, ndaj fshatit varësisht prej llojit dhe modalitetit të vendbanimeve: fshat i dendur që dominon në luginat e lumenjëve dhe fshat i shpërndarë-në kodrina dhe vise kodrinoro-malore.
- zhvillimit dhe avancimit të rrjetit të trafikut në gjithë territorin e komunës që do të siguronte krijimin e një infrastrukture komunale, lidhshmërinë në mes të fshatrave si dhe të fshatërave me qytetin e Prizrenit dhe anasjelltas.
- ngritjes së cilësisë së mjedisit jetësor duke krijuar hapësira atraktive për banim dhe vendeve të punës, që do ta ulte fenomenin e shpërnguljes së popullatës rurale në qytet, meqë kushtet në zonat rurale janë shumë më të volitshme në aspektin e krijimit të zhvillimeve të reja.

d) Konteksti i Qytetit



1.19 Plani e identifikon Prizrenin si qytet ku gravitojnë interesat afariste, me varg dyqanesh të specializuara me asortiman të gjerë të të mirave si dhe zgjidhje të shumta të shitblerjes. Prizreni si zonë me vlera të kulturës, trashëgimisë historike dhe arkitektonike, të ekonomisë, turizmit, tregëtisë dhe të gjitha shërbimeve

tjera publike paraqet qendër të rëndësishme për punësim të banorëve të Prizrenit. Plani njeh faktin se kërkesat e qytetit të Prizrenit janë në rritje dhe në këtë drejtim është i nevojshëm intensifikimi i të gjitha shërbimeve publike si dhe planifikimi i gjithëmbarshtëm i funksioneve të tjera në qytet. Prandaj, plani mundëson zhvillimin e qytetit mbështetur në vlerësimet e bëra për gjendjen ekzistuese të kualitetit të rrethitës njerëzore, normave dhe standardeve ndërkombëtare për zhvillim dhe regjenerim urban si dhe parametrat e analizuar dhe të vlerësuar të këtij plani karshi strategjisë zhvillimore për Qytetin e Prizrenit.



1.20 Plani përmban orientimet kyçe të formuluar për t'i orientuar planet e ardhshme detale. Këto orientime i shqyrtojnë çështjet si regjenerimi urban, mbrojtja e zonave të rëndësishme kulturore-historike dhe ambientale, rikonstruimi i një infrastrukture të mirëfilltë si dhe promovimi i zhvillimit ekonomik.

IV. ÇKA SYNON KY PLAN

1.21 Synimi fundamental i Kuvendit Komunal të Prizrenit është përpilimi i një Plani i cili bazohet në parime të qëndrueshme të zhvillimit.

“Kuvendi Komunal i Prizrenit njih faktin se mbrojtja e trashëgimisë kulturore të Prizrenit është esenciale për zhvillimin e gjithëmbarshtëm dhe të qëndrueshëm të qytetit. Kjo arrihet përmes:

- mbrojtjes dhe rejtjes së objekteve dhe komplekseve urbarkitektonike me vlera historike dhe kulturore, me qëllim të avancimit të këtyre vlerave në shërbim të profilimit të karakterit historik kulturor dhe turistik të qytetit të Prizrenit.
- integritit të objekteve dhe të komplekseve të lartëpërmendura në tërësi zonale duke i vendosur në funksionet përkatëse, bashkëkohore dhe/ose historike
- integrimi tërësive zonale të mbrojtura në kontekstin e gjerë të qytetit, përmes komunikimit të ndërsejlltë të funksioneve jetësore.
- riorganizimin e qendrës së qytetit në funksion të afirmimit të vlerave trashëgimore të Prizrenit për qëllime turistike, duke promovuar fillimisht zhvillimin e turizmit transit dhe dinamik, për t'u shndërruar më tej në turizëm stacionar (shtëpiak).



“Kuvendi Komunal i Prizrenit mbështet objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo nënkupton:

- të qëndrosh brenda kapaciteteve të ambientit natyror duke avancuar në ndërkohë kualitetin e jetës.
- fëmijëve në të ardhmen t'ju ofrojmë cilësinë e jetesës me kushte më të mira.
- të sigurosh që shtresa më e varfër dhe e paaftë e shoqërisë, për shkak të statusit që ka, të mos detyrohet të injorojë obligimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- të integrosh objektivat orientimore të ambientit me orientimet sociale dhe ekonomike.

“Kuvendi Komunal i Prizrenit njih faktin se shoqëria e arriti dhe në disa raste edhe i tejkaloi kufijtë ambiental; se, shoqëria duhet të mësojë si të jetojë brenda kufijve ambiental. Që të arrihet një gjë e tillë, do të duhej që:

- të zvogëlohet konsumimi i resurseve natyrore.
- të vendosen kufijtë në ndikimet tona ndaj ambientin
- të shkohet drejt përparimit social dhe ekonomik dhe të kontrollohet zhvillimi në përmbushjen e këtyre kufijve
- të rritet efikasiteti i energjisë dhe resurseve
- të zvogëlohet ndikimi ndotës ndaj ambientit
- të mbrohet dhe të zhvillohet llojllojshmëria e natyrës
- të shtohet pjesëmarrja dhe përkrahja e qytetarëve.

“Kuvendi Komunal i Prizrenit gjithashtu njeh faktin se zhvillimi i qëndrueshëm parashtron pengesa në ekonomi dhe beson se zhvillimi i qëndrueshëm:

- është në harmoni me rritjen e mirëqenies ekonomike dhe kualitetin e jetës.
- është i nevojshëm për të siguruar perspektivë afatgjate ekonomike.
- ofron mundësi pozitive për krijimin e të ardhurave dhe punësimit përmes të përdorimit të teknologjisë më të pastër dhe më efikase si dhe të mënyrës së jetesës.

“Kuvendi Komunal i Prizrenit pranon se ndryshimet e nevojshme për arritje të qëndrueshmërisë nuk do të shfaqen automatikisht, dhe në veçanti Kuvendi Komunal merr parasysh se:

- ekonomia do të duhej të menaxhohej përmes intervenimeve në ndryshim të zgjidhjes dhe sjelljes së konsumatorëve dhe afaristëve.
- ne duhet të zhvillojmë mënyrat për të përfituar mbështetjen e qytetarëve në ballafaqim me pengesat eventuale.
- rregulloret dhe mekanizmat ekonomike si dhe masat për ngritjen e vetëdijes publike do të duhej të shfrytëzohen për t'i përmbushur këto arritje.

“Kuvendi Komunal i Prizrenit beson se Administrata Lokale është partner esencial në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm:

Shumë probleme sociale dhe ambientale janë të nivelit lokal ku roli i Administratës lokale në përpilim të orientimeve dhe implementim është i rëndësishëm së madhe. Edhe çështjet me karakter ndërkombëtar dhe kombëtar, shpesh kanë zgjidhje lokale.



“Sa më i afërt të jetë niveli i qeverisjes me qytetarë, autoritetet lokale kanë rol të rëndësishëm në:

- Informim dhe edukim të komunitetit lokal
- Përfaqësim në emër të komunitetit dhe asistim në demokraci lokale
- Koordinim dhe mundësim të veprimeve lokale si dhe në inkurajim të pjesëmarrjes direkte të individëve në proces

V. VIZIONI PËR PRIZRENIN



Trashëgimia kulturore-historike e Prizrenit paraqet vlerë të rëndësishme madhore. Mbrojtja dhe avancimi i ndërtesave dhe i komplekseve me karakter historik dhe kulturor si dhe integrimi i tyre në rrjedhat bashkëkohore do të veheshin në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm. Trashëgimia e ruajtur do të jetë element i rëndësishëm në kompozimin e siluetës së përgjithshme të qytetit. Të gjitha vlerat e trashëguara por edhe ato që me kohë janë shkatërruar duhet të përtërihen me qëllim të arritjes së atyre vlerave që me kohë pësuan transformime. Rrikthimi i vlerave të trashëguara në gjendjen e tyre burimore do të bëhet në bazë të të dhënave për to.

Gjithashtu, ne e shofim trashëgiminë kulturore-historike si një nga potencialet e zhvillimit ekonomik. Afirmimi i vlerave trashëgimore të Prizrenit paraqet aspekt të veçantë për zhvillimin e sektorit të turizmit në të gjitha potencialet me të cilat posedon Prizreni. Njëherit, kjo qendër do të ketë rëndësi të posacme në zhvillimet makroubane në lëminë e turizmit duke u bazuar në afërsinë me resurset natyrore të vlerave të veçanta dhe atraktive si: Cvileni, Gryka e Lumbardhit rrëzë Sharrit, Prevalla, Brezovica, etj, të cilat janë potencial për zhvillim të mirëfilltë të turizmit rekreativ stacionar, turizmit përfundjavë, atij veror dhe dimëror, dhe ku mund të zhvillohen aktivitete rekreative (gjueti, peshkim, skijim, alpinizëm, etj) si dhe ato të preventivës shëndetësore në kushte të natyrës së paprekur.



Në zonat e reja urbane, ne parashofim integrimin e të gjitha shërbimeve vitale për funksionim cilësor të një vendbanimi duke promovuar vende të vogla të punës. Kjo mund të arrihet përmes zhvillimit të destinimeve të përziera dhe përgjatë vijave të trafikut publik. Këto zona do të kenë kapacitet optimal urban në mënyrë që të përmbushen nevojat për banim, në ndërkohë që të mundësohet shkarkimi i qendrës së qytetit të Prizrenit si parakusht për ruajtjen e banimit dhe shndërrimin e tij në një banim më kualitativ, në suazat e zonave të propozuara të mbrojtjes. Banimi do të jetë i madhësisë, llojit dhe i kategorive të ndryshme në mënyrë që të përmbushë aspiratat dhe kërkesat e banimit, të integruar plotësisht në zhvillimet e reja. Vendet madhore të punës do të jenë të përfshira në shemat e trafikut të integruar në mënyrë që të jenë lehtë të arritshme për banorët dhe njëherit do të kenë ndikim minimal në ndotje të ambientit.

Sistemi i trafikut do t'u shërbejë të gjithë banorëve të qytetit. Rrjeti ekzistues i trafikut automobilistik do të integrohet me modalitetet tjera të trafikut duke e ngritur cilësinë dhe lidhshmërinë e qytetit të Prizrenit në një tërësi integrale dhe duke i vendosur skemat e të gjitha modaliteve në veçanti. Ecja dhe çiklizmi do të jenë të përshtatshme dhe të këndshme si mënyrë e trafikut dhe si formë e rekreimit, sidomos te rrugët e ngushta të pjesës së vjetër të qytetit ku trafiku automobilistik do të ishte krejtësisht i ndaluar, përpos për raste emergjente. Rrugët e tilla do të shndërrohen në shetitore turistike me përmbajtje atraktive gjithnjë duke u bazuar në traditën e zejeve, të kombinuar me kërkesa të së sotmes. Vendosja e masave të tilla në rrjetin e itnegruar të trafikut do t'a ngriste cilësinë e jetesës të këtyre lagjeve



Avansimi i infrastrukturës ekzistuese – uji, energjetika, telekomunikimi - do të bazohet në resurset ekzistuese nëntokësore dhe mbitokësore të komunës duke i shfrytëzuar ato në mënyrë racionale me metoda më bashkëkohore dhe gjithnjë duke patur parasysh mbrojtjen e ambientit dhe mosshkatërrimin e këtyre resurseve. Plotësimi me kapacitete shtesë për infrastrukturë do të bëhet prej sistemeve të mëdha të rajonit. Ne parashofim një sistem të ri të integruar për infrastrukturë të re (uji, kanalizimi fekal dhe atmosferik, energjia elektrike, gasifikimi dhe fijet optike të telekomunikacionit) në të gjitha akset e reja rrugore dhe në

rrugët ekzistuese të cilat kërkojnë një rekonstruim të tërësishëm për t'i përmbushur kërkesat e reja. Menaxhimi i hedhurinave do të bëhet konform direktivave evropiane (psh. trajtimin e hedhurinave përmes sortimit, reciklimit dhe djegies)

Aktivitetet kulturore dhe të rekreimit do të zgjerohen aty ku ka nevojë, jo vetëm në të mirë të drejtpërdrejtë të banorëve ekzistues, por edhe për tërheqje të investimeve të reja, duke i bërë ato lokacione tërheqëse dhe të qëndrueshme gjë që do të rezultojë me një ekonomi kualitative. Këto aktivitete duhet të bazohen në traditën e Prizrenit dhe në potencialin të cilin e ka ky qytet. Arti publik do të integrohet në sheshe, ndërtesa dhe peizazh. Në synjmë një art publik origjinal, edukativ, të shkathhtë, të shëndoshë dhe me vlerë, si për zhvillimin ashtu edhe për jetën kulturore të Prizrenit

VI. QËLLIMET DHE SYNIMET E KËTIJ PLANI

1.22 Për të arritur këtë vizion, është formuluar në mënyrë të veçantë një numër i qëllimeve dhe i synimeve strategjike, të cilat mbështesin dhe paraqesin forma të qëndrueshme të zhvillimit. Secili qëllim i parashtruar prihet me synimet përcjellëse.

QËLLIMET	SYNIMET
Progresi social i cili njeh nevojat e secilit	<ul style="list-style-type: none"> - sigurimi i sipërfaqeve të destinuara që përmbushin nevojat e gjithë komunitetit, duke përfshirë banimin me kosto të ulët dhe atë me kërsa speciale; - zbutja e varfërisë dhe e mospërfshirjes sociale në fushat e nevojave të veçanta; - sigurimi i qasjes gjithëpërfshirëse nëpër shërbime në të gjitha sektoret e komunitetit, e veçanërisht për personat me aftësi të kufizuar, pleqtë dhe ata që jetojnë me ndihma sociale; - inkurajimi jetës së shëndoshë; - avancimi i mundësive për argëtim/rekreim; - zvogëlimi i krimit dhe i frikës nga krimi.
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore-historike	<ul style="list-style-type: none"> - edukimi dhe vetëdijësimi i qytetarëve për vlerat e trashëgimisë kulturore-historike të qytetit; - inkurajimi i mbrojtjes aktive të trashëgimisë kulturore dhe historike duke hapur kështu mundësi të reja për vende pune; - inkurajimi i turizmit kulturor-historik.
Ristrukturimi dhe avancimi i ekonomisë locale	<ul style="list-style-type: none"> - sigurimi i provizionit të tokës, ndërtesave dhe sistemeve të trafikut që i përgjigjet karakterit në ndryshim të ekonomisë lokale.

QËLLIMET	SYNIMET
Shfrytëzimi i kujdesshëm i resurseve natyrore dhe mbrojtja e ambientit	<ul style="list-style-type: none"> - mbrojtja dhe inkurajimi i mjedisit ekologjik; - shfrytëzimi ekonomik dhe efikas i tokës; - zvogëlimi i ndotjes dhe hedhurinave; - mbrojtja e gjelbrimit dhe qasja e lehtësuar në hapësirat e lira të gjelbërta.
Inkurajimi, koordinimi dhe integrimi i të gjitha modeleve të trafikut në interes të qëndrueshmërisë, përfshirjes së lehtë dhe sigurisë.	<ul style="list-style-type: none"> - përcjellja e sistemit të koordinuar të trafikut për të përmbushur nevojat ekonomike dhe sociale të Prizrenit - përmirësimi i lidhjeve për në vende të punës, dyqane, shërbime, vendrekreime, etj. përmes transportit publik, ecjes dhe çiklimit. - rritja e sigurisë në rrjetin e trafikut dhe e sigurisë personale të shfrytëzuesve të rrjetit. - zvogëlimi i ndikimeve të panevojshme ambientale në trafik. - zvogëlimi i nevojës për udhëtim, sidomos me vetura.
Kualitet i lartë i zhvillimit të ndërtimeve për banorët e Prizrenit	<ul style="list-style-type: none"> - sigurimi që zonat urbane të jenë të integruara, lehtë të arritshme, atraktive, të sigurta dhe funksionale.

VII. VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË

1.23 Suksesi i këtij plani do të duhej të matej duke vlerësuar barazpeshën në mes të presionit të rritjes që duhet akomoduar dhe të nevojës për mbrojtje dhe avancim të mjedisit njerëzor, gjegjësisht, mbrojtje dhe avancim të burimeve ambientale dhe promovim të mirëqenies sociale.


1.24 Kuvendi Komunal i Prizrenit bën vlerësimin e qëndrueshmërisë së Planit të vet të Përgjithshëm, ku si kërkesë shfaqet identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve ambientale, ekonomike dhe sociale, të shoqëruara me orientimet e këtij plani dhe orientimet tjera që dalin nga propozimet specifike zhvillimore.

1.25 Vlerësimi i qëndrueshmërisë luan rol të rëndësishëm në përgatitjen e Planit. Ky vlerësim qëndron në funksion të avancimit të kualitetit të rrethinës njerëzore në Qytetin e Prizrenit dhe mbështetet në dispozitat e Ligjit për Mbrojtje të Ambientit dhe Ligjit për Planifikim Hapësiror, si dhe në gjendjen ekzistuese dhe problemet e identifikuara të rrethinës njerëzore, mbështetur mbi të dhënat e sistemuara nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, nga



institucionet përkatëse që veprojnë në Kosovë pas luftës, nga Enti Statistikor i Kosovës, të dhënat/raportet e MAPH, si dhe nga grumbullimi i të dhënave. në terren.

- 1.26 Ky plan e shtron gjendjen ekzistuese të rrethinës njerëzore të Qytetit të Prizrenit gjatë hartimit të të gjitha fazave, gjegjësisht në kapitujt vijues të këtij plani. Njëherit, qëllimi i Kuvendit Komunal është vlerësimi i qëndrueshmërisë gjatë gjithë fazave të përpilimit të këtij Plani.



Qasjet e reja ndaj problemeve të qytetit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, nënkupton përmbushjen e kërkesave të gjeneratave të tanishme duke mos i rrezikuar mundësitë dhe nevojat e gjeneratave të ardhshme

KAPITULLI 2

PARASHIKIMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Ndyshimet politike, shoqërore dhe ekonomike të dhjetëvjetëshin e fundit në Kosovë paten ndikim stagnues në proceset zhvillimore shoqëro-ekonomike, e në veçanti në zhvillimin e industrisë dhe të shërbimeve publike. Proceset e dhunëshme integruese të përcjelluara me shkatërrimin dhe tjetërsimin e të mirave të krijuara, nga ana e rexjimit serb, dhe pas vitit 1999, mosdefinimi i çështjes pronësore, mungesa e investimeve si dhe amortizimi i teknologjisë ekzistuese, kanë shkaktuar ndërprerjen e plotë të proceseve zhvillimore me pasoja shumëvjeçare. Në këtë periudhë, në aspektin global kanë ndodhur edhe shumë ndryshime, si:

- Thellimi i proceseve integruese në mes shteteve evropiane dhe proceset dezintegruese në disa shtetet të Evropës juglindore, në veçanti në Ballkan. Në kuadër të këtyre ndryshimeve Kosova ka përjetuar transformime rrënjësore shoqëro-ekonomike duke kaluar nga paraliza e plotë politike dhe shoqërore në një gjendje të re të prosperitetit politiko-shoqëror.
- Sendërtimi i principeve të mbrojtjes së mjedisit të përcaktuar me deklaratën e Rio de Zhanerios (1992) dhe të shumë dokumenteve përcjellëse, qëllimi i të cilave është zhvillimi i qëdrueshëm, respektivisht, valorizimi harmonik i resurseve dhe afirmimi i vlerave lokale me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendosjen rreth çështjeve të zhvillimit në interes të tyre.

2.1 Zhvillimi i Prizrenit pas Luftës së Dytë Botërore, në veçanti gjatë planit urbanistik të Mandiqit, sidomos në pjesën qendrore të qytetit, duke përdorur fondet shtetërore, ka pasë për qëllim të zhvillimit të një të ashtuquajturë "strukture të re urbane" mbi

vlerrat e trashëguara ose tradicionale. Ndërtime të tilla ka pasur sidomos në pjesën e qendrës së qytetit duke filluar nga Hoteli Theranda deri te Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit, duke rezultuar me shkatërrim të bërthamës historike të qytetit. Kjo vlen edhe për ndërtimin e Shtepisë së Mallrave në vend të qendrës së vjetër zejtare, Shtepisë së Kulturës etj. Ndërtime nga e ashtuquajtura “strukturë e re urbane” ka pasur edhe në pjesë të tjera të qendrës së qytetit, të cilat shkaktuan humbje të pjesëve më karakteristike të trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Tani këto struktura qëndrojnë në disharmoni të theksuar me arkitekturën e vjetër të qytetit. Ky ndërtim “shtetëror” i asaj kohe është përcjellur edhe me ndërtime individuale, kryesisht jolegale, në qendër dhe në periferi të qytetit, duke mos e respektuar trashëgiminë, logjikën urbanistike dhe ligjëshmërinë. Sot, ndërtimet për banim dhe biznese private nuk i kursyen as zonat e gjelbërta dhe hapësirat tjera publike, duke e degraduar kështu mjedisin dhe duke e ulur kualitetin e jetës në qytetin e Prizrenit.

- 2.2 Kuvendi Komunal i Prizrenit njef faktin se trajtimi i zonave me vlera të trashëgimisë historike dhe kulturore, trajtimi i ndërtimeve ilegale në kontekstin e zhvillimeve të reja paraqet një detyrë sfiduese në kuptimin e parandalimit të parregullsive në fushën e urbanizmit, përfshirë këtu problematikën e infrastrukturës dhe të trafikut të tejngarkuar, dhe posaçërisht në ngritjen e vetëdijes qytetare lidhur me problematikën dhe pasojat që në vazhdimësi e degradojnë jetën publike

ORIENTIMI ZhQ 1 – LOKACIONET E QËNDRUESHME PËR ZHVILLIM TË RI

Qasjet e reja ndaj problemeve të qytetit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, nënkupton përmbytjen e kërkesave të gjeneratave të tanishme duke mos i rrezikuar mundësitë dhe nevojat e gjeneratave të ardhshme.

Ky plan ka për qëllim arritjen e zhvillimeve të reja të qëndrueshme. Orientimet e parashtruara në këtë kapitull janë orientime thelbësore strategjike përballë së cilave do të vlerësohen propozimet e shfrytëzimit madhor të tokave, të parapara me Plan. Çdo zhvillim i ri që implikon ndërtime të reja apo forma të ndryshme të intervenimeve në zhvillimet ekzistuese duhet t’a vazhdojë traditën e Prizrenit me koncepte bashkëkohore, në ndërkohë që të sigurojë zhvillim afatgjatë të kulturës në ambientin autokton dhe me specifika të ndryshme kulturore të qytetarve të Prizrenit.



Gjatë zgjedhjes së lokacioneve do të mirren parasysh këto kriteriume të qëndrueshmërisë:

- i. shtrirja strategjike e qytetit në mënyrë që të vendosen parakushtet për zhvillim të mëtutjeshëm të Prizrenit duke e vazhduar traditën e qytetit me lum që rrjedh nëpërmes, e që rezulton me zhvillim të konceptit të kombinuar;
- ii. trajtimi i lokacioneve brenda zonës urbane ekzistuese sidomos në qendrën e saj;

- iii. shfrytëzimi sa më i mirë i tokës për zhvillime të reja në funksion të zgjerimit të qytetit, duke siguruar arritjen e :
 - shfrytëzimit të kontrolluar të tokës bujqësore dhe të pyjeve në zonat periferike të qytetit;
 - parandalimit dhe trajtimit të ndërtimeve pa leje në kontekstin e zhvillimeve të reja;
 - iv. Konsolidimi i strukturave ekzistuese ekonomike përmes nxitjes së ristrukturimit dhe duke eliminuar interesat konfliktuoze në shfrytëzimin e hapsirës për këto qëllime
 - v. Krijimi i modeleve të qëndrueshme të zhvillimit duke i vënë në raport modalitetet e trafikut dhe të shërbimeve lokale dhe duke i inkurajuar iniciativat e trafikut të integruar;
 - vi. inkurajimi i zhvillimeve me destinim të përzier, duke përfshirë banimin, arsimin, shëndetësinë, shërbimet tjera publike, shoppingun, afarizimin dhe mundësitë e reja për rekreimit.
 - vii. Zhvillimi dhe kontrollimi i të sistemit të furnizimit me ujë të pishëm me qëllim të sigurimit të zhvillimit harmonik regjional dhe lokal si faze kalimtare të zhvillimit afatgjatë të sistemit të furnizimit me ujë të pishëm
 - viii. Kontrollimi i mbeturinave dhe ujrave të zeza duke siguruar përpunimin respektivisht reciklimin e tyre
 - ix. Promovimi dhe mbrojtja e mjedisit ekologjik në të gjitha propozimet zhvillimore me qëllim që të pengohet çdo degradim i ambientit jetësor në funksion të ruajtjes së potencialeve natyrore për gjeneratat e ardhshme,
- 2.3 Kuvendi Komunal i Prizrenit, para se gjithash, duhet të zgjedhë opcionin më të qëndrueshëm në dispozicion për vendosjen e hapësirave të reja në përputhshmëri me parimin e qëndrueshmërisë. Lokacionet vlerësohen përballë kriteriumeve në vijim:
- **Mundësia e shfrytëzimit të lokacioneve paraprakisht të zhvilluara** dhe të ndërtesave pjesërisht të shfrytëzuara si dhe qëndrueshmëria për ridestinim;
 - **Vendosja dhe lidhja e lokacioneve potenciale të zhvillimit të ri** me vendet e punës, dyqanet dhe shërbimet publike, në mënyra tjera përveç me vetura, si dhe potenciali për avancimin e një lidhjeje të tillë.
 - **Kapaciteti i infrastrukturës ekzistuese dhe asaj potenciale**, përfshirë këtu hapësirat e lira, ujësjellësin dhe kanalizimin, shërbimet tjera të infrastrukturës



sociale (si shkollat dhe spitalet), trafikun publik, në mënyrë që të mund të absorbohet zhvillimi i mëtejshëm si dhe kostoja e infrastrukturës shtesë;

- **Pengesat fizike dhe ambientale**, përfshirë këtu psh. nivelin e ndotjes, stabilitetin dhe rrezikun nga fatkeqësitë natyrore.

2.4 Sipërfaqja kadastrale e Qytetit të Prizrenit është **2926.5789 Ha**. Në përgaditje të këtij plani për periudhë deri në vitin 2013, Kuvendi Komunal i Prizrenit ka përcaktuar kufijtë e qytetit të Prizrenit të kushtëzuar nga qarkorja e propozuar, e cila rezulton me gjithsej **cca 3194 Ha** të territorit, dhe kjo sipërfaqe shpallet Territor Urban i Prizrenit. Territori urban i Prizrenit, me këtë plan fiton **cca 267.42 Ha** shtesë, prej ku rreth **cca 96.3 Ha** është sipërfaqe e Qarkores me Brez të gjelbër të Qytetit. Projektionet e këtij plani për periudhë 2003-2013 gjithashtu reflektojnë sipërfaqen e cila ka karakter të posaçëm për qëllime të Komunës me interes ndërkombëtar (cca 504.97 Ha).



- 2.5 Roli i këtij Plani është që të sigurojë që zhvillimet e reja të shkojnë drejt atyre lokacioneve që ofrojnë mundësitë për krijim të bashkësive lokale (njësive administrative) të qëndrueshme, gjithnjë duke qëndruar prapa orientimeve planifikuese të cilat janë vendosur për t'i mbrojtur ato pjesë të Prizrenit që janë të ndieshme ndaj presionit të zhvillimit dhe që nuk paraqesin zhvillim të qëndrueshëm të tipit që ky plan promovon.
- 2.6 Kualiteti i lartë i projektimit urban është poashtu i rëndësishëm në arritjen e zhvillimeve të qëndrueshme. Projektimi urban përkthen orientimet në krijim fizik të vendeve për jetë dhe punë. Qëllimi i tij është të kombinojë kualitetin ambiental me atë jetësor, ofron mjete për shfrytëzim sa më të mirë të tokës, siguron funksionim të mirë të zhvillimeve, si dhe bën lidhjen e strukturës me funksionet e vendbanimit. Poashtu ofron mjete për harmonizim të zhvillimeve të ndërtuara me ambientin natyror. Përvetësimi i qasjes së drejtuar nga projektimi urban do të thotë se zhvillimi është i dizajnuar për t'iu përgjigjur lokacionit të vet si dhe shfrytëzuesëve të tij. Ky plan përvetëson qasjen e drejtuar nga propozimet e projektuara dhe orientimet e veta për zhvillime të reja të qëndrueshme; orientimet e detajuara për kualitet në projektim urban janë të dhëna në Kapitullin 9 – “Arritja e Kualitetit”.
- 2.7 Orientimet për mbrojtje dhe promovim të mjedisit ekologjik janë të përfshira në Kapitullin 10 të këtij Plani “Mbrojtja Dhe Avancimi i Mjedisit”. Këto orientime sigurojnë mbrojtjen e natyrës dhe të interesave ekologjike dhe propozimet për

zhvillime të reja, mbështetur në këto orientime, përfshijnë masat për promovim dhe inkurajim të mjedisit ekologjik.

ORIENTIMI ZhQ 2 - GJETJA E LOKACIONIT NË MËNYRË QË TË REDUKOHET NEVOJA PËR UDHËTIM



Në përmbushjen e kërkesave për gjetjen e lokacioneve për zhvillime të reja, në këtë fazë të planit e edhe më tutje, Kuvendi Komunal i Prizrenit do të kërkojë që të gjitha propozimet për zhvillime të reja të kenë parasysh zvoglimin e nevojës për udhëtim. Me këtë qëllim, Kuvendi Komunal i Prizrenit vendos prioritetet në vijim lidhur me lokacionet e propozuara:

Lokacionet e Prioriteti të Parë

Zhvillimet brenda zonës qendrore – Qytetit të Vjetër të Prizrenit

Për qëllime të Orientimit ZhQ 2, Lokacionet me Prioritet -I- janë ato zona brenda Qytetit të Vjetër të Prizrenit të cilat janë në afërsi parësore me shërbimet kyçe dhe ku zhvillimet që kanë të bëjnë me rehabilitimin dhe rekonstruimin e lokacioneve të përcaktuara përforcojnë dhe përfitojnë në qëndrueshmërinë e zhvillimeve ekzistuese

Për qëllime të zonimit strategjik të qytetit të Prizrenit, këto lokacione janë identifikuar si **Tërësia Qendrore Orientuese.**



Lokacionet e Prioritetit të Dytë

Për qëllime të Orientimit ZhQ 2, Lokacionet me Prioritet -II- janë ato zona që shtrihen përreth lokacioneve të Prioritetit -I- ku zhvillimet e reja bazohen në kriteriumin 800m të

distancës këmbësorike nga kryqëzimet e trafikut më madhor publik dhe nga shërbimet lokale të vendosura në qendër të zonave urbane

Për qëllime të zonimit strategjik të qytetit të Prizrenit, këto lokacione janë identifikuar si **Tërësia Qarkore Orientuese**

- 2.8 Një vendbanim i suksesshëm dhe i qëndrueshëm përbëhet prej njerëzve të moshave të ndryshme, me strukturë nacionale, prejardhje dhe të ardhura të ndryshme. Si pjesë e stilit të jetës që kanë, ata bëjnë rrugëtime të ndryshme. Fëmijët udhetojnë për në shkollë. Më të moshuarit vizitojnë dyqanet dhe vendet për argëtim/rekreim. Një numër i banorëve bëjnë punë private në afërsi të shtëpive të tyre, prandaj rrallë udhetojnë me vetura. Një numër tjetër i banorëve bëjnë udhëtime të përditshme për të shkuar në vende të punës. Një tablo e udhëtimeve komplekse shpesh përfshin mënyra të ndryshme të udhëtimit. Synim kyç i planifikimit është ndërlidhja e vendeve të punës, shoppingut, shërbimeve publike dhe objekteve të argëtim, rekreimit përmes modaliteteve tjera të



trafikut përveç atij automobilistik, si: trafikut publik, shtigjet këmbësorike dhe të çiklizmit, etj. Kjo është e rëndësishme për të gjithë, e sidomos për ata që nuk e shfrytëzojnë rregullisht veturën, në mënyrë që të arrihet përfshirja sociale për të gjithë banorët.

- 2.9 Që të zvoglohet nevoja për udhëtime me vetura, zhvillimet e reja duhet të vendosen në distanca të përshtatshme të ecjes për në qendër si dhe në kryqëzimet të mira të trafikut publik. Ky fakt sygjeron se vendosja e banimit 800m (10 minuta) larg shërbimeve të qendrës urbane, i ofron njerëzve, për nevojat e tyre të përditshme, alternativa tjera të trafikut në vend të atij me vetura private.

- 2.10 Kuvendi Komunal i Prizrenit do të integrojë planifikimin e trafikut me planifikimin e tokës ndërtimore në mënyrë që të promovojë zhvillime të qëndrueshme. Kjo arrihet, në radhë të parë, duke e vendosur banimin e ri dhe zhvillimet tjera në mënyrat që zvogëlojnë nevojën për udhëtime të gjata. Kur nevoja për udhëtim shfaqet, kjo duhet të bëhet me mjete të udhëtimit më të sigurta, efikase dhe jondotëse. Kjo nënkupton shfrytëzim sa më të madh të ecjes në këmbë, biçikletave dhe trafikut publik si dhe zvogëlim të shfrytëzimit të veturave që ndikojnë në uljen e zhurmës, tollovisë dhe aksidenteve në trafik.



ORIENTIMI ZhQ 3 - LIMITIMI NË MADHËSINË E LOKACIONEVE TË REJA PËR ZHVILLIME TË PËRZIERA

Shkalla fizike e lokacioneve të reja për zhvillim të përzier do të limitohet me distancë të pranueshme të ecjes prej 800 m, e që nënkupton përfshirjen e të gjitha shërbimeve publike në kuadër të lokacioneve të banimit, duke formuar kështu bashkësi locale (Njësine Administrative) të propozuar me radius prej 800m si distancë këmbësorike e pranuar. Rrjeti i formuar i Njësive Administrative të propozuara do të harmonizohet me rrjetin e trafikut të integruar, rrjedhimisht, me kryqëzimet e trafikut publik dhe me shërbimet lokale të vendosura në qendrat e zonave urbane, të cilat do t'i shërbejnë zhvillimeve të reja.

2.11 Madhësia fizike e lokacioneve kryesore të reja, do të duhet të limitohet në përputhje me parimet e vendosura gjatë hulumtimeve për zvogëlim të nevojës për udhëtim me vetura. Kjo do të thotë se zhvillimet e reja nuk duhet ta tejkalojnë distancën prej 800m nga shërbimet e vendosura në qendër të këtyre njësive dhe në kryqëzimet kryesore të trafikut publik.

ORIENTIMI ZhQ 4 – INTENSIFIKIMI (DENDËSIA) I ZHVILLIMEVE



Në Tërësinë Qëndrore Orientuese, intensifikimi i zhvillimeve përfshirë këtu ndryshimin e destinimit do të trajtohet sipas rregullave të vendosura për trajtimin e lokacioneve të mbrojtura. Ndërkaq, brenda Tërësive Qarkore Orientuese, intensifikimi i zhvillimeve dhe destinimet/ridestinimet do të lejohen me kusht që:

- Zhvillimi e bën optimal kapacitetin e lokacionit; dhe
- Intenziteti i zhvillimeve të propozuara është kompatibil me shfrytëzueshmërinë, intenzitetin, shkallën dhe brendësinë e zonës përreth.

Kuvendi Komunal i Prizrenit do të vlerësoj sasinë dhe cilësinën e zhvillimeve përballë kriteriumit të parashtruar më sipër si dhe orientimeve dhe standardeve tjera të përfshira në këtë Plan.

Sasia e zhvillimit në një lokacion, duke përcaktuar intenzitetin e zhvillimit

	Tërësia Qendrore Orientuese			Tërësia Qarkore Orientuese
	- Zona I e mbrojtjes	- Zona II e mbrojtjes	- Zona e Kontaktit	TQO Veri / TQO Lindje / TQO Jug / TQO Perëndim
Niveli i dendësisë	100 banorë/Ha	100 banorë/Ha	100 banorë/Ha	250 banorë/Ha për banim të lartë 150 banorë /Ha për banim të kombinuar 50 banorë / Ha për banim të ultë
Etazhiteti	P+1 dhe P+2 Varësisht nga rregullat e vendosura për trajtimin e lokacioneve të mbrojtura	P+2	P+2 dhe P+3	P+5 - për banim të lartë P+1 deri P+3 - për banim të kombinuar P+2 - për banim të ultë
Maksimum vendparkingje	parkimi rezidencial - varësisht nga situimi dhe raporti ndaj objekteve dhe komplekseve nën mbrojtje	parkimi rezidencial - (varësisht nga situimi dhe raporti ndaj objekteve nën mbrojtje	parkimi rezidencial - (varësisht nga situimi dhe raporti ndaj objekteve nën mbrojtje	parkimi rezidencial – Për banim të Lartë: 1.5 vendparkingje/ banesë me 1-2 dhoma gjumi 1 vendparking/ banesë me mbi 2 dhoma gjumi Për banim të ultë: 1 vendparkim/1 shtëpi
	Parkimi jorezidencial ndryshon në varshmëri me tipin e zhvillimit	Parkimi jorezidencial ndryshon në varshmëri me tipin e zhvillimit	Parkimi jorezidencial ndryshon në varshmëri me tipin e zhvillimit	Parkimi jorezidencial ndryshon në varshmëri me tipin e zhvillimit
Shih Shtojcën 3				
Hapësira publike të hapura	Do të aplikohen Standardet e përfshira në Orientimin KOM I1	Do të aplikohen Standardet e përfshira në Orientimin KOM I1	Do të aplikohen Standardet e përfshira në Orientimin KOM I1	Do të aplikohen Standardet e përfshira në Orientimin KOM I1
Shih Orientimi KOM 11				
Hapësira private fleksibile	Standardet minimale me përjashtim të rasteve speciale	Standardet minimale me përjashtim të rasteve speciale	Standardet minimale me përjashtim të rasteve speciale	Do të aplikohet maksimumi i standardeve
Shih Shtojcën 4				



Cilësia e zhvillimit në një lokacion

	Tërësia Qendrore Orientuese			Tërësitë Qarkorte Orientuese
	- Zona I e mbrojtjes	- Zona II e mbrojtjes	- Zona e Kontaktit	Z. V Prizren / Z. L Prizren / Z. J Prizren / Z. P Prizren
Format e ndërtimit	Fasadë frontale në varg që definojnë hapësirat publike autonome, dhe Front minimal për hapësirat private	Fasadë frontale në varg që definojnë hapësirat publike autonome, dhe Front minimal për hapësirat private	Fasadë frontale në varg që definojnë hapësirat publike autonome, dhe Front minimal për hapësirat private	Fasadë frontale në varg që definojnë hapësirat publike autonome, dhe Front minimal për hapësirat private
Forma e hapësirave publike	Hapësira të hapura urbane, si sheshet dhe parqet e vogla	Hapësira të hapura urbane, si sheshet dhe parqet e vogla	Hapësira të hapura urbane, si sheshet dhe parqet e vogla	Hapësira të hapura urbane, si sheshet dhe parqet e vogla
Hapësira private	Kopshte, patio, ballkone, oborre të prapme	Kopshte, patio, ballkone, oborre të prapme	Kopshte, patio, ballkone, oborre të përbashkëta, oborre të prapme	Kopshte, patio, ballkone, oborre të përbashkëta, oborre të prapme
Formati i parkingjeve	Nëntokësore, të mbuluara, oborre të prapme parkimi,	Objekte parkimi, nëntokësore, të mbuluara, oborre të prapme parkimi, sheshe parkimi	Objekte parkimi, nëntokësore, të mbuluara, oborre të prapme parkimi, rrugë parkimi, sheshe parkimi	Objekte parkimi, nëntokësore, të mbuluara, oborre të prapme parkimi, rrugë parkimi, sheshe parkimi

2.12 Kuvendi Komunal i Prizrenit ka vlerësuar se çfarë kuptimi ka intensifikimi urban për karakterin e lokacioneve të reja, për kualitetin e jetës së banorëve dhe të punëtorëve dhe për raportin në mes të zonave urbane të Prizrenit si dhe të zonave urbane me rrethinën ekzistuese. Intensifikimi i suksesshëm urban përfaqëson një numër të synimeve që lidhen me planifikim, për të siguruar që zhvillimi qytetit të Prizrenit të përmbajë një strukturë të projektuar për dendësi të banorëve (100 banorë / 1 Ha, në Tërësinë Qendrore Orientuese, si dhe: 50 ban/ha –banimi i ultë, 150 ban/ha – banimi i kombinuar dhe 250ban/ha – banimi i lartë, në Tërësitë Qarkore Orientuese). Shfrytëzimi maksimal i potencialit të tokës urbane të zhvilluar paraprakisht dhe asaj të propozuar për zhvillim, paraqet gurëthemelin e këtij Plani. Kjo arsye strategjike qëndron jo vetëm në shërbim të zvogëlimit të ndikimit të zhvillimeve nëpër rrethinë, por edhe në funksion të gjenerimit të popullatës urbane, nevojat e së cilës



mbulohen me përmes trafikut të integruar dhe të përfshirjes së shërbimeve publike në skema të destinimeve të përziera.

2.13 Kuvendi Komunal i Prizrenit është për qasje inovative për vendparkingje, hapësira të lira publike dhe aso private fleksibile, që i trajtojnë kërkesat e orientimeve për zonat, ashtu që të krijohet kualitet i qëndrueshëm.

2.14 Brenda zonës qendrore të Prizrenit, duhet pasur kujdes që banimi ekzistues, shërbimet publike, dyqanet, etj. të vazhdojnë të mbajnë vitalitetin e qendrës së qytetit. Kuvendi Komunal i Prizrenit inkurajon zhvillime të intensifikuara të banimit dhe të destinimeve të përziera në disa lokacione të Tërësive Qarkore Orientuese. Kuvendi gjithashtu synon që Vendbanimet e Definuar të jenë të integruara në zhvillime të reja për të fuqizuar rolin dhe identitetin e vendbanimit dhe për t'i inkorporuar ato në zhvillimin e përgjithshëm të Tërësive Qarkore Orientuese të Prizrenit.



ORIENTIMI ZhQ 5 - PROMOVIMI I LOKACIONEVE ME DESTINIM TË PERZIER

Pavarësisht nga lokacioni i zhvillimeve, objektivat për destinim të përzier janë:

- më pak udhëtime,
- shërbime lokale praktike dhe,
- shpërndarje ekonomike dhe rrugë më të sigurta

Kuvendi Komunal i Prizrenit inkurajon përzierje të destinimeve komplementare dhe kompatible në të gjitha propozimet për zhvillim.

Brenda Tërësisë Qendrore Orientuese të Prizrenit, Kuvendi Komunal i Prizrenit synon:

- i. mbrojtjen e karakterit të destinimeve të përziera ekzistuese;
- ii. në Zonën I dhe II të Mbrojtjes, mbrojtjen e destinimeve ekzistuese jorezidenciale dhe ridestinimin në mënyrë që të avancohet karakteri i destinimeve të përziera, sipas propozimeve të dhëna në zonave të mbrojtura;
- iii. në Zonën e Kontaktit, inkurajimin e destinimit të përzier jorezidencial në pjesët frontale të përdhësës së objekteve ekzistuese të banimit, në rrugët që kanë karakter dominues jorezidencial; dhe

Në Tërësitë Qarkore Orientuese, Kuvendi Komunal i Prizrenit do të:

- i. **Kërkojë që në shumicën e zhvillimeve rezidenciale, të përfshihet akomodimi jorezidencial i përshtatshëm si dyqanet, shërbimet, apo vendet e vogla të punës, të vendosura për qëllim të përmbushjes së nevojave të shtuara të gjithë lagjes si tërësi; dhe**
- ii. **Lejojë zhvillime jorezidenciale me kusht që të mos veket në pikëpyetje autonomia, funksioni apo karakteri i zonës.**

2.15 Afërsia në mes të destinimeve të ndryshme të lokacionit zvogëlon numrin e udhëtimeve që qytetarët bëjnë për në punë, shtëpi apo dyqane, gjë që i kontribuon qëndrueshmërisë ambientale. Lidhjet në mes të zonave të banimit, objekteve publike, dyqaneve etj., i sjellin shërbimet esenciale afër shtëpive të banorëve gjë që është më e përshtatshme dhe me çka avansohet ekonomia lokale. Zonat me destinime të përziera gjithashtu ndihmojnë në ngritjen e aktivitetit të këmbësorisë gjatë ditës dhe në përmirësimin e kushteve të sigurisë së komunitetit.



2.16 Natyra e destinimeve të përziera ndryshon varësisht nga lokacioni. Llojlojshmëria e destinimeve rritet dhe distribuimi fizik i tyre bëhet më i koncentruar në drejtim radial prej qendrës së qytetit drejt tërësive qarkore. Te Tërësitë Qarkore Orientuese, përgjatë rrugëve kryesore në drejtim të Gjakovës, Prishtinës, dhe Kukësit, destinimet e përziera konsiderohen të jenë të arsyeshme në front me rrugën ose si të grupuara në mënyrë lokale.

2.17 Këto orientime kanë për qëllim të sigurojnë që zhvillimet e reja në Prizren të përfshijnë destinime më të përshtatshme për funksionim të zonës brenda së cilës këto zhvillime janë të vendosura. Destinimi i përzier nuk është e thënë të konsiderohet për secilin zhvillim, por është i dëshirueshëm aty ku zona varet nga aktivitetet komplementare rezidenciale dhe jorezidenciale.

2.18 Që një mjedis me destinime të përziera të jetë një vend atraktiv për jetë dhe punë, është e rëndësishme që të ushtrohet një kontroll i kujdesshëm në ndryshimet apo zhvillimet e reja, për të siguruar që konfliktet në mes të destinimeve të ndryshme të jenë të zvogëluara deri në minimumin e pranueshëm. Kuvendi Komunal i Prizrenit do të konsiderojë kompatibilitetin e destinimeve të ndryshme, lokacionin e hyrjeve, nevojat për shërbimet dhe për fleksibilitet për secilin destinim. Ai gjithashtu do të sigurojë që destinimet dhe aktivitetet e ndryshme brenda lokacionit dhe më gjerë, të

përkrahin njëra tjetrën në mënyrë pozitive. Destinimet e pranueshme, në cilindo rast, në praktikë, do të kontrollohen më me kujdes për arsye të ruajtjes së karakterit fizik të zonës apo për të adresuar aspekte specifike ekonomike të identitetit të saj lokal.

2.19 Për destinimet e përziera në lokacionet qendrore, do të kërkohet skemë e zhvillimeve, në mënyrë që ato të reflektojnë rregullat e vendosura për trajtim të lokacioneve të mbrojtura. Në vende tjera, zhvillimet mund të kenë destinime tjera duke i vendosur në përdhësë të ndërtesave si të ndryshme nga destinimet e etazheve tjera, si të bashkangjitura njëra me tjetrën ose duke e komplementuar (plotësuar) destinimin ekzistues fqinj.

2.20 Kuvendi Komunal i Prizrenit shkon kah promovimi i mjedisit të gjallë dhe atraktiv përmes destinimeve që kanë përkrahje të ndërsjellë, duke:

- promovuar zhvillim intensiv të lokacioneve në zonat qarkore për t'i arritur avantazhet e afërsisë me trafikun dhe me shërbimet;
- avancuar kualitetin e mjedisit lokal në zonat qarkore duke fuqizuar identitetin e zonave individuale;
- promovuar skema të destinimit të përzier si më të preferuara nga skemat me një destinim
- avancuar komunikimet në mes të shtëpive, shërbimeve publike, vendeve të vogla të punës dhe dyqaneve;
- promovuar "ekonominë 24 orëshe" aty ku ka aktivitete të ndryshme që zhvillohen gjatë ditës dhe natës;
- mbrojtur vitalitetin e zonave të shoppingut
- promovuar një varg shërbimesh më të mira të argëtimit/rekreimit, arsimit etj., për banorët lokal dhe për vizitorët; dhe
- inkurajuar një varg të tërë të destinimeve afariste



2.21 Kuvendi Komunal i Prizrenit njef faktin se ana praktike e përfshirjes së destinimeve tjera në kuadër të propozimeve zhvillimore varet nga madhësia e skemës dhe nga pengesat fizike në lokacion.

2.22 Qasja e planifikimit fleksibil e përfshirë në këtë orientim është fundamental për përmbushjen e kërkesave të këtij Plani për vende të vogla të punës. Në kushtet e sotme të riprofilimit ekonomik të Prizrenit synohet që punësimi tradicional në prodhimtari të merr kahje të zhvillimit të qëndrueshëm të aglomeracionit urban në ndërkohë që do të hapen mundësi të reja për vende të vogla të punës me punësim në sektorin e tregëtisë, turizmit dhe në shërbimet si shëndetësia, arsimit, administrata

etj. Këta sektorë të punësimit janë gjithandej të përshtatshëm brenda zonave me destinim të përzier.

- 2.23 Për të siguruar prezencën e qëndrueshme të destinimeve jorezidenciale në zhvillime të mëdha rezidenciale, akomodimi do të duhej tu përgjigjet kërkesave për ndryshim të kushteve të tregut. Kuvendi Komunal i Prizrenit do të kërkojë që hapësirat të dizajnohen ashtu që të jetë i lehtë adaptimi në mes të afarizmave apo destinimeve të ndryshme komunale, me destinim të lejuar fleksibil.



Kërkesat e Kuvendi Komunal për zhvillim të përzier në lokacione të ndryshme

	Tërësia Qendrore Orientimore: (rikonstruimi, rehabilitimi i zonës qendrore)	Tërësitë Qarkore Orientuese: (ndërtim i ri dhe rikonstruim i Vendbanimeve të Definuar të cilat posedojnë PDU)
Lokacioni	Zonat në afërsi parësore me transportin publik dhe me të shumtën e shërbimeve publike Zonat brenda 800m të distancës këmbësorike nga transporti publik dhe e shumta e shërbimeve publike	Qendrat fqinje në afërsi parësore me dyqanet lokale, shërbimet dhe bus-stacionet për në qendër të qytetit të vjetër Zonat brenda 800m nga qendra fqinje dhe nga bus-linja për në qendër të qytetit
Llojet tipike të aktiviteve	Banimi individual Vende të vogla dhe mesatare pune Argëtim/Rekreim/tregëti Njësi të Klasit A të vogla dhe të mesme Shërbime komunale Arsimi/Shëndetësia	Banimi i kombinuar Vende të mëdha pune Vende të vogla dhe mesatare të punës Argëtim/Rekreim/hotele Njësi të Klasit A të vogla dhe të mesme Shërbime komunale Arsimi/Shëndetësia
Forma e destinimeve të përziera	Kryesisht përzierje horizontale e komponenteve të vendpunësimit dhe banimit. Shërbimet e koncentruara në frontet e rrugëve kyçe. Lidhje e ngushtë brenda vendeve të punës dhe banimit	Kryesisht përzierje vertikale brenda shemës për zonat tjera përveç banimit individual, Njësitë industriale dhe depotë të ndara nga zonat e banimit
Synimet orientimore për destinim të përzier	Mbrojtja e destinimeve të përziera ekzistuese, sidomos zejet tradicionale Ridestnimi për qëllime të arrijtjes së destinimeve të përziera të balancuara Vitaliteti dhe siguria në rrugë Definimi i lokacioneve fokusale për dyqane dhe shërbime që i shërbejnë lokalitetit Proporcione të rëndësishme të vendeve të punës	Destinimet e Përziera, sidomos të shërbimeve lokale Promovimi i destinimit të përzier në të gjitha shemat Inkurajimi i banimit në etazhet mbi përdhesë / Përdhesat jorezidenciale Vitaliteti dhe siguria në rrugë Definimi i lokacioneve fokusale për dyqane dhe shërbime që i shërbejnë tërë rrethinës Fuqizimi i qendrave më të afërta të zonës Urbane Destinimet kompatible me autonomitë rezidenciale Zhvillimet e mëdha të përfshijnë qendrat e reja të Zonës Urbane

ORIENTIMI ZhQ 6 - NDARJA E NDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT NË FAZA

Kuvendi Komunal i Prizrenit synon shfrytëzimin më të mirë të mundësive për zhvillimin e tokave paraprakisht të zhvilluara brenda Qytetit të Prizrenit, gjegjësisht Zonës Qëndrore Orientimore, si dhe tokave të pazhvilluara më parë, Zonat Qarkore Orientimore, duke:

- Përgatitur analizat e zhvillimit
- Punuar në bashkëpunim me institucione tjera
- Përcaktuar lokacionet me interes të posaçëm për nevojat e Kuvendit Komunal.

2.24 Vlerësimi i përafërt i gjendjes ekzistuese vë në rend të parë zhvillimin e lokacioneve paraprakisht të zhvilluara (përfshirë trajtimin e ndërtimeve ilegale) që nënkupton edhe rishfrytëzimin e ndërtesave apo konvertimin/ndërrimin të destinimit të tyre, për të vazhduar me zhvillimet madhore në Zonat Qarkore Orientimore, në lokacionet e pandërtuara. Që të arrihet një gjë e tillë, do të vendosen orientimet për ndarje në faza që do të përcaktojnë fazat e zhvillimit dhe afatet për lëshim të lokacioneve. Fjala “lëshim” I referohet fillimit të zhvillimeve fizike në punishte. Kuvendi Komunal i Prizrenit do të përcaktojë dinamikën e realizimit të të gjitha orientimeve të këëtij plani, sipas prioriteteve të Kuvendit Komunal.




KAPITULLI 3

ZONIMI STRATEGJIK I QYTETIT




Zonimi strategjik i Qytetit të Prizrenit është bërë në tri aspekte funksionale, në vijim:

- **Zonimi Urb-Territorial** (zonimi në tërësi, zona, nënzona dhe zona të veçanta)
- **Zonimi Administrativ** (i bashkësive lokale në njësi administrative)
- **Zonim Territorial-Historik** (sipas zhvillimi territorial nëpër epoka historike)




3.1 **Zonimi Urb-Territorial** nënkupton zonimin e Qytetit të Prizrenit në tërësi territoriale: qëndrore dhe qarkore, definimin e tyre në zona dhe nënëzona i dhe përcaktimin e zonave të veçanta. Në këtë kapitull, zonimi Urb-Territorial do të elaborohet në nivelin e Tërësive Qarkore Orientuese, përfshirë Zonat e veçanta. Trajtimi i zonave dhe nënzonave të Tërësisë Qëndrore Orientuese janë të dhëna në Kapitullin 5 “Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore”



Zonimi Administrativ nënkupton ridizajnimin e Bashkësive Lokale (Njësive Administrative) konform parimit të distancës së pranueshme të ecjes – radiusi 800 m, që rezulton me një territor standard për një Njësi prej mesatarisht cca 150 Ha. Rrjeti i formuar i Njësive Administrative të propozuara është harmonizuar me tërësitë territoriale të qytetit duke formuar kështu një strukturë komplekse të zonave të banimit dhe të zonave të veçanta, në përputhje me standardet planifikuese të zbatueshme për destinimet jorezidenciale, të pranishme në nivelin e Njësive Administrative dhe nën-njësive të saj, në nivel të Tërësive Orientuese dhe në nivelin e Qytetit.




Bashkësitë Lokale ekzistuese,
Qyteti i Prizrenit 2003



Ristrukturimi BL në Njësi Administrative
sipas Ndarjes Urb-Territoriale
Prizren 2003-2013

3.2 **Zonimi Territorial-Historik** - Zhvillimi territorial i Prizrenit nëpër epoka historike është dhënë në kapitullin 5 “Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore”. Harta “Zhvillimi Territorial Historik i Qytetit” nëpër epoka sygjeron zgjerimin e qytetit në të gjitha drejtimet përveç atij jug-lindor (në drejtim të Kalasë).



-  ANTIKA shek. II
-  BIZANTI shek. V
-  MEËJETA deri në shek. XIV
-  MEËJETA E VONË shek. XVII/XVIII
-  Shek. XVIII/XX
-  Shek. XX...

Harta e zhvillimit
territorial të Prizrenit nëpër epoka
historike

3.a ZONIMI URB - TERRITORIAL

Për qëllime strategjike të zhvillimit të përgjithshëm të Qytetit të Prizrenit, ky Plan e parashef Zonimin Urb-Territorial në:

A. Tërësia Qëndrore Orientuese

B. Tërësi Qarkore Orientuese

3.1 **Tërësia Qëndrore Orientuese** – përfshin pjesën qendrore ekzistuese urbane të Prizrenit, të koncipuar si Qyteti i Vjetër i Prizrenit (QVP). Për qëllime strategjike të mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore-historike, Qyteti i Vjetër i Prizrenit është ndarë në tri zona të mbrojtjes:

I. Zona 1 e Mbrojtjes

II. Zona II e Mbrojtjes

III. Zona e Kontaktit

3.2 Nënzona kryesore të Qytetit të Vjetër të Prizrenit janë komplekset dhe objektet e trashëgimisë si:

	I. Zona I e Mbrojtjes	II. Zona II e Mbrojtjes	III. Zona e Kontaktit
Tërësia Qëndrore Orientuese	<ul style="list-style-type: none"> - Kalaja - Kompleksi i Marashit, LSHP dhe Kurila - Kompleksi I Hamamit - Kompleksi I Teqes Halveti, Rruga e Saraçëve dhe ansambli banimi - Kompleksi I Shën Premtes, Hamamit, Kulla Sahatit dhe shtëpia Shehzade - Kompleksi I Katedrakës katolike - Kompleksi I Shatërvanit - Komplekset e banimit, Nënkalaja, Pantella dhe ... 	<ul style="list-style-type: none"> - Kompleksi i Tabahanës - Kompleksi i Karabashit 	<ul style="list-style-type: none"> - Kompleksi I gjimnazit "Gjon Buzuku"

3.3 **Tërësitë Qarkore Orientuese** – janë zonat që shtrihen përqark Tërësisë Qëndrore Orientuese dhe përbëhen prej zhvillimeve të reja të propozuara me plan dhe pjesëve ekzistuese të Prizrenit që në fakt janë Vendbanime të Definuar (posedojnë plan rregulativ). Zhvillimet e reja të banimit janë të bazuara mbi parimin e zhvillimit të përzier që nënkupton përfshirjen e destinimeve tjera siç janë shkollat, qendrat e mjekësisë familiare, hapësirat e lira dhe shërbimet tjera publike në kuadër të zonave të banimit. Për qëllime strategjike është shfrytëzuar rrjeti ekzistues i rrugëve magjistrale: Prizren-Gjakovë, Prizren-Prishtinë, Prizren-Brezovicë dhe Prizren-kufiri shqiptar, prandaj edhe është bërë ndarja strategjike e Prizrenit në katër Tërësi qarkore orientuese:

- IV. Tërësia Qarkore Orientuese – Prizreni Veri
- V. Tërësia Qarkore Orientuese – Prizreni Lindje
- VI. Tërësia Qarkore Orientuese – Prizreni Jug
- VII. Tërësia Qarkore Orientuese – Prizreni Perëndim


3.4 Nënzonat e Tërësive Qarkore Orientuese përfshijnë pjesët te vendbanimeve të reja të projektuara me Plan, Vendbanimet e Definuar që kanë Plan Rregullativ Urbanistik dhe Pjesë të Vendbanimeve Rurale brenda kufirit të ri të qytetit të Prizrenit, si dhe zonat jorezidenciale të cilat nënkuptojnë zonat me destinim të caktuar të koncipuara si zona të veçanta si, industria, rekreimi, parqet, dhe zonat e rezervuara nga Kuvendi Komunal i Prizrenit për nevoja të KFOR-it:

ZONAT	Vendbanimet e Definuar		Nënzonat Jorezidenciale	Vendbanimet e Reja - destinim i përzier
	Vendbanimet e Definuar që kanë PDU – (VD)	Tokat e fshatrave brenda kufirit të ri të qytetit – vendbanimet Rurale (VR)		
Prizreni Veri	- Ortakoll - Lakuriqi Veri.	- Arbana (%) - Theranda	- Z. Tregti dhe Industri e Vogël - Komp. Rekreimit - Z. e rezervuar nga KKP për KFOR-in - Gjelbrim /për zgjerim eventual të KFOR-it	Të gjitha zonat e reja rezidenciale brenda kufirit të ri të qytetit
Prizreni Lindje	- Dardania	- Luginishtë - Shpatina	- Parku i Marashit - Z. e rezervuar për KFOR	
Prizreni Jug	- Tusus	- Hoça e Qytetit	- Parqet e qytetit (A, B) - Qendra e Re e Qytetit	
Prizreni Perëndim		- Arbana (%) - Vllashi	- Z. industriale – zone e lirë - Terminali Kryesor	

3.5 **Zonat e Veçanta** janë lokacioneve brenda Tërësive Orientimore të Prizrenit që përmbajnë zhvillime ekzistuese apo të reja me karakter të veçantë:

1. Qendra e Vjetër e Qytetit (QVP)
2. Qendra e Re e Qytetit (QRP)
3. Zonat industriale
4. Korridori i Qarkores me Brez të Gjelbër
5. Kompleksi i Rekreimit
6. Terminali Kryesor
7. Zona e Lumbardhit (Shtrati me dy brigjet e Kejtit të lumit Lumbardh)
8. Kompleksi i Spitalit 10.8ha
9. Varrezat , etj.

ORIENTIMI ZS 1 - TËRËSIA QËNDRORE ORIENTUESE DHE TËRËSITË QARKORE ORIENTUESE



A. Tërësia Qëndrore Orientuese e Qytetit të Prizrenit

3.6 Tërësia Qëndrore Orientuese është definuar si zonë e cila përmban shumicën e shërbimeve të qendrës së qytetit dhe përfshin zonën ekzistuese urbane të Prizrenit. Si e tillë, Tërësia Qëndrore Orientuese paraqet një strukturë të tërë të vlerave të rëndësishme të trashëgimisë kulturore-historike. Në bazë të analizave të gjertanishme të strukturës së mbetur të Prizrenit, kjo zonë, për qëllime strategjike të mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore-historike, ndahet në dy zona të mbrojtjes e rrethuar me zonën e tretë – zonën e kontaktit - e cila do të ketë trajtim përkates.


3.7 Zona e parë e mbrojtjes

proponohet të jetë ajo pjesë e qytetit të vjetër e cila i ka të ruajtura lagjet historike që karakterizohen me fizionominë e tyre të veçantë, rrjetën e rrugëve, sheshet, komplekset me rëndësi kulturore dhe historike dhe shumë objekte sakrale dhe profane me interes të lartë arkitektonik si pjesë fundamentale të trashëgimisë



historike dhe kulturore të Prizrenit. Duke patur parasysh faktin se kjo pjesë i është nënshtruar proceve negative të transformimit është e nevojshme që të hartohen planet për ruajtjen, rehabilitimin dhe ristrukturimin e saj në kuptim të integritimit në rrjedhat bashkëkohore

3.8 **Zona e dytë e mbrojtjes** do të përfshinte pjesët e qytetit të vjetër me integritet më të vogël urbanistik dhe arkitektonik por i cili mund të identifikohet si sistem i tërësishëm urban dhe i cili detyrimisht kërkon forma të koordinuara të veprimit.



3.9 **Zona e kontaktit** propozohet të jetë zona që në fakt paraqet “tampon” zonën në mes të kufirit të pjesës së vjetër të mbrojtur dhe zonave të reja të qytetit. Aktualisht kjo zonë ka përjetuar mjaftë ndryshime duke i mbajtur vetëm ca elemente të vleshme urbane. Si e tillë është e nevojshme të trajtohet në mënyrë që të vendoset harmoni më e madhe e strukturave në aspektin fizik dhe vizuel të këtyre dy zonave.


3.10 Sëkëndejmi, strategjia e Kuvendit Komunal të Prizrenit është mbrojtja e banimit ekzistues në suaza të zonave të propozuara të mbrojtjes me tendencë që të shkarkohet qendra e qytetit të Prizrenit. Janë paraparë zonat e reja urbane me kapacitet optimal urban në mënyrë që të përmbushen nevojat për banim. Kërkohej banim i mjaftueshëm, përfshirë banimin me kosto të arritshme, duke preferuar zhvillimet me destinime të përziera, duke zvogëluar nevojën për udhëtim me vetura dhe duke inkurajuar forma të qëndrueshme të zhvillimit, përfshirë këtu shemat e destinimeve të përziera me çka u mundësohet banorëve të jetojnë dhe të punojnë në afërsi të shërbimeve publike kyçe.



TËRËSIA ORIENTUESE QENDËR 2003-2013 DESTINIMI I SIPËRFAQEVE		[Ha]	Total {Ha}	Nr. Banorëve për dendësi 100ban/ha
Zona I e mbrojtjes			42.697	4270
	Banim i Ulët + O. Publike – ekzistuese	41.88		4187.67
	Banim i Lartë + O.Publike - ekzistuese	0.82		82
Zona II e mbrojtjes			48.473	4263
	Banim i Ulët + O. Publike - ekzistuese	42.34		4234
	Banim i Lartë + O.Publike - ekzistuese	0.28		29
	Zonë e veçantë	5.84		0
Zona e Kontaktit			99.049	9905
	Banim i Ulët + O. Publike - ekzistuese	98.31		9831
	Banim i Lartë + O.Publike - ekzistuese	0.74		74
Gjithsej Zonat e Mbrojtjes			190.22	18730

B. Tërësitë Qarkore Orientuese e Qytetit të Prizrenit

3.11 Ndarja e zhvillimeve të reja në Tërësi Qarkore është bërë në funksion të implementimit në faza të zhvillimeve të qëndrueshme, gjë që Kuvendi Komunal i Prizrenit e përcakton si parakusht të rëndësishëm në definimin e strategjisë zhvillimore të qytetit. Lokacionet e reja zhvillimore të qytetit të Prizrenit janë ndarë në katër zona të reja urbane. Në



Në kuadër të këtyre lokacioneve të reja hyjnë edhe Vendbanimet e Definuar të cilat kanë Plan Rregullativ Urbanistik dhe të cilat përmbajnë shërbime ekzistuese. Këto lokacione janë ridefinuar në kontekstin e zonave të reja urbane të Prizrenit, duke formuar tërësi të reja për qark Tërësisë Qëndrore Orientuese, të propozuara si **Tërësitë Qarkore Orientuese** - Tokat në Veri, Lindje, Jug dhe Perëndim të Prizrenit.

3.12 **Tokat në Veri të Prizrenit** - Ky lokacion përfshihet në pjesën e tokës së haptë në veri të zhvillimeve ekzistuese të Prizrenit dhe 20% të fshatit Therandë (Petrovo Sellë). Ky lokacion ndodhet brenda qarkores i cili nga i njëjti është i izoluar me rrip gjelbrues me gjërësi 60m. Lokacioni përfshin zonën e përcaktuar për destinime të përziera të tregtisë dhe industrisë së vogël, zonën e përcaktuar për Kompleks të Rekreimit, zonat e banimit të lartë dhe të ultë si dhe sipërfaqen e gjelbruar e cila njëherit rezervohet nga Kuvendi Komunal i Prizrenit për nevoja të zgjerimit eventual të KFOR-it. Kuvendi Komunal e mbështet faktin se Plani i Pergjithshëm do të duhej të ketë në konsideratë nevojën e banorëve të “gjeneratës së dytë” dhe për vende të punës në qytetin e Prizrenit.




3.13 Zhvillimi i kësaj zone do të ndihmonte mirëmbajtjen e një varg shërbimeve që janë në dispozicion brenda qytetit. Përfshirja e vendbanimit të Dardanës (Dushanovës) në qytetin e Prizrenit, do të avancojë standardin dhe cilësinë e jetesës së banorëve të atij vendbanimi me trajtimin e ndërtimeve të egra dhe me rregullimin e infrastrukturës urbane të asaj zone. Përfshirja e shërbimeve të reja, shoppingut, rekreacionit si dhe vendeve të vogla të punës në kuadër të sipërfaqeve me destinim banimi, do të përmbushte nevojat e banorëve të tanishëm dhe atë ardhshëm të kësaj Tërësie.

Pasqyra e hektarëve të përcaktuar për secilin lokacion për zhvillime të reja në Tërësinë Qarkore - Veri bazuar në dendësinë e projektuar të banorëve dhe në numrin e banorëve për zonat, është dhënë në tabelën në vijim:

TËRËSIA ORIENTUESE VERI 2003-2013 DESTINIMI I SIPËRFAQEVE	[Ha]	Dendësia	Nr. Banorëve për dendësi 100ban/ha
Njësitë Administrative (1-5) Veri			
Banim i Ulët + O. Publike - ekzistuese	112.12	50 ban/ha	5606
Banim i Lartë + O.Publike - ekzistuese	10.04	250 ban/ha	2510
Zhvillim i Ri (banim i ultë)	241.80	50 ban/ha	12090
Zhvillim i Ri (banim i lartë)	138.74	250 ban/ha	34685
Ridestnim (banim i lartë)	3.83	250 ban/ha	957.5
Ridestnim (gjelbrim)	3.73	0	0
ZV Tregëti & Industri	110.64	0	0
ZV Kompleks Rekreimi	85.05	0	0
Kazerma Ushtarake	29.87	0	0
Gjelbrimi	301.93	0	0
Gjithsej TOV	1037.75		55849

3.14 Tokat në Lindje të Prizrenit – Zona në Lindje të Prizrenit ofron mundësi për zhvillime të reja. Kjo zonë përfshihet në pjesën e tokës së haptë në lindje të Prizrenit, 10% të fshatit Lugishtë (Lugishtë e Qytetit) dhe 5% të fshatit Shpatinë (Grnqarë). Në drejtim të rrugës magjistrale për në Prishtinë si zgjidhje ekonomike dhe funksionale është paraparë brezi i zonave të banimit të lartë (max. P+5), përgjatë kësaj rruge nga të dy anët në gjërësi



prej 100m', duke shkuar nga periferia (rruga qarkore deri te qendra e qytetit).

Në brendi të kësaj zone destinohet sipërfaqja për banim të ultë të etazhiteve të ndyshme (max. P+2 dhe P+3). Në këtë lokacion është i përfshirë në tërësi vendbanimi i quajtur Dardania (Jaglenica) i cili përmban plan rregullativ urbanistik (viti 1983). Në këtë zonë do të trajtohen ndërtimet ilegale konform strategjisë për integrim në zonat e reja zhvillimore. Në kuadër të këtij

lokacioni duhet të përfshihen të gjitha institucionet me karakter publik, në mënyrë të

arritjes së standardit të dëshiruar për destinim të përzier, mbështetur në parimin e distancës së përvetësuar prej 800m. Poashtu, në tokat në lindje të Prizrenit, e paraqitur në hartën e propozimeve, është edhe zona e rezervuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit për nevoja të KFOR-it. Zhvillimi do të përmbledhë në vete të gjitha shërbimet e nevojshme, si ato sociale, arsimore, komunale, të elaboruara në Kapitullin 4 “Përmbushja e Kërkesave të Komunitetit” Pasqyra e hektarëve të përcaktuar për secilin lokacion për zhvillime të reja në Tërësinë Qarkore Lindje bazuar në dendësinë e projektuar të banorëve dhe në numrin e banorëve për zonat, është dhënë në tabelën në vijim:

TËRËSIA ORIENTUESE LINDJE 2003-2013 DESTINIMI I SIPËRFAQEVE	[Ha]	Dendësia	Nr. Banorëve për dendësi 100ban/ha
Njësitë Administrative (1-2) Lindje			
Banim i Ulët + O. Publike - ekzistuese	62.55	50 ban/ha	3128
Zhvillim i Ri (banim i ultë)	201.53	50 ban/ha	8097
Ridestinim (banim i ulët)	48.92	50 ban/ha	2446
Zhvillim i Ri (banim i lartë)	20.23	250 ban/ha	2965
ZV Gjelbrimi	47.02	0	0
Gjithsej TOL	380.25		16636

- 3.15 Tokat në Jug të Prizrenit** - Ky lokacion përfshihet në pjesën e tokës së haptë në jug të Prizrenit dhe 5% të fshatit Shpatinë. Në këtë hapësirë është paraparë ndërtimi i banimit të ultë, me etazhitet max. P+2, për shkak të ruajtjes së konfiguracionit të terrenit dhe vazhdimësisë së zhvillimit të qytetit buzë lumit Lumbardh që do të ketë nivel të lartë të standardit dhe cilësisë së jetesës. Trajtimi i ndërtimit ilegale konform strategjisë për integrim në zonat e reja zhvillimore do të ndërmirret edhe në këtë zonë. Për shkak të afërsisë me Zonën e Kontaktit, ndërtimi duhet t'i plotësojë kriteret e parashtruara. Në kuadër të kësaj zone duhet të përfshihen të gjitha të gjitha shërbimet e nevojshme, si ato sociale, arsimore, komunale. Pasqyra e hektarëve të përcaktuar për secilin lokacion për zhvillime të reja në Tërësinë Qarkore Jug bazuar në dendësinë e projektuar të banorëve dhe në numrin e banorëve për zonat, është dhënë në tabelën në vijim:



TËRËSIA ORIENTUESE JUG 2003-2013 DESTINIMI I SIPËRFAQEVE	[Ha]	Dendësia	Nr. Banorëve për dendësi 100ban/ha
Njësitë Administrative (1-4) Jug			
Banim i Ulët + O.Publike	17.38	50 ban/ha	869
Zhvillim i Ri (banim i ultë)	448.189	50 ban/ha	22096
Zhvill. Ri (ban.i kombinuar)	200.54	150 ban/ha	30082
Shetitorja-Keji i Lumbardhit	72.25	0	0
ZV Kompleksi Spitalor	7.35	0	0
ZV Varrezat	17.04	0	0
Gjithsej TOJ	864.66		53046

3.16 Tokat në Perëndim të Prizrenit - Zona zhvillimore në Perëndim të Prizrenit ofron mundësi për stacion të ri hekurudhor të vendosur në terminalin kryesor të Prizrenit në linjën në mes të Prizrenit dhe Kukësit, në zonat hulumtuese të identifikuara në përcjellje të linjës hekurudhore. Lokacioni do të mundësonte zhvillime të mëdha me destinime të përziera në distanca këmbësorike komfore nga stacioni i propozuar




hekurudhor, në ndërkohë që banorët e tanishëm të zonës do të përfitonin nga vendosja e një shërbimi të ri të hekurudhës. Si zonë me rëndësi ekonomike ku janë të destinuara sipërfaqet për industri të përgjithshme dhe për Tregëti dhe industri të vogël (TQO Perëndim), arritja

dhe transporti i rëndë do të kryhet përmes rrugës qarkore dhe hekurudhës. Përparësitë që dalin nga afërsia dhe lidhja e mirë me terminalin e qytetit do t'i gëzojë edhe qendra e re e qytetit të Prizrenit e cila është paraparë që të situohet në kuadër të kësaj zone. Qendra e re e Prizrenit do t'i përmbajë institucionet me karakter publik duke formuar një qendër administrative, kulturore, afariste-shërbyese dhe tregëtare-ekonomike. Kjo qendër e re do t'i akomodojë institucionet qeveritare të cilat aktualisht janë të situuara në qendrën e vjetër të qytetit bashkë me disa shërbime tjera si bankat, posta, etj. Në këtë zonë do të trajtohen ndërtimet ilegale konform strategjisë për integrim në zonat e reja zhvillimore. Pasqyra e hektarëve të përcaktuar për secilin lokacion për zhvillime të reja në Tërësinë Qarkore Perëndim bazuar në dendësinë e projektuar të banorëve dhe në numrin e banorëve për zonat, është dhënë në tabelën në vijim:

TËRËSIA ORIENTUESE PERËNDIM 2003-2013 DESTINIMI I SIPËRFAQEVE	[Ha]	Dendësia	Nr. Banorëve për dendësi 100ban/ha
Njësitë Administrative (1-2) Perëndim			
Zhvillim i Ri (banim i lartë)	195.59	250 ban/ha	48898
ZV Industria Ekz. 1	69.72	0	0
ZV Industria Ekz. 2	49.25	0	0
ZV Qendra e Re	39.15	0	0
ZV Terminali	18.08	0	0
ZV Industri-Z e Lirë	128.45	0	0
Gjithsej TOP	500.23		48898

ORIENTIMI ZS 2 – SIPËRFAQET ORIENTUESE PËR ZHVILLIME TË REJA

3.17 Kufijtë e ri të qytetit të Prizrenit përkufizojnë sipërfaqen e re të qytetit, gjegjësisht, Territorin Urban të Prizrenit. Projektionet e këtij plani për periudhë 2003-2013 reflektojnë sipërfaqet territoriale të dhëna më poshtë. Tabela ZS3.1 paraqet raportin në mes të sipërfaqeve territoriale të qytetit të Prizrenit sot dhe atij të projektuar me këtë plan. (Për lexim më të afërt të tabelave të dhëna më poshtë, shif hartën "Territorit Urban-Prizren 2003-2013"). Rritja e sipërfaqes kadastrale të qytetit të Prizrenit është bërë për cca 267.4211 Ha.



#.	RAPORTI NË MES TË SIPËRFAQES SË VJETËR DHE TË RE TË QYTETIT TË PRIZRENIT	Ha
[1]	Sipërfaqja kadastrale e Prizrenit 2003 (të dhënat nga KK Prizren)	2926.5789
[2]	Sipërfaqja e Territorit Urban-Prizren 2003-2013	cca 3194.0000
[3]	Diferenca [1] - [2]	cca 267.4211

3.18 Gajtë projektimit të kufirit të ri të qytetit të Prizrenit është bërë analiza e sipërfaqeve ekzistuese të komunës kadastrale të qytetit të Prizrenit dhe raporti i kësaj sipërfaqeje me kufirin e ri të qytetit 2003-2013. Në tabelën ZS3.2 janë paraqitur diferencat aritmetike [në Ha] midis sipërfaqeve që janë munguar nga Sipërfaqja kadastrale e Prizrenit 2003 dhe atyre të cilat janë shtuar me këtë Plan.

#.	DIFERENCAT E SIPËRFAQEVE TË PËRVETËSUARA GJATË PROJEKTIMIT TË TERRITORIT URBAN 2003-2013	Ha
[1]	Sipërfaqja kadastrale e Prizrenit 2003 (të dhënat nga KK Prizren)	2926.5789
[a]	Sipërfaqja e munguar nga Sipërfaqja kadastrale e Prizrenit 2003	
	Pika [a.1]	cca 471.7405
	Pika [a.2]	cca 224.7167
		gjithsej 696.5472
	Sipërfaqja e mbetur nga Sipërfaqja kadastrale e Prizrenit 2003	
	Diferenca [1] –[2]	cca 2230.0317
[b]	Sipërfaqja e shtuar në Sipërfaqja kadastrale të Prizrenit 2003	
	Pika [b.1]	cca 901.4252
	Pika [b.2]	cca 205.4529
		gjithsej 1106.8781
[2]	Sipërfaqja e Territorit Urban-Prizren 2003-2013	cca 3194.0000

3.19 Sipërfaqet orientuese për ha janë dhënë përmes aplikimit të standardeve të sipërfaqeve të nevojshme për banorë. Pasqyra e hektarëve të përcaktuar për secilin lokacion për zhvillime të reja të banimit në Tërësitë Qarkore Orientuese të Prizrenit është dhënë në Kapitullin 6: “Përmbushja e Kërkesave të Komunitetit”.

3.b ZONIMI ADMINISTRATIV

3.20 Qyteti i Prizrenit aktualisht përbëhet prej 20 bashkësive Lokale, prej të cilave vetëm gjashtë (6) bashkësi lokale (BL nr 9-12, shif tabelën 3b.1) kanë kufinj të definuar, ndërkaq BL tjera kanë vazhduar shtrirjen e vet që sygjeron madhësi të tyre deri në dalje të qytetit.



BASHKËSITË LOKALE

Struktura ekzistuese administrative e Qytetit të Prizrenit - 2003

Nr.	Emërtimi i ri	Emërtimi i vjetër	Cca [ha]	Nr. i banorëve pas 1991	Nr. i banorëve para luftës	Nr. i banorëve pas 1999	Dendësia e Përafërt e banorëve
1	Xhevat Berisha	Emin Duraku			11672	15428	
2	Kongresi i manastirit	Kongresi I manastirit	49.38		Mungon e dhëna nga IMG		
3	Vëllezërit Stavileci	Vëllezërit Stavileci			4991	6594	
4	10 Qershori	24 Maji			5589	7387	
5	7 Shtatori	7 Shtatori			7923	10473	
6	Dardania	Jaglenica			753	1004	
7	2 Korriku	2 Korriku			Mungon e dhëna nga IMG		
8	11 Marsi	11 Marsi			14214	18787	
9	Ganimete Tërbeshi	Ganimete Tërbeshi	24.96		6498	8588	260 ban/ha
10	Gani Çavdërbasha	Gani Çavdërbasha	23.05		6566	8769	284 ban/ha
11	Shaban Polluzha	Shaban Polluzha	15.96		5439	7189	340 ban/ha
12	Xhevdet Doda	Xhevdet Doda	23.59		4540	6004	192 ban/ha
13	Lidhja e Prizrenit	Lidhja e Prizrenit	51.17		5920	7828	115 ban/ha
14	Ortakolli	28 Nëntori			18320	8588	
15	Bajram Curri	Bajram Curri			5582	7387	
16	Arbanë	Dushanovë			529	529	
17	Druri I Marashit	Druri i Marashit			4680	6186	
18	Camëria	Nënkalaja			784	305	
19	Abdyl Frashëri	Abdyl Frashëri			2633	3480	
20	Grazhdanik	Grazhdanik			529	529	
Gjithsej:				93035	107162	125055	
(Nr. 1-16 – BL Sipas të dhënave të KK Prizren)				Nr total i ban. sipas Entit Statistikor Prizren	Nr 1-20 BL (Sipas të dhënave të IMG)		


Vërejtje: të dhënat e shfrytëzuara nga tri burimet (KK Prizren, Enti Statistikor, Prizren dhe IMG), propozojmë që të korrigjohen pas regjistrimit të përgjithshëm të popullatës të planifikuar në mes të vitit 2004.

Pasi të jenë zyrtarizuar të dhënat e këtij regjistrimi, do të bëhet korrigjimi eventual i bazës së të dhënave dhe pas kësaj mund të konsiderohet se ky projektion është në tërësi i saktë.

ORIENTIMI ZS 3 – RIDIZAJNIMI I ZONAVE ADMINISTRATIVE

3.21 Ridizajnimi i bashkësive lokale, dhe njëherit koncipimi i tyre si njësi administrative është bërë konform parametrave planifikues për territor standard me cca 150 Ha. Në kushtet e dendësisë së projektuar të banorëve (100 banorë/1 Ha), kjo sipërfaqe e përvetësuar për zona të banimit paraqet optimumin e dëshiruar për akomodim të shërbimeve të cilat do të plotësojnë kërkesat e banorëve të asaj zone të banimit, si: shkollat, parqet, qendrat e mjekësisë familjare, qendrat e kulturës e të rekreimit, shërbimet komunale, shoppingu etj.

3.22 Ridizajnimi i Bashkësive Lokale në Njësi Administrative është bërë në bazë të parimit të distancës së pranueshme të ecjes pre 800 m. Ky radius formon rrjetin e Njësive Administrative e cila harmonizohet me tërësitë territoriale të qytetit. Njësia Administrative – Qendër përfshin pjesën qendrore të Prizrenit (Tërësinë Qendrore Orientuese) dhe përbëhet nga zonat e mbrojtjes, të përvetësuar me Plan. Kjo Njësi paraqet bërthamën e Qytetit të Vjetër të Prizrenit. Për shkak të dendësisë së madhe të banorëve në këtë pjesë të qytetit (shif tabelën 3b.1), gjë që njëherit vlen për gjithë qytetin e Prizrenit, është dhënë propozimi për nënndarje të Njësive Administrative-Qendër në Njësi Implementuese të cilat mund të funksionojnë si tërësi të veçanta administrative deri në “shkarkimin” e dëshiruar të Qendrës (në 100 banorë /1 Ha). Njësitë Implementuese gjithashtu paraqesin edhe fazat e implementimit të këtij plani, gjë që do të mundësojë integrimin gradual të njësive impelmentuese, psh. dy nga dy njësi implementuese, e deri te integrimi i plotë i tyre në një njësi administrative.



3.23 Nën-ndarja e njësive administrative në njësi implementuese është projektuar edhe për të gjitha Tërësitë Qarkore Orientuese për të njejtin qëllim të implementimit dhe funksionalizimit në faza si në Tërësinë Qendrore Orientuese. Shpërndarja e njësive Administrative nëpër Tërësi Orientuese, madhësia e tyre (dhe e njësive implementuese), si dhe dendësia e projektuar për secilën njësi bashkë me numrin e banorëve, është dhënë në tabelat e përgjithshme: TOQ, TOV, TOL, TOJ, TOP, seksionet “projeksioni”.

3.c ZONAT E VEÇANTA

Në kuadër të tërësisë urbane të Prizrenit me këtë Plan identifikohen zonat e veçanta. Në procesin e mëtejshëm të planifikimit, gjegjësisht, të rregullimit urbanistik përmes planeve rregullative dhe projekteve urbanistike të këtyre zonave në veçanti, do të definohen orientimet dhe rregullat e veçanta të ndërtimit dhe të shfrytëzimit të tokës ndërtimore që do të paraqesin bazën për dhënien e pëlqimeve urbanistike.



Rastet e veçanta, të definuara me këtë Plan (komplekset dhe objektet të trashëgimisë, lokacionet tjera të karakterit të veçantë) dhe me dispozitat ligjore për planifikim, urbanizëm dhe ndërtim, pëlqimi urbanistik do të ipet në bazë të orientimeve dhe rregullave (standardeve), të përcaktuara me këtë Plan. Zonat e veçanta të përshkruara në këtë nënkapitull janë: Qendra e Vjetër e Qytetit (QVP), Qendra e Re e Qytetit (QRP), Korridori i Qarkores me Brez të Gjelbër, Kompleksi i Rekretim, Terminali Kryesor, Zona e Lumbardhit (Shtrati me dy brigjet e Kejit të lumit Lumbardh), Zonat industriale, Kompleksi i Spitalit, dhe Varrezat.

ORIENTIMI ZS 4 – QENDRA E VJETËR E QYTETIT

3.24 Qendra e Vjetër e Qytetit shtrihet brenda kufijve të definuar të zonave të mbrojtjes (Zona I dhe II e Mbrojtjes dhe Zona e Kontaktit). Në këtë zonë ndodhet bërthama historike e Prizrenit e cila përbëhet prej objekteve dhe komplekseve me karakter historik dhe kulturor dhe ruajtja e tyre është element i rëndësishëm në kompozimin e siluetës së përgjithshme të qytetit. Parakusht për ruajtjen e banimit ekzistues në këtë zonë si dhe shndërrimin e tij në një banim më kualitativ është sjellja e kapacitetit urban në kufinj optimal duke e bërë shkarkimin e kësaj qendre nga funksioni i banimit, në harmoni me zhvillimet e reja në zonat përfaqësojnë kësaj qendre, të përcaktuara me këtë plan.



- 3.25 Kjo qendër do të ketë rëndësi të posaçme edhe në zhvillimin ekonomik të Prizrenit me fokus në zhvillimet në lëminë e turizmit. Karakteristikat dhe orientimet për trajtimin e qendrës së vjetër të Prizrenit në suaza të zonave të përcaktuara të mbrojtjes janë shtjelluar në veçanti në kapitullin 3 “Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore”.

ORIENTIMI ZS 5 - PROPOZIMI PËR QENDRËN E RE TË PRIZRENIT

Qendra e Re e Prizrenit shtrihet në Tërësinë Qarkore Orientuese – Perëndim, në një zonë me madhësi prej 39.147 Ha. Rregullimi urbanistik i kësaj zone do të bëhet përmes planit rregullativ, ku orientimet dhe rregullat e veçanta të ndërtimit dhe të shfrytëzimit të tokës ndërtimore do të paraqesin bazën për dhënien e pëlqimeve urbanistike për këtë zonë.



- 3.26 Qendra e re e Prizrenit do t'i përmbajë institucionet me karakter publik duke formuar një qendër të madhe administrative, kulturore, afariste-shërbyese.
- 3.27 Në Qendrën e Re të Qytetit do të akomodohen institucionet qeveritare të cilat aktualisht ndodhen në qendrën e vjetër të qytetit. Gjithashtu, posta qendrore do të dislocohet nga Qendra e Vjetër në Qendrën e Re, ndërkaq ajo e vjetra do të ridestinohet korform orientimeve të dhëna për trajtim të Qendrës së Vjetër të Qytetit. Në këtë qendër parashifet koncentrimi i të gjitha shërbimeve profesionale dhe financiare, objektet kulturore si kinematë, sallat koncertale, etj. Në këtë zonë do të trajtohen ndërtimet ilegale konform strategjisë për integrim në zonat e reja zhvillimore. Qendra e re e qytetit të Prizrenit do t'i gëzojë edhe përparësitë që dalin nga afërsia dhe lidhja e mirë me terminalin kryesor.



ORIENTIMI ZS 7 - KORRIDORI I QARKORES DHE BREZI I GJELBËR I QYTETIT

Qarkorja e Prizrenit – kushtëzon vendosjen e zhvillimeve të reja brenda saj, duke i hulumtuar mundësitë për vendosje të zhvillimeve më të mëdha përgjatë pjesëve frekvente kualitative të korridorit të trafikut publik ekzistues, vazhdimisht në kërkim të mundësive për qasje me mjete tjera pos veturave

- 3.28 Traseja e qarkores do të ketë profil sipas llogarive të frekuencës së automjeteve dhe se prej aksit rrugor Prizren-Prishtinë deri në aksin rrugor Prizren – Kukës, sipas frekuentimit duhet të jenë kahjet e ndara me brez të gjelbër me nga dy kursorë plus kursori për ndalesë. Përmaësat e qarkores janë të dhëna në hollësi në kapitullin “Promovimi i Trafikut të Integruar.



Brezi i Gjelbër i Qyteti përbëhet prej pjesës së propozuar e cila shtrihet në pjesën e rrafshhtë të qyteti të Prizrenit dhe e mbështjell qarkoren e qytetit në të dy anët e saj, me një gjërësi prej 60m dhe prej pjesës ekzistuese kodrinore të gjelbrimit e cila karakterizohet me natyrë të



pasur dhe si e tillë duhet të ruhet. Natyra ekzistuese e gjelbërt nis në anën lindore duke depërtuar në dy anët e Lumbardhit dhe vazhdon në jug të qytetit të Prizrenit. Brezi i gjelbër do të lidhet me këto pjesë ekzistuese të gjelbëruara duke formuar kështu unazën mbështjellëse të gjelbëruar për Qarkoren e qytetit.

- 3.29 Brenda këtij brezi, lejet për zhvillim do të refuzohen me përjashtim të atyre me arsytet e dhëna më poshtë:

i. Ndërtimi i objektit të ri për një nga qëllimet e dhëna:

- a. Pyllëzim, shtigje për rekreim joformal
 - b. Punte të ndalesave gjatë udhëtimit, një nga secila anë e qarkores që mund të përfshijë sipas nevojës dhe projekteve zbatuese: pompa të benzinës, toaletet , publike, telefona, ulëse për pushim, etj., parkingje në të hapur për pushime afatshkurtëra për automjete transportuese të të gjitha kategorive, puntet informative turistike, restorane të kapacitetit të vogël, të klasit A3 (Klasët e Destinimeve).
- 3.30 Kuvendi Komunal i Prizrenit gjithashtu një rol pozitiv që Brezi i Gjelbërt mund ta ketë në përmbushjen e synimeve tjera, si:
- Ofrimi i lidhjeve të mira me rrethinën për banorët urban;
 - Ofrimi i mundësive për rekreacion në të hapur afër zonave urbane;
 - Ruajtja dhe avancimi i pejsazhit atraktiv afër vendeve ku banojnë njerëzit;
 - Rregullimi i dëmeve dhe i tokës së lënë pasdore përreth qytetit dhe
 - Mbrojtja e interesave për ruajtjen e natyrës.

- 3.31 Brezi i Gjelbërt bënë kontrollimin e shtrirjes së Qytetit dhe me këtë parandalon zgjerimin e Prizrenit urban si dhe e mbron karakterin rural të rrethinës. Brezi nuk parashifet të jetë një kufizim (pengesë), por lokacion potencial për gjelbrimin dhe rregullimin e pjesëve të degraduara dhe të pagjelbëruara të Brezit. Kufijtë e Brezit të Gjelbërt janë dhënë në Hartën e Propozimeve.

ORIENTIMI ZS 8 – ZONA E PROPOZUAR PËR KOMPLEKS TË REKREIMIT



Në Tërësinë Orientuese Veri (TOV) është propozuar Kompleksi i Rekreimit i cili përfshin sipërfaqe të gjelbëruara dhe objekte për sport/rekreim. Kompleksi i Rekreimit shtrihet në një zonë me madhësi prej 301.927 ha.

Brenda kësaj zone, lejet për zhvillim do të refuzohen me përjashtim të atyre me arsyet e dhëna më poshtë.

i. Ndërtimi i objektit të ri për një nga qëllimet e dhëna:

- Pyllëzim, shtigje për rekreim joformal (vende esenciale për sport dhe rekreacion në natyrë, ose destinime të tjera që e ruajnë karakterin e hapët të zonës së Kompleksit të Rekreimit dhe nuk janë në konflikt me qëllimin e tij)
- Objekte të sportit dhe të rekrimit
- Hapësira për promovim dhe ngritje të vetëdijes lidhur me florën dhe faunën autoktone të Prizrenit (auditorium, kopsht botanik, akvarium, punëtori edukimi, etj...)
- Objekte përcjellëse (hotel, motel, restoran, shopping, ...)
- Hapësira për parkim në të hapur



ii. Rishfrytëzimi i ndërtesës, me kusht që propozimi:

- Të mos përfshijë zgjerim të objektit ose çfarëdo shfrytëzimi tjetër përcjellës të tokës përreth objektit, gjë që mund të jetë në konflikt me karakterin e kësaj zone;
- Të implikojë rindërtim të objektit me formë, madhësi dhe pamje të përgjithshme që i përshtatet rrethinës që ka;
- të implikojë ridenstinim që nuk e cenon karakterin e zonës së Rekreimit ose përmbushjen e qëllimeve të tij;

iii. Zbatimi i operacioneve inxhinierike apo të tjera, apo shndërrimi material i destinimit të tokës, në funksion të karakterit të Kompleksit të Rekreimit dhe që nuk është në konflikt me qëllimet e tij;

- 3.32 Kompleksi i Rekreimit është sipërfaqe e destinuar për sporte, rekreime dhe argëtime formale dhe joformale. Përveç përbajtjeve në të mbyllur për sporte dhe objekteve të rekreimit, kjo zonë përfshin shtigje për këmbësorë dhe çiklizëm, me çka lehtësohet komunikimi në mes të zonave tjera në fqinjësi. Kjo zonë gjithashtu përmban vlera të mbrojtjes së natyrës. Kuvendi Komunal i Prizrenit inkurajon ruajtjen dhe avancimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve për në vendrekreime dhe vendargëtime tjera, me kusht që të mos cenohet qëllimi i përgjithshëm i funksionit të kësaj zone.



ORIENTIMI ZS 9 – ZONA E PROPOZUAR PËR TERMINALIN KRYESOR

Zona e Terminalit Kryesor përfshin sipërfaqe prej 18.080 ha dhe rregullimi urbanistik i kësaj zone do të bëhet përmes planit rregullativ, ku orientimet dhe rregullat e veçanta të ndërtimit dhe të shfrytëzimit të tokës ndërtimore do të paraqesin bazën për dhënien e pëlqimeve urbanistike për këtë zonë.

- 3.33 Kjo zonë paraqet pikë shkëmbyese të trafikut rrugor dhe atij hekurudhor të përmasave madhore, me të gjitha përbajtjet funksionale të një terminali bashkëkohor. Kjo zonë ka lidhje direkte me hekurudhë dhe kyçje të shpejtë me qarkoren e qytetit dhe zhvillimi i saj do të ketë ndikim madhor në përmbushjen e synimeve strategjike të Kuvendit Komunal të Prizrenit për integrimin e Prizrenit, rrjedhimisht, Kosovës në rrjetin rrugor dhe hekurudhor të Evropës Juglindore. Përveç shërbimit të trafikut me të gjitha përbajtjet përcjellëse, kjo zonë do t'i përfshijë të gjitha shërbimet tjera profesionale dhe financiare, hotelet dhe shoppingun, përfaqësitë, bankat dhe agjencionet, vendet për rekreim dhe pushim, si dhe të gjitha përbajtjet tjera që kësaj zone i japin karkater publik të mirëfilltë.



- 3.34 Në kontekstin e udhëtimeve brenda dhe jashtë Prizrenit, nga terminali kryesor do të përfitojnë të gjithë banorët e Prizrenit si dhe udhëtarët tranzitë që e shfrytëzojnë këtë pikëshkëmbim të rëndësishëm rajonal. Terminali do t'i ofrojë përparësitë vitale që dalin nga afërsia dhe lidhja e mirë edhe zonave industriale në fqinjësi duke krijuar kushte për zhvillim të qëndrueshëm shoqëror-ekonomik të Prizrenit.



ORIENTIMI ZS 10 – KEJI I LUMIT LUMBARDH



Rregullimi urbanistik i kësaj zonave, që nënkupton rregullimin e shtratit të lumit, organizimin funksional dhe mënyrën e ndërtimit, do të bëhet përmes planit rregullativ, ku orientimet dhe rregullat e veçanta të dala nga plani rregullativ do të paraqesin bazën për dhënien e pëlqimeve urbanistike për këtë zonë.

3.35 Kjo zonë me karakter specifik e cila përfshin shtratin dhe dy brigjet e Kejit të lumit Lumbardh do të trajtohet në kuadër të kufijve të ri të qytetit, në tërë gjatësinë e Qytetit të Prizrenit. Pjesa e cila fillon prej parkut të Marashit e deri te objekti i ish- Gjykatës (aktualisht shfrytëzohet nga OSBE) do të ketë plan rregullativ të veçantë. Pjesa e kësaj zone e cila shtrihet në qendrën e vjetër të qytetit është definuar në kuadër të Zonës I të Mbrojtjes dhe do të trajtohen sipas rregullave

të vendosura për trajtimin e lokacioneve të mbrojtura. Përpunimi i shtratit dhe dy brigjeve të Kejit të Lumbardhit në vazhdim, prej objektit të ish- Gjykatës e deri te qarkorja, do të bëhet mbi bazat e zgjidhjes së realizuar me plan rregullativ.

3.36 Keji i lumit Lumbardh do të ketë një trajtim të Boshtit të Qytetit duke i dhënë Prizrenit një koncept të ri të formës longitudinale. Koncepti i gjatësisë së lumbardhit duhet të zhvillohet ashtu që në të dy anët e lumit të formohen



shtigjet për këmbësorë në formë të shëtitoreve dhe shesheve në një ose më tepër nivele duke e bërë fenomenin e ujit (lumin) si pikë qendrore të këtij aksi. Dy shtigjet që përcjellin Lumbardhin në gjatësinë e tij do të kombinohen me gjelbrim ndërsa denivelimi i gjatësisë së shtratit duhet të rregullohet me anë të kaskadave, e që njëherit formohojnë ujëvarëse të vogla, me çka edhe arrihet efekti i gurgullimës së ujit.

ORIENTIMI ZS 11 - ZONAT E PROPOZUARA PER INDUSTRI

Funksioni parësor i këtyre zonave është industria e lehtë me koncentrim në klasët B1 dhe B8 përfshirë edhe klasin B2 (Klasët e Destinimeve). Përcaktimi i lokacioneve të veçanta industriale do të bëhet me plan rregullativ. Procesi i vazhdueshëm i planifikimit nënkupton nënshkrimin e plotë ndaj masave të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Organizimi i trafikut duhet të jetë në funksion të shfrytëzimit sa më racional të rrjetit rrugor për qëllime të industrisë.

Propozimi për zhvillim të industrisë në Prizren në periudhë 2003-2013 është bërë për 239.0925 ha të tokës. Industria e Prizrenit si dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të zonave të industriale janë shtjelluar në kapitullin 5 “Sigurimi i Vitalitetit Ekonomik”.

- 3.37 Pikënisja për selektim të lokacioneve për ndërtimet e reja kërkon një Studim të Kapacitetit Urban që ofron vlerësimin më të mirë për sasinë e industrisë së re që do të mund të akomodonte kërkesat në rritje për zhvillim të kapaciteteve industriale të Prizrenit.
- 3.38 Zhvillimi i konsolidimi i ekzistueses dhe ristrukturimi në të ardhmen në funksion të zhvillimit të qëndrueshmë ekonomik, në tri drejtime: rivitalizimi i industrisë ekzistuese përmes transformimit pronësor ; zhvillimi i industrisë së orientuar (që nënkupton gjenerimin e projekteve teknologjike të reja aplikative); dhe zhvillimi i degëve të reja, përpos funksionit zhvillimor e që kanë edhe ato të mbrojtjes së ambientit , por edhe degët për të cilat do të ketë treg dhe partneritet/bashkëinvestim, varësisht prej interesit të tregut më të gjerë se vetëm ai kosovar.



Brenda Zonave të propozuara Orientimore për industri, biznes dhe depo, Kuvendi Komunal i Prizrenit synon parësisht përmbushjen e nevojave afariste. Aty ku zhvillimet kanë implikime të trafikut, kërkohet përgatitja e Vlerësimit të Trafikut i cili do të dorëzohej si i bashkangjitur në aplikimin për planifikim të zhvillimit.

- 3.39 Kërkesa për tokë ndërtimore të përfshirë në Plan do të përmbushet, fillimisht me përcaktimin e tokës në dy lokacionet e identifikuara në Tërësinë Qarkore Orientuese – Veri, dhe në Tërësinë Qarkore Orientuese – Perëndim, të specifikuar për industri të re dhe depo, dhe së dyti, me promovimin dhe përfshirjen e vendeve të punës brenda zhvillimeve të përziera në kuadër të këtyre zonave.

Tabela ZS 11.a				
zonat e propozuara per industri				
Zona e Veçantë Industriale	#	Destinimi	Sipërfaqja [Ha]	Trajtimi urb-arkitektonik
Tërësia qarkore orientuese (TQO) – Veri	1	Tregëti dhe Industri e Vogël	cca 110.644	Zhvillim i R
Tërësia qarkore orientuese (TQO)– Perëndim	2	Zona Ekzistuese Industriale	cca 49.2523	Konsolidim i strukturave ekzistuese - ridestinim
	3	Zgjerimi i Zonës Ekzistuese Industriale	cca 69.7162	Rizhvillim
	4	Industri - zonë e lirë	cca 128.4485	Zhvillim i Ri
Gjithsej [Ha]			cca 358.0610	

1. Zona e Veçantë në TQO – Veri: Tregëti dhe Industri e Vogël / klasët A1, B1, B8

3.40 Kjo zonë përfshin 110.644 ha. Me përcaktimin e tokës ndërtimore në veri të Prizrenit, të specifikuar si Zona e Veçantë për Tregëti dhe Industri të Vogël është propozuar skema e destinimeve të përziera me kusht që një skemë e tillë të mund të ekzistojë pranë zonave të banimit dhe të rekreimit, pa pasur ndikime negative në kontekstin e mjedisit të pastër dhe ekologjik. Shtrirja e kësaj zone në pjesën periferike të tërësisë Veriore dhe lidhja e mirë e saj me rrugën qarkore dhe zonat e banimt duke e shtuar këtu edhe afërishtë me zonën e propozuar për Kompleks Rekreimi, do të ndihmojë dhe do të bëjë që ekonomia lokale e Prizrenit të bëhet e qëndrueshme. Kjo zonë është përcaktuar për Klasën **A1** (Dyqane), **B1** (Biznesi, që në vete ngërthen proceset industriale) dhe **B8** (Depo, Distribuim)- shif Klasët e Destinimeve (shif shtojcën). Në këtë zonë do të promovohet “Parku i Biznesit” i cili do të vihet në shërbim të bizneseve startuese.

2. Zona e Veçantë në TQO – Perëndim : Zona Ekzistuese Industriale – Tregëti dhe Industri e Vogël - klasët A1, A3, B1, D2

Rregullimi urbanistik i kësaj zone do të bëhet përmes planit rregulativ, ku orientimet dhe rregullat e veçanta të ndërtimit dhe të shfrytëzimit të tokës ndërtimore do të paraqesin bazën për dhënien e pëlqimeve urbanistike për këtë zonë.

3.41 Kjo zonë përfshin një sipërfaqe prej cca 49.2523. Në këtë zonë parashifet konsolidimi, respektivisht rekonstruktimi i strukturave ekzistuese në funksion të zhvillimit harmonik dhe human të qytetit, parasegjithash duke i aktivizuar kapacitetet e Ndërmarrjes “Famipa” në funksion të ruajtjes së traditës prizrenase për përpunimin e arit dhe argjentit dhe llojeve tjera të artizanateve. Strukturat tjera ekzistuese (sallat prodhuese dhe objektet përcjellëse) do të ridestinoohen dhe rehabilitohen në mënyrë

bashkëkohore duke i dhënë kësaj zone një karakter afarist-shërbyes, tregëtar-ekonomik dhe kulturor-argëtues, gjë që do ta bëjnë këtë lokacion atraktiv për punë dhe për argëtim. Integrimi i kësaj zone me qendrën e vjetër të qytetit bëhet përmes parkut të qytetit, ndërkaq me zonën e re industriale, të identifikuar si “Industri-Zonë e Lirë” do të bëhet përmes rrugës tërthore e cila lidhet me qarkoren e qytetit, gjë që do të ndihmojë në shkarkimin e trafikut nga zona qendrore e qytetit për qëllime të furnizimit. Në këtë zonë promovohet Parku Industrial dhe Tregëtar.

3. Zona e Veçantë në TQO – Perëndim : Zgjerimi i Zonës Ekzistuese Industriale – Industri Bujqësore, kl. B1, B8

Rregullimi urbanistik i kësaj zone do të bëhet përmes planit rregullativ, ku orientimet dhe rregullat e veçanta të ndërtimit dhe të shfrytëzimit të tokës ndërtimore do të paraqesin bazën për dhënien e pëlqimeve urbanistike për këtë zonë.

3.42 Kjo zone përfshin cca **69.7162 ha** dhe gjatë periudhës së këtij plani akomodon një pjesë të industrisë e cila disloket nga lokacioni ekzistues dhe specifikohet si Industri Bujqësore. Në këtë zonë propozohet skema e destinimit të përzier me kusht që një skemë e tillë të mund të ekzistojë në afërsi të banimit pa pasur ndikime negative në kontekstin e mjedisit të pastër dhe ekologjik. Ndërtimi ilegal i cili gjatë periudhës së planifikimit merr përmasa të dukshme do të trajtohet në kontekst të zhvillimeve të reja. Shpërndarja e klasëve B1 dhe B8 (Klasët e Destinimeve – shtojca 5) do të bëhet në varësi prej fqinjësisë me zonat dhe objektet përreth (terminali, hekurudha, qarkorja etj.)

4. Zona e Veçantë në TQO – Perëndim : Industri e Përgjithshme – Zonë e lirë - klasët B1, B2, B8

3.43 Ky lokacion përfshin cca 128.4485 ha dhe është zonë që momentalisht paraqitet si tokë e hapët brendja kufijve të ri të qytetit të Prizrenit. Propozimi për përcaktim të specifikuar biznes, industri e përgjithshme me depo dhe distribuim, Klasën B1, B2 dhe B8 (Klasët e Destinimeve, (shif shtojcën) ofron mundësi për racionalizim të destinimeve në mënyrë të planifikuar. Lokacioni ka lidhje të mirë me rrugën qarkore dhe me hekurudhën, ka lidhje direkte me Terminalin Kryesor, duke lehtësuar kështu kycjen e automjeteve të rënda pa ndikuar fare në zonat e banimit. Ndikimi vizuel i zhvillimit do të përkufizohet me zonat e gjelbëruara gjerësisht përreth këtij lokacioni. Në këtë zonë promovohet edhe Parku Industrial.

ORIENTIMI ZS 12 – KOMPLEKSI I SPITALIT

Lokacioni ekzistues i kompleksit të spitalit përfshin një sipërfaqe prej 10.8 Ha dhe shtrihet në pjesën jugore të qytetit (TQO-jugore). Rregullimi urbanistik i kësaj zonave, do të bëhet përmes planit rregullativ, ku orientimet dhe rregullat e veçanta të planit rregullativ do të paraqesin bazën për dhënien e pëlqimeve urbanistike për këtë zonë.

3.44 Rindërtimi i kompleksit të spitalit kërkon një Studim të Kapacitetit Urban që ofron vlerësimin më të mirë për sasinë e zhvillimeve të reja që mund të akomodohen në

këtë zonë. Sipas analizave të këtij Plani, ky lokacion i përmbush kërkesat e reja në kontekstin e sasisë së tokës ndërtimore të nevojshme për zhvillim, prandaj kufijtë ekzistues të këtij lokacioni janë përvetësuar edhe për periudhën e ardhshme të planifikuar 2003-2013.

- 3.45 Në këtë zonë parashifet konsolidimi, respektivisht rekonstruktimi i strukturave ekzistuese në funksion të avansimit dhe modernizimit të shërbimeve shëndetësore me paisje dhe strukturë administrative të kohës që do të mundësonte funksionim kontinual dhe integrim gradual me strukturat e reja të cilat do të akomodohen në këtë lokacion. Hapësirat dhe strukturat ekzistuese të cilat nuk i plotësojnë standardet ndërkombëtare, do të ridestinoohen për qëllime të shërbimeve përcjellëse ose/dhe administrative në kuadër të sistemit të ri shëndetësor. Strukturat e reja spitalore të kompleksit do të përcaktohen sipas skemave më bashkëkohore të komplekseve të tilla, me koncentrim të të gjitha shërbimeve shëndetësore dhe atyre përcjellëse. Meqë kjo zonë përmban vlera të mbrojtjes së natyrës, gjelbrimi ekzistues do të ruhet dhe do të plotësohet, bashkë me mundësi të reja për rehabilitim dhe rekreim në të hapët.
- 3.46 Lokacioni ka lidhje të mirë me rrjetin e rrugëve duke lehtësuar kështu kycjen e automjeteve pa ndikuar fare në zonat e banimit. Ndikimi vizuel i zhvillimit do të përkufizohet me zonat e gjelbëruara gjerësisht përreth këtij lokacioni.

ORIENTIMI ZS 13 – VARREZAT

Rregullimi urbanistik i kësaj zonave, do të bëhet përmes planit rregullativ, ku orientimet dhe rregullat e veçanta të planit rregullativ do të paraqesin bazën për dhënien e pëlqimeve urbanistike për këtë zonë.

- 3.47 Lokacioni ekzistues i varrezave të qytetit të Prizrenit janë definuar në kuadër të Zonës II të Mbrojtjes dhe do të trajtohen sipas rregullave të vendosura për trajtimin e lokacioneve të mbrojtura. Trajtimni i kësaj zone do të përfshinte rregullimin e shtigjeve këmbësorike dhe objekteve përcjellëse brenda kompleksit, sipërfaqe parkuese për vetura në hyrje të varrezave si dhe trajtimin e gjelbërimit. Konzervimi i kësaj zone i përjashton mundësitë për zgjerim të lokacionit në të ardhmen.
- 3.48 Prandaj, Kuvendi Komunal i Prizrenit do të kërkojë provizione për lokacion të ri për varrezat e reja të Prizrenit, në pjesën veriore të gjelbëruar (pika 2 e Hartës së propozimeve). Afërsa me qarkoren e qytetit dhe lidhjet e mira me rrjetin e rrugëve, ambienti i gjelbëruar, toka e hapët e cila mundëson planifikim të kësaj zone për një periudhë më të gjatë kohore, janë përparësi të cilat e bëjnë këtë zhvillim lehtë të arritshëm për të gjithë banorët.
- 3.49 Lokacioni i ri i varrezave do të ketë skemë të përmbajtjeve dhe të funksionimit sipas modeleve bashkëkohore, gjithnjë në shërbim të traditës kosovare-prizrenase dhe në veçanti, në shërbim të dokeve fetare të të gjitha religjioneve që janë prezente në Prizren.

KAPITULLI 4

MODELI I QYTETIT



Ndërtimi dhe renovimi i Prizrenit në të ardhmen do të varet nga mundësitë dhe limitimet e evidentuara gjatë hartimit të strategjisë për zhvillim të gjithëmbarshtëm të qytetit.

Në aspektin e shtrirjes strategjike, ky plan e definon Prizrenin si qytet me lum që rrjedh nëpërmes, i cili i takon modelit të qyteteve me koncept të kombinuar të shtrirjes.

Kuvendi Komunal i Prizrenit synon që qyteti i Prizrenit të rimodelohet mbi bazat e përtërjes së traditës së vjetër të shtrirjes së qytetit përgjatë lumit duke i konkurruar modelit ekzistues të me tendencat për rikonceptim longitudinal, gjegjësisht, shtrirje në perëndim përgjatë Lumbardhit.

Ky model i kombinuar me tendencë të konceptit longitudinal do t'ia kthejë Prizrenit fenomenin e të qenit unik –

fenomenin e ujit!



4.1 POZITA GJEOGRAFIKE DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE

Komuna e Prizrenit gjendet në jugperëndim të Kosovës dhe përbëhet prej 72 fshatërave me gjithsej sipërfaqe prej 63871.6866 ha, gjegjësisht, 640 km² (5,94% të territorit të Kosovës). Prizreni kufizohet me Shqipërinë në perëndim, me IRJ të Maqedonisë në jug - lindje, me Komunën e Gjakovës në veri-përendim, me Rahovecin në veri, Therandën në veri-lindje, Shtërpcën në lindje dhe Dragashin në jug.



Komuna e Prizrenit karakterizohet me relief të ndryshueshëm që në vete përmbledh pjesën malore të Malit Sharr si dhe pjesën kodrinore dhe atë fushore të territorit të Prizrenit. Pika më e ulët e pjesës fushore ndodhet në lartësi mbidetare prej 277 m' ndërkaq pika më e lartë e kësaj komune arrin lartësinë prej 2363 m'. Qyteti i Prizrenit shtrihet në lartësi mbidetare në mes të 403 m' në pjesën e rrafshit të Prizrenit, në veri 412 m', në lindje te Marashi 430 m', dhe pika më e lartë e Kalasë është 520 m'.

Komuna e Prizrenit ka rrjetë të pasur hidrografike. Numri më i madh i burimeve ndodhen në pjesën malore. Të gjithë ujërat sipërfaqësor të këtij territori rrjedhin kah Drini i Bardhë. Këta lumenjë i takojnë derdhjes së detit Adriatik. Një nga degët kryesore të Drinit të Bardhë është Lumbardhi i cili kalon nëpër qendrën e qytetit të Prizrenit. Lumbardhi është lum i maleve të Sharrit me gjatësi prej 35 km dhe sipërfaqe të derdhjes prej 226 km².

4.1.1 KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE TË TOKËS

Kushtet natyrore të tokës në rajonin e Prizrenit janë të ndryshme prandaj edhe kemi paraqitje të tipeve të shumëllojshme në këtë hapsirë relativisht të vogël gjeografike. Në procesin e diferencimit gjenetik të tokës ndikuan faktorët si: reliefi, klima, vegjetacioni, hidrografia, hidrologjia dhe ndikimi i njeriut. Në reliefin e Prizrenit dallojmë dy tërësi gjeomorfologjike me karakteristika të veçanta: Gryka e Prizrenit dhe zona e Sharrit. Këto dy tërësi dallohen për nga aftësitë e produktivitetit të tokës.

Në rrafshinë dhe përreth lumenjëve ekzistojnë tokat që janë shumë productive, kurse në terrenet malore tokat janë të përshtatshme për kullose dhe për pylltari.

Tokat pseudogjene – njësitë e ndara sistematike dallohet për nga rexhimi i lagështisë (ujit). Kriter i ndarjes është marrë thellësia dhe theksimi i horizontit eluvijal, përmbajtja edhe karakteri i reliefit. Ndarja e këtyre njësive ka reëndësi në zgjedhjen e masave adekuate të meliorimit, e posaçërisht të rregullimit të rexhimit të ujit.

Toka hidrogjene – ka ndikim të madh të lagështisë së tepërt dhe të ujërave nëntokësore. Karakteristikë e kësaj toke është “jorizontagleja” e cila paraqitet në thellësi të ndryshme, në varësi me ujërat nëntokësore. Në të shumtën e rasteve ky lloj i tokës gjendet përfundimisht livadheve me vegjetacion hidrofil.

Toka e kuqërremtë minerale – është e përfshirë në shtresat delunijale të reliefit kodrinor. Ky relief siguron depërtueshmëri të volitshme që e ngadalëson dukshëm gërryerjen e tokës.

Toka deluviale – gjendet në anën e majtë dhe të djathtë të rrugës Prizren-Suharekë.

Toka aluvijale – gjendet në luginat e lumenjëve Lumbardhi, Drini i Bardhë, Toplluha, etj.

Toka aluvialo-deluviale – shtrihet në sipërfaqet më të vogla në zonat e përfshira në të Komacionit. Këto toka janë shtresime deluvijale në rrjedhat e lumenjëve të cilat kanë përbërje të ngurtë.

4.1.2 KUSHTET KLIMATIKE

Klima - e qytetit të Prizrenit është jashtëzakonisht e llojllojshme. Në viset e ulëta dominon klima mesdhetare dhe verërat janë shumë të nxehta ndërkaj në viset malore dominon klima e alpeve prandaj sasi të bores mbeten nëpër gropa deri në muajin qershor dhe kështu në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve.

Prizreni ndodhet në 42° 13' të gjërësisë veriore gjeografike dhe 20° 44' të gjatësisë lindore gjeografike. Sipas gjërësisë gjeografike Prizreni ndodhet në brezin e mesëm të nxehtësisë, kjo do të thotë se ndodhet në mes të zonës kaluese subtropike me shtypje të madhe dhe zonës subpolare me shtypje të ulët, ashtu që edhe kushtet klimatike janë të përcaktuara me këto karakteristika. Verës, për arsye të lëvizjes së brezit subtropik me shtypje të larta kah veriu, Prizreni ndodhet nën ndikimin e të ashtuquajturit anticiklon azor, me kushte relativisht stabile dhe me të reshura të herëpashershme të karakterit lokal. Dimrit kushtet atmosferike janë nën ndikimin e aktiviteteve të ciklonit nga oqeani Atlantik dhe detit Mesdhe, si dhe anticiklonit Siberian dimëror, i cili manifestohet me të reshura të bollshme. Për kushtet klimatike në Prizren është e rëndësishme edhe distanca nga deti, distancë kjo e cila është vetëm 105km, si dhe lugina e Drinit të Bardhë, përmes së cilës vjen klima mesdhetare. Marrë në përgjithësi Prizreni ka klimë mesatare kontinentale me ndikime të klimës mesdhetare.

Temperatura - është elementi kryesor i klimës. Temperaturat mesatare vjetore të dhëna në tabelën më poshtë tregojnë se vjeshta është më e nxehtë se pranvera dhe se në bazë të tendencës për lëvizjen e minimumit të temperaturës në muajin shkurt dhe maksimumit në muajin gusht kemi të bëjmë me ndikim të temperaturave mesdhetare.

Temperaturat aktive të ajrit fillojnë shumë herët dhe zgjasin deri vonë. Temperatura karakteristike më e lartë se 6°C fillon që nga 15 marsi dhe mbetet deri me 18 nëntor, d.m.th se periudha e vegjetacionit është rreth 8 muaj, edhe pse në teori mirret 6 muaj (nga prilli deri në shtator). Temperatura mesatare e periudhës së vegjetacionit në Prizren është 19,1°C. Maksimumi mesatar i temperaturës në vjeshtë është 17,6°C. Për analizën klimatike është me rëndësi edhe prania e ditëve verore dhe ditëve me nxehtësi tropike. Kjo nxehtësi verore është e përshtatshme për vreshtari, e cila është e përshtatshme për të gjitha vendet të cilat kanë min 40 ditë me temperaturë me më së paku 20°C. Në Prizren mesatarisht ka 98.1 ditë ose 26,8% ditë në vit me ditë verore. Prania e ditëve me nxehtësi tropike është 34,8 ditë ose 9,5% në vit. Për bujqësi dhe ndërtimtari me rëndësi është periudha pa ngrica dhe me ngrica, përkatësisht koha në mes të ditëve me temperatura minimale mbi 0°C (pa ngrica) e cila mesatarisht zgjatë 229 ditë ose 60% në vit dhe në mes të ditëve me temperatura nën 0°C (me ngrica) me rreth 20,3% në vit. Ditët me temperatura që shkaktojnë ngrica janë të papërshtatshme posaçërisht në pranverë për shkak të pemëve dhe perimeve të reja të cilat për shkak të temperaturave mesatare të ajrit do të mund të kultivohen.

Mesataret e temperaturës së ajrit													
Stacioni	Muajt												Shuma
	X	XI	XII	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	
Prizren	12.2	7.6	3.4	0.1	2.2	6.4	12.0	16.6	20.2	22.2	22.2	18.2	4.369

(Të dhënat KK Prizren¹)

Mesatarja e ditëve me disa temperature ekstreme në rajonin e Prizrenit													
	Muajt												Viti
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Tx>25°C	1	1	0.3	1	9	19	26	25	14	2			96
Tx>30°C					1	6	11	12	3	0.03	1	1	33
Tm>0°C	20	13	8	0.5	0.1				0.1	1	5	15	63
Tm>10°C	3	1	0.2										5

(Të dhënat KK Prizren)

Të dhënat nga viti 1951-1980 nga Stacioni meteorologjik, "Profili socio ekonomik dhe fizik"

Lagështia e ajrit - Shkalla e ngopjes së ajrit me lagështi është më rëndësi të posaçme për turizëm, shëndet dhe bujqësi. Nga lagështia e ajrit varet krijimi i mjegullës, reve, vesës, ngricave, shiut dhe borës.

¹ Tabela e marrë nga Profili socio ekonomik dhe fizik

Lagështia relative e ajrit (në %)													
Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
T ^o C	81.2	74.8	69.4	65.2	66.3	62.6	57.8	59.0	66.8	76.2	82.3	82.8	70.4

Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative të ajrit është 70.4%. Duke e vështruar sipas stinëve të vitit lagështi relative më të madhe ka dimri (79.6%) dhe vjeshta (75.1%), që I përshtatet eliminimit të ndotjes së ajrit, kurse nga aspekti shëndetësor për njerëz është element klimatik jo i përshtatshëm. Verën dhe pranverën e karakterizon një lagështi relative e ultë (59.8%, përkatësisht 66.7%), që është e përshtatshme nga aspekti shëndetësor, sepse për organizmin e njeriut vlerat më të përshtatshme të lagështisë së ajrit janë 40 deri 70%. Lagështia relative më e ulët gjatë verës është për shkak të temperaturave të larta, përderisa lagështia e lartë relative e ajrit në dimër është për shkak të arritjes së shpeshtë të ajrit të lagësht nga deti Adriatik.

Lagështia e ajrit është një ndër elemente të rëndësishme klimatike nga e cila varet intensiteti i transpirimit dhe avullimi, gjegjësisht rexhimi uJOR i indeve të bimëve.

Mesatarja e ditëve me disa temperature ekstreme në rajonin e Prizrenit													
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
U	82	76	69	64	64	61	59	59	67	74	80	83	70
U1	76	67	58	51	50	47	44	50	58	69	79	58	58
U2	28	21	15	14	20	17	16	18	20	16	20	28	14

(Të dhënat KK Prizren)

Në tabelë janë paraqitur vlerat mesatare të lagështisë së ajrit në orën 14, si kohë më e nxehtë gjatë ditës dhe minimumi absolute i lagështisë relative të ajrit në territorin e Prizrenit.

U - Mesatarja e lagështisë relative të ajrit

U1 - Mesatarja e lagështisë relative e ajrit në orën 14

U2 - Minimumi absolute i lagështisë relative të ajrit në territorin e Prizrenit,

Në bazë të tabelës gjatë dimrit, në dhjetor dhe janër (82-83%) dhe në muajt e verës zvoglohet, kështuqë është më e ultë në muajin gusht (59%).

Gjatë periudhës së vegjetacionit, lagështia e ajrit zvoglohet në mes të 64 dhe 74% në tëc gjithë muajt e kësaj periudhe përveq të tetorit që është 70-75%. Lagështia relative e ajrit është më e ulët në orën 14 kur është temperature e ajrit më e lartë. Vlera mesatare e të rreshurave vjetore është 686mm, nga e cila në kohën e vegjetacionit është 320mm (46%), kurse në kohën jashtvegjetacionit është 336mm (54%).

Të rreshurat mesatare mujore dhe vjetore në mm (R), mesatarja e ditëve me të rreshura me lartësi >0.1m dhe >10.0 në teritorin e Prizrenit (1951-1980)													
Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
R	71	57	59	60	75	59	59	41	60	65	88	77	769
h>0.1mm	12	11	12	12	14	11	12	7	9	8	13	13	134
h>10.0mm	2	2	2	2	2	2	2	1	2	2	3	3	25

(Të dhënat KK Prizren)

Në bazë të tabelës lëvizja vjetore e lartësisë së të rreshurave është 47mm, kurse lëvizja relative vjetore është 6.1%, ku tregohet se territori i Prizrenit gjendet në kufijt e rreximit pluviometrik të modifikuar mesdhetar dhe të Europës qendrore.

Reshjet në regjionin e Prizrenit sipas stacionit meteorologjik BONSTIL të vitit 200/2001

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
<i>(Të dhënat KK Prizren)</i>													

Shuma e tërësishme e reshjeve vjetore ka vlerën prej 650mm shi në vit.

Muajt	Mundësitë e paraqitjes së të rreshurave								
	X-III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	IV-IX	I-XII
Qo	365	48	73	44	45	51	59	320	686
Cv	0.30	0.58	0.51	0.69	0.78	0.82	0.50		
Cs	1.00	1.20	1.05	1.40	1.60	1.60	1.50		

(Të dhënat KK Prizren)

Sasia të rreshurave vjetore në kohën e vegjetacionit më së pakti variron në muajin e majit dhe të shtatorit (Cv=0.50), ndërsa më së shumti në korrik (Cv=0.78) dhe në gusht (Cv=0.82). Ky orar I të rreshurave I përgjigjet tipit kalimtar ndërmjet rreximit pluviometrik mesdhetar dhe europës qendrore. Periudha më e gjatë për të rreshura në kohën e vegjetacionit është treguar nga 27 qershori deri 16 gusht të vitit 1954 në kohëzgjatje prej 51 ditësh por periudha e thatë në kohën e vegjetacionit nga 3-4 javë është e zakonshme. Shirrat verore dhe të vjeshtës lajmërohen në formë të rebesheve.

Vrerësitat dhe Insolimi (Rrezatimi) - Shkëlqimi i rrezeve të diellit zgjatë shumë. Në Prizren zgjatë rreth 2150 orë në vit. Muaji me më së shumti diell është korriku me 322.1 orë, përkatësisht me 69.5% të rrezatimit potencial. Muaji me rrezatim mesatar më të shkurtër është dhjetori me gjithsej 56.8 orë, respektivisht me 20.0% të rrezatimit potencial të këtij muaji.

Të reshurat - Krahas temperaturës, të reshurat e shiut janë elemente kryesore klimatike, sasia dhe hapi vjetor i tyre paraqet karakteristikën kryesore klimatike të një vendi. Hapi vjetor i të rreshurave të shiut është i rëndësishëm për prodhimtari, regjim të lumenjve dhe ujërave nëntokësor. Që të kemi një pasqyrë më të mirë të të rreshurave të shiut, do të shfrytëzojmë të dhënat nga stacioni i matjes së të rreshurave në Prizren.

Mesatarja mujore, sezonale dhe vjetore dhe sasia vjetore e të rreshurave në mm për periudhën prej vitit 1926 deri 1940 dhe prej vitit 1947 deri në vitin 1959

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
	71.3	64.9	59.4	64.5	78.3	63.2	34.7	44.7	56.0	90.9	81.4	88.2

VITI	Dimri	Pranvera	Vera	Vjeshta	
797.5	224.2	202.2	142.6	228.3	341.4

Prizreni gjendet në kalimin në mes të rexhimit të të rreshurave maritime dhe kontinentale. Por, Prizreni ka rexhimin pluviometrik mesdhetar, kjo do të thotë se të rreshura ka më shumë në pjesën e ftohtë të vitit (prej tetorit deri në mars, sasia 456.1 mm) se sa në pjesën e nxehtë të vitit (prej prillit deri në shtator, sasia 341.4mm). Në këtë lokalitet verehen dy maksimume të të rreshurave: kryesori (në vjeshtë, me lartësi mesatare prej 228.3m) dhe I mesmi (dimëror, me lartësi mesatare 224.4m). Për bujqësi është I rëndësishëm maksimumi I I mesëm, I cili bimës së kultivuar I sjell mjaft lagështi. Ndikimi I rexhimit mesdhetar vërehet në zvogëlimin e të rreshurave në muajt e verës. Në verë, kur vegjetacionit, kuturave, shtazëve dhe njerëzve I nevojitet më së shumti uji, të rreshura kemi më së paku me 142.6m, vetëm 17.9 nga të rreshurat e tërësishme vjetore. Shiu veror është më I shpeshtë dhe më I shkurtë, por me rebeshe të mëdha. Ky është edhe shkaku I erozionit të madh të tokës në të gjitha terrenet e pjerrta të cilat në Prizren janë shumë dhe paraqiten si pjesë mjaft me vlerë për bujqësi. Periudha më e thatë dhe pa të rreshura është vera (21.2 ditë). Periudha me të rreshura të shumta është pranvera (33.9 ditë), pastaj dimri (31.8 ditë) dhe vjeshta (28.6 ditë). Shiu është forma dominante e të rreshurave, por edhe bora bie mjaft shpesh. Mestarja vjetore e të rreshurave në formë të borës është 23.3 ditë apo 20% nga numri I përgjithshëm I ditëve me të rreshura.

Të rreshurat në formë të borës janë të kufizuara nga muaji tetor deri në prill, me paraqitje maksimale në janar (6.4 ditë) ndërsa me paraqitje më të dobët në tetor (0.1 ditë). Në këtë lokalitet toka është e mbuluar me borë me lartësi të konsiderueshme me një mesatare vjetore prej 28.3 ditësh. Duke pasë parasysh ndërimet e temperaturës dhe lagështisë së ajrit në lartësi të regjionit malor të Sharrit, Koritnikut, Oshljakës dhe Malit të Vjetër (Koxha-Balkanit), mund të mirret se periudha korrik-shtator është e përshtatshme për turizëm dhe për kurim shëndetësor dhe rekreues. Në anën tjetër, në lartësitë më të mëdha se 1500m periudha e mbështjellësit të borës është më shumë se 200 ditë, që është e përshtatshme për periudhën dimërore turistike kurse verës kemi zonë të freskët të qëndrimit.

Për shkaqe të zhvillimit të komunikacionit me rëndësi është edhe mjegulla, e posaqërisht në pjesët e ulta të relievit ku kalojnë edhe rrugët. Ftohja e temperaturës gjatë natës është shkaktari kryesor I formimit të mjegullës. Për këtë arsye , ajo paraqitet në pjesën e ftohtë të vitit (prej muajit tetor deri në mars), me një mesatare prej 24.9 ditë, derisa gjatë verës jegulla paraqitet vetem me 2.1 ditë. Në dhjetor kemi sasinë më të madhe të paraqitjes së mjegullës (6.1 ditë), kurse atë më të vogël e kemi gjatë muajve qershor dhe korrik (0.2 ditë).

Erërat - Era është element I rëndësishëm I klimës. Nga drejtimi I saj, dendësia dhe forca varen edhe elementet tjera të klimës. Në Prizren më së shpeshti fryejnë erërat jugperëndimore (150%), verilindore (131%) dhe veriore (97%), e më së rralli lindore (40%), jugore (50%) dhe perëndimore (55%). Erërat më të shpeshta kryesisht kanë edhe shpejtësinë mesatare më të më të madhe mesatare, dhe atë në

erërat nga juperëndimi (18.9m/sec ose 68.0km/orë) dhe verilindja (16.5m/sec ose 59.4 km/orë). Në verë gjatë natës kemi nga jugu dhe juglindja erëra locale të freskëta nga Cvileni. Atëherë, në orët e mbrëmjes mund të gjejmë freski në shetitore dhe kopshte në pjesët jugore të qytetit. Kjo erë e lehtë e pengon stagnimin e ajrit mbi Prizren, me ç'rast bën largimin e ajrit të papastër, të nxehtë dhe me plot pluhur e mikrobe me ajër të pastër nga mallet I cili është I pastër dhe ka lagështi të mirë.

4.1.3 UJËRAT

Në sasinë, formën dhe shpërndarjen e ujërave në regjionin e Prizrenit kemi përshtypjen se qyteti është I pasur me ujëra, derisa në të vërtetë është pasqyrë e elementeve të përshtatshme të kushteve tjera natyrore. Në pjesën me lartësi mbidetare deri 500m sasia e të rreshurave sillet prej 650 deri 800 m, derisa në rrafshnaltat dhe në male sasia vjetore e të rreshurave është prej 800 deri 1500m, do të thotë së në këtë regjion kemi sasi të mjaftueshme të të rreshurave atmosferike. Në lidhje me sasinë mesatare të të rreshurave, regjioni është I pasur me burime dhe rrjedha sipërfaqësore të ujit.

Rrjeta hidrografike e regjionit të Prizrenit në përgjithësi I takon pellgut të Drinit të Bardhë, I cili derdhet në detin Adriatik. Sipërfaqja e pellgut të Drinit në Rrafshin e Dukagjinit është 4860 km². Në territorin e regjionit të Prizrenit Drini I Bardhë depërton në kotën 320m te Ura e Fshejtë dhe del nga territori I Prizrenit në afërsi të fshatit Vrmicë (270m). Një nga degët kryesore të Drinit të Bardhë është Lumbardhi (Bistrica e Prizrenit), burimi I të cilit është në kotën 2360m në malet e Sharrit. Lumbardhi është I gjatë 35km dhe ka një sipërfaqe të pellgut prej 266km².

Shtresat e dëborës janë burim kryesor I Lumbardhit, pas shkrirjes uji rritet më së shumti gjatë muajit maj, ku arrihet maksimumin i cili është 2 deri 3 herë më I madh nga rrjedha vjetore mesatare. Për shkak të të rreshurave të dëborës kah mesi I dimërit zvoglohet rrjedha dhe shfaqet minimumi i ujit. Ky minimum shfaqet edhe kah mesi I verës (gusht-shtator), për shkak të avullimit dhe minimumit të të rreshurave

4.2 DEMOGRAFIA

Në bazë të të dhënave statistikore për numrin e banorëve, në Komunën e Prizrenit jetojnë 225.531 banorë. Në mungesë të regjistrimeve zyrtare në Kosovë, treguesit demografik bazohen në projeksione sipas të cilave:

PARAMETRAT DEMOGRAFIK PËR KOMUNËN E PRIZRENIT 2003	1981	1991	2001
Numri i popullsisë	134,526	178,723	225,531
Dendësia e popullsisë në 1 km ²	211	280	352
Madhësia e familjes /anëtarë	7	7	7.18
Numri i familjeve	19,218	25532	31419

Të dhënat KK Prizren 2003

PËREBËRJA ETNIKE NË KOMUNËN E PRIZRENIT 2003	Shqiptarë	Boshnjakë	Turq	Ashkalinjë	Serbë
Numri i popullsisë	225,531	14,000	12,000	5,500	344
Qershor 2001	86 %	6 %	5 %	2 %	0.15%

Burimi: Zyra e OSBE-së, të dhëna të mblledhura për qëllime të zgjedhjeve²

Sipas të dhënave të grumbulluara nga Entit Statistikor i Prizrenit, nga raportet e publikuara nga ana e MAPH, dhe OSBE, numri i banorëve në Komunën e Prizrenit, si dhe numri i banorëve sipas ndarjes në zonë urbane dhe rurale në këtë komunë para dhe pas lufte është:

Komuna e Prizrenit	NUMRI I PËRGJITHSHËM I BANORËVE								
	sipas Enti Statistikor i Prizrenit						sipas OSBE	sipas MAPH	
	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2000	Para lufte 1991	Pas lufte 2001
	54766	60153	70331	98290	134590	178679	236039	178723	225531

Komuna e Prizrenit	Numri përgjithshëm i banorëve në zonat urbane		Numri përgjithshëm i banorëve në zonat rurale	
	sipas MAPH			
	Para lufte 1991	Pas lufte 2001	Para lufte 1991	Pas lufte 2001
	89360	112750	89360	112750

² Zhvillimi Ekonomik Lokal 2003-2006

Qyteti i Prizrenit	NUMRI I BANORËVE NË PRIZREN NË VITE TË VEÇANTA								
	sipas Enti Statistikor i Prizrenit						Sipas ESP ³	Projeksioni sipas ritjes natyrore rreth 40%	
	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2001	2013	
	20540	22997	28062	41631	61801	93035	134900	193157	

Nga tabela shihet se për 33 vite, (1948-1981) indeksi i rritjes së popullsisë së Prizrenit është për 3.01 herë, derisa në mungesë të regjistrimit real të popullatës pas vitit 1981, sipas shtimit natyror rritja është llogaritur rreth 40% (në raport me periudhën dhjetëvjeçare) 1991-2001 (rreth 134900 banorë), si dhe numri i projektuar për 2013 midis 180'000-200'000 banorë (rreth 193157 banorë).



³ Sipas Entit Statistikor Prizren: Të dhënat për vitin 1991 janë vlerësuar sipas metodave statistikore

4.3 MODELI I QYTETIT

Indi i qytetit të Prizrenit është shembull tipik i asaj që në arkitekturë quhet organike – e thurur në rreth. Zhvillimi i tillë i indeve përmes gërshetimit të degëve mund të krahasohet, edhe me degët e drunjëve, rrjedhën e lumit e të prrockave, gjurmët e çarjeve të tokës të shkatuara nga thatësia e madhe, etj. Ky ind është rezultat i kundërthënieve në mes të rregullave të vendosura nëpër kohë dhe të ashpërsisë së terrenit, prandaj, vihet në dyshim të besuarit se morfologjia e Prizrenit është vetëm një krijim spontan.



ORIENTIMI MQ 1 – PERIMETRI I QYTETIT

- 4.1 Veçanti e Prizrenit është depërtimi i pjesës së sheshtë të qytetit në natyrën përreth. Një gjë e tillë mund të spjegohet gjatë vështrimit të natyrës së një njësie bazë e cila e ka kushtëzuar mënyrën e zhvillimit të vet qytetit. Ansamblet e vjetra të cilat janë kryesisht të ruajtura, janë njësi të cilat nuk janë zhvilluar jashtë perimetrit të tyre por eventualisht në brendinë e vet. Në një strukturë të tillë, hapi i ardhshëm zhvillimor ishte i kushtëzuar nga thërmimi i hapësirës së vendosur prej hapit paraprak.
- 4.2 Zhvillimi i mëvonshëm i indit të qytetit është rezultat i një shkëputjeje artificiale, e cila ka rezultuar me degradim të formës së zhvillimit autokton të morfologjisë së Prizrenit. Përvetësimi i një formati të ri i cili do ta kthente aspektin autokton të zhvillimit por duke i respektuar kushtet dhe kërkesat e së sotmes, paraqet një sfidë të përhershme në planifikimin e përmasave të pjesëve (njësive bazë të reja) dhe të raporteve brenda një tërësie.

ORIENTIMI MQ 2 – STRUKTURA URBANE

- 4.3 Strukturat urbane në këtë Plan janë quajtur grupe (ansamble) banimi. Ansamblet e banimit në Prizren janë mikrorajone urbane të cilat paraqesin një aglomerat të kapacitetit hapësiror që përfshin rreth 40-50 struktura banimi me oborre të veta. Grupet e banimit (mahallat) karakterizohen me organizim hapësiror me përmasa joformale por njëkohësisht koherente. Për nga struktura hapësirore, janë formuar si tërësi stabile mbi parimin organik, si nënsisteme, dhe si të kushtëzuara nga konfiguracioni i terrenit. Në mënyrë të theksuar veçohen "kurrizi" i lëvizjeve e që

janë rrugët dhe rrugicat, të cilat çojnë në bërthamën e ansamblit. Efekti i arritur përmes lakoreve organike të rrugëve dhe rrugicave, të cilat kanë një strukturë në formë të rrjetit të parregullt, karakteristike për qytetin e Prizrenit, është pikërisht efekti i befasisë i cili vjen gjatë perceptimit dhe përjetimit nga rrugët e ansambleve të banimit.

- 4.4 Në shikim të parë, ansamblet e vjetra të cilat janë kryesisht të ruajtura, duket sikur në vete bartin kushte të vështira të banimit, si psh., dendësia e



madhe e banorëve, insolimi i pamjaftueshëm dhe ajrosja e dobët. Mirëpo, shtëpitë e këtyre ansambleve janë të mbrojtura në këtë aspekt, pikërisht përmes pozitës që kanë dhe ndërlidhjes me strukturën përreth. Analizat tregojnë se raporti i shtëpisë ndaj fqiu është i shprehur ashtu që tek shtrirja indore (kur një brinjë është më e gjatë e një më e shkurtër) distanca më e madhe është distanca e e brinjës së lirë, gjegjësisht, distanca është më e madhe se në rastin e shtrirjes vargore (kur që të dy brinjët janë të shkurtëra). Ndërkaq, raporti i shtëpisë ndaj parcelës është i shprehur ashtu që është e “ngjitur” për fqiu duke ruajtur për vete hapësirën më të madhe të mundshme të oborrit të vet

- 4.5 Për nga karakteristikat morfologjike, perimetri i tërësisë së një grupi të banimit (mahalle) mund të karakterizohet si pjesë publike. Indi këtu është më i dendur dhe kalimi prej pjesës publike në atë private (brendia e tërësisë) bëhet në mënyrë rigoroze përmes portave që lidhin rrugën me oborret e shtëpive. Për dallim nga perimetri i grupeve të banimit, dyqanet e qarshisë kanë formë drejtkëndëshe kryesisht të drejtë me brinjë më të shkurtër kah pjesa publike, janë përdhese ose edhe me një kat sipër dhe janë të shtrira në varg dhe të ngjeshura mes vete.
- 4.6 Zhvillimet e mëvonshme të strukturës urbane janë bërë pa ndonjë format të përcaktuar, prandaj sot ballafaqohemi me një trend të zhvillimit dhe distribuimit të strukturave urbane pa ndonjë koncept të mirëfilltë që ka rezultuar me shtrirje joadekuate dhe njëherit joorganike, gjë që e rithekson shkëputjen e zhvillimit të mëhershëm të indit autokton prizrenas.

ORIENTIMI MQ 3 – RRUGËT, RRUGICAT DHE UDHËKRYQET E SHESHET

- 4.7 Rrugët dhe rrugicat (sokaqet e dikurshme) të ansambleve të shtëpive paraqesin vende publike të përmasave intime dhe janë krijuar si rezultat i përshtatjes në topografinë e terrenit, të dedikuara për lëvizje të këmbësorëve dhe qerreve tërheqëse me një gabarit relativisht modest kryesisht prej 4m. Në realitet, profili i

tyre variron prej shkallës së interesit kur ai kalon nga niveli publik në atë privat. Në vendin ku ndërrohet drejtimi i lëvizjeve shfaqet hapësira për qëndrim dhe pushim të shkurtër në formë të udhëkryqit apo të sheshit. Aty zakonisht ndodhet qeshmja që e përforcon idenë e qëndrimit të shkurtër gjatë ndërrimit të drejtimeve, Morfologjia e udhëkryqit prizrenas e nxjerr në pah natyrën e saj si nyje e ngjeshur, gjegjësisht, tendencën që të zbutet presioni i lëvizjes dhe që të parandalohet gërshetimi i drejtimeve. Kontribut të veçantë në këtë drejtim kanë dhënë tehet jokënddrejte por të harkëzuara të shtëpive të cilat gjenden skaj rrugëve, meset e formuara të lira (në kuptim të çfarëdo shfrytëzimi tjetër) të këtyre vendqëndrimeve, si dhe zgjerimi i rrugëve në formë të hinkës në pikat e derdhjes së rrugëve. Gjatë vrojtimit analitik, mund të konstatohet



se për nga përmasat gjeometrike, udhëkryqet me më shumë krih apo sheshet si dhe udhëkryqet e qarshive zënë sipërfaqe më të madhe dhe janë më të hapura sesa ato të ansambleve të shtëpive. Një fakt i tillë rrjedh si nevojë që dyqaneve nëpër skaje t'u ipet më shumë hapësirë.

- 4.8 Ajo që është trashëguar nga indi tradicional është insistimi i qytetarëve prizrenas që jetën dhe zhvillimin e tyre t'a lidhin pikërisht me rrugën, udhëkryqin, sheshin më frekuentiv (si dikur, në indin e qytetit të vjetër), dhe në veçanti me afërsinë e përhershme me lumin dhe me urat.

ORIENTIMI MQ 4 - ZHVILLIMI I RI LONGITUDINAL I QYTETIT

Ndërtimet relativisht më të vonshme në Prizren që kapin periudhën rreth qindvjeçare dhe vazhdojnë më tej, mund të kategorizohen si:

- E reja në të vjetrën, brenda bërthamës së qytetit, dhe
- E reja pranë së vjetrës, përfaqë bërthamës së qytetit

Që të dy relacionet janë kritike në prezentimin e formës së re urbane që me këtë plan merr kahje të zhvillimit përgjatë Lumbardhit në pjesën perëndimore të qytetit, duke i vendosur bazat e një koncepti të ri longitudinal në mënyrë që, përfundimisht, Prizrenit t'i këthehet fenomeni i ujit (lumin) si bosht dhe frymë e zhvillimit të mëtutjeshëm.

ORIENTIMI MQ 5- E REJA NË TË VJETRËN BRENDA BËRTHAMËS SË QYTETIT

- 4.9 Degradimet e shkaktuara artificiale në të cilat i përjetoi bërthama, gjegjësisht, pjesa e vjetër e qytetit e kanë shmangur atë nga forma autoktone e zhvillimit. Orientimet e

këtij plani synojnë që të bëjnë "riparimin" e të gjitha "lëshimeve" në aspektin urb-arkitektonik, në mënyrë që të arrihet një zbutje midis së resë dhe së vjetrës.

- 4.10 Qëllimi qëndron në përshtatjen sa më të madhe të mundshme të përmbajtjeve ekzistuese që janë relativisht të reja, me strukturën



natyrore të Prizrenit në mënyrë që të arrihet aq sa është e mundur lidhshmëria organike në mes të vjetrës dhe të resë. Zbutja e kontrasteve në këtë relacion do të ndikojë thellësisht në parandalimin e degradimeve eventuale të mëtutjeshme.

- 4.11 Të menduarit urban mbështetet në krijim e një vazhdimësie të formatit autokton me një koncept të ri: e reja sa më e aftërt së vjetrës – duke mos krijuar kontraste të kohës por duke gjeneruar harmoni dhe përshtatje midis të vjetrës dhe së resë, gjë që nuk do të bëhet përmes metodologjisë së kopjes por, pikërisht, çdo veprim që ndërmirret në zhvillimet e mëtutjeshme të bëhet në frymën e kohës.



ORIENTIMI MQ 6- E REJA PRANË SË VJETRËS PËRQARK BËRTHAMËS SË QYTETIT

- 4.12 E reja pranë së vjetrës përfaqë bërthamës së qytetit do të zhvillohet me të njejtën frymë si në bërthamë të qytetit, por në kontekstin e tërësisë së re që krijohet me zgjerimin e qytetit. Orientimet e këtij Plani synojnë që të gjitha strukturat e reja të cilat do të zënë vend në kahje të ndryshme të zhvillimit të qytetit, të gjenerojnë lidhmërinë organike me pjesën e vjetër të qytetit. Është konceptuar ndërlidhja e strukturave përmes kalimeve graduale. Përmes planifikimit të përmasave të pjesëve dhe të raporteve të tyre brenda një tërësie urb-arkitektonike, ky proces i kalimit gradual do të gjenerojë transformimin e formës dhe të vëllimeve të strukturave si dhe lëvizjen harmonike vertikale të objekteve, e veçanërisht të atyre të cilat do të shtrihen përgjatë akseve kryesore rrugore të Prizrenit në drejtim të Gjakovës, Kukësit dhe Prishtinës.


- 4.13 Në këto arterie rrugore do të formohen sheshe dhe bulevarde (rikthimi i idesë së hapësirave për qëndrim dhe pushim të shkurtër në formë të udhëkryqit apo të sheshit që poashtu do të përmbajnë Fontana e kroje si



vazhdimësi e qeshmeve të dikurshme, etj.), të cilat ndërhyjnë dhe e bëjnë më atraktive gjatësinë e shprehur të një rruge të tillë me komunikacion të shpejtë dhe frekuentiv. Në të dy anët e këtyre rrugëve do të ngriten objekte të larta, sipas konceptit të shtrirjes amfiteatrale në terren, pra, të ngritura në lartësi përmes shkallëzimit gradual që shmanget nga rruga, duke e rijetësuar fenomenin e erkerit në kontekstin bashkëkohor. Në koncipimin e këtyre arterieve githashtu është simuluar ideja e rrugëve të dikurshme për të cilat syzohet se ishin përrocka apo rrëkej që rrethonin frontet e njësive urbane (mahallave). Tani këto rrugë frekuentive e rijetësojnë idenë e lumit me vizura të hapura në dy dimensione:

- **në gjatësi** - përmes përdhësës transparente, në kuptimin e materialit të përdorur për mbështjellje të hapësirave të përdhësës që njëherit përbëjnë front transparent të rrugëve që mundëson vizura të mira;
- **në lartësi** - përmes shmangies amfiteatrale (shkallëzimit) në të dy anët e rrugës me një arkitekturë që simulon erkerin në secilën etazhë të ngritur dhe të shmangur nga rruga, me çka hapet fronti tërthor i rrugës dhe krijon vizura të mira.

4.14 Momenti i kyçjes në zonën e mbrojtur (qendrën e vjetër të qytetit) me ç'rast përfundojnë strukturat e larta për të kaluar mëpastaj në etazhitet më të vogël, do të shkaktohet efekti i befasisë së këndshme (efekti i befasisë i cili vllente edhe më parë në koncipimin e rrugëve, udhëkryqeve dhe pikëderdhjeve të drejtimeve rrugore të vjetra) me ç'rast ***"para nesh zbulohet Prizreni i bukur!"***



10

PLANI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Sistemi i planifikimit luar rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit dhe në promovimin e praktikave të mira mjedisore, që të dyja këto që Kuvendi Komunal i përcakton si synime të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të Prizrenit. Ky kapitull përfshin orientimet të cilat janë dizajnuara për t'i mbrojtur karakteristikat specifike të mjedisit.

Kuvendi Komunal zotohet për hartim të Planit për Mbrojtje të Mjedisit bazuar mbi vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe planeve për mbrojtjen e resurseve si dhe përmirësimin e gjithëmbarshtëm të gjendjes së mjedisit në Prizren dhe rrethinë.

Orientimet nëpër kapituj të veçantë, ofrojnë qasje të cilat Kuvendi Komunal i konsideron të jenë qenësor në kompletim të Planit për Mbrojtje të Mjedisit. Zgjidhjet për Ndotësit si industria, trafiku, ujërat e zeza, janë dhënë si të veçanta në kapitujt përkatës për ndotësit në fjalë (shif Kapitujt 7, 8 dhe 9)



10.1 Ndotja e mjedisit është një brengë e madhe për qytetarët e Prizrenit. Të ndërgjegjësuar për mbrojtjen e mjedisit të tyre jetësor, qytetarët e Prizrenit, të mbështetur nga organizatat e ndryshme, kanë nxitur iniciativa qytetare për pastrimin e rrugëve dhe gjithashtu pastrimin sistematik pranë shtëpive të tyre.

10.2 Brengë tjetër në këtë aspekt është edhe ndotja e lumit Lumbardh, që vjen si rezultat i hudhjes së hedhurinave nëpër fshatëra direkt në lum. Gjithashtu, prerja e pyjeve dhe erozioni paraqesin problem madhor mjedisor me të cilin ballafaqohet Prizreni.



10.3 Kuvendi Komunal dëshiron që të mbrohen karakteristikat ekzistuese të vlerave mjedisore të cilat e avansojnë kualitetin e rrethinës ku jetojnë njerëzit dhe aty ku është e mundur, të avansohen për gjeneratat e ardhshme. Zhvillimet e reja do të duhej të kontribuojnë

në kualitetin mjedisor dhe nuk do të duhej të cenon hapësirën e lirë planifikuese të cilën e gëzojnë banorët dhe vizitorët.

10.4 Prioritetet E Komunës për investime në të ardhmen e shpejtë janë:

- pyllëzimi i pyjeve të prera
- mbrojtja ligjore e pyjeve
- Krijimi i një institucioni i cili do ta luftonte ndotjen e ajrit, ujit, tokës
- Vetëdijësimi, në nivel të arsimit local, lidhur me mbrojtjen e resurseve natyrore
- Ndërprerja e përdorimit të zhavorit nga brigjet e Lumbardhit në lokacion më të gjerë
- krijimi i parqeve të gjelbruara në qytetin e Prizrenit dhe më gjerë.



10.5 Përveç kësaj, Kuvendi Komunal potencon ngritjen e vetëdijes lidhur me çështjet mjedisore si dhe inkurajon dhe mbështet qasje të reja në konstruktivitet të zhvillimit në përgjithësi. Prandaj ky kapitull përfshin një numër të orientimeve, të hartuara për të ndryshuar dhe inkurajuar mënyrat e planifikimit dhe të projektimit që kanë për qëllim nxitjen e përdorimit racional të burimeve natyrore, adoptimin e ushtrimeve të sigurta mjedisore dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

ORIENTIMI MA1- VLERËSIMI MBI NDIKIMIN NË MJEDIS

Gjatë shqyrtimit të propozimeve për zhvillim të cilat mund të kenë efekte të rëndësishme mjedisore, në aspektin e natyrës, vëllimit ose lokacionit të zhvillimit, Kuvendi Komunal i Prizrenit do të kërkojë që propozimi të hartohet konform Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit si dhe do të kërkojë dorëzimin e Vlerësimi mbi ndikimin në mjedis (VNM) për t'i identifikuar këto efekte më saktësisht.

10.6 Kuvendi Komunal është zotuar për avancim dhe mbrojtje të mjedisit dhe të hapësirës së banorëve të atij mjedisi. Prandaj është e rëndësishme që të vlerësohen me kujdes të gjitha efektet që një zhvillim mund t'i shkaktojë mjedisit. Në rast se zhvillimi i propozuar dëshmon efekte madhore në mjedis, Kuvendi Komunal do të kërkojë që të gjitha aplikacionet për planifikim të kenë të bashkangjitur VNM-në, e cila duhet të japë shpjegime lidhur me atë se si, psh. zhvillimi e parashef mbrojtjen e ekologjisë ose të karakteristikave tjera natyrore të



asaj zone dhe duhet t'i demonstrojë mjetet e përshtatshme për këtë qëllim, si dhe të parashef alternative të zhvillimit.

ORIENTIMI MA 2 - RAJONET E MBROJTURA

Rajonet e mbrojtura janë definuar në ligj me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së disa tipareve të vlefshme natyrore që kanë rëndësi të vlefshme topografike, ekologjike apo rekreative. Kuvendi Komunal i Prizrenit do të promovojë dhe sigurojë avancimin e mbrojtjes së mjedisit në gjithë zonën e Planit. Brenda zonave të propozuara në Hartën e Propozimeve si zona të mbrojtjes, leja do të refuzohet për zhvillime që mund të kenë ndikim cenues material në vlerat mjedisore, kulturore, shkencore, gjeologjike, etj., të zonës me përcaktim të veçantë.



Pesha që ndërlidhet me dëmet eventuale të lartpërmendura rritet varësisht nga rëndësia e përcaktuar e zonës së mbrojtur (Shiko Shtojcën 1). Aty ku është e përshtatshme, do të vendosen konditat ose obligimet planifikuese për të mbrojtur dhe avancuar interesat e mbrojtjes së natyrës së lokacionit dhe për të siguruar masa kompensuese të përshtatshme si dhe mirëmbajtje të lokacionit.

- 10.7 Kuvendi Komunal është zotuar për të mbrojtur dhe avancuar mbrojtjen e mjedisit në Prizren., prandaj detyra e tij është që të përfshijë orientime në kuadër të orientimeve të planit zhvillimor, që mbrojnë lokacionet me interesa të mbrojtjes së natyrës të nivelit lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Rëndësia e këtyre lokacioneve në Prizren është reflektuar në rangimin e përcaktimeve dhe në rëndësinë specifike të habitateve të veçanta. Kjo mund të veçojë prezencën e bimëve dhe shtazëve specifike. Kjo gjithashtu mund të ketë lidhshmëri me ato lokacione që janë të rëndësishme për shkak të interesave të veta qenësore shkencore.
- 10.8 Zhvillimet që vënë në dyshim ose që dëmtojnë vlerat qenësore të lokacioneve me përcaktim të tillë, do të trajtohen në bazë të rezultatit të VNM-së. Prandaj propozimet për zhvillim duhet të bashkangjasin vlerësimet e ndikimeve në mjedis (VNM), dhe detalet e çfarëdo mjeti të përshtatshëm për mbrojtje dhe avancim. Gjithashtu mund të jetë e nevojshme që të bëhet edhe dorëzimi i detaleve lidhur me menaxhimin e lokacionit të cilat spjegojnë se si do të arrihet një gjë e tillë.

ORIENTIMI MA 3 - MBROJTJA E LLOJEVE TË SHTAZËVE DHE BIMËVE, DRUNJËVE DHE GJELBËRIMIT RRETHUES/ MBROJTËS

Do të refuzohen zhvillimet që mund të shkaktojnë dëme eventuale të llojit të shtazëve ose bimëve ose të grupqëndrimit (biodiversitetit) të tyre, të cilësuar si burime natyrore me

vlerë¹, përveç nëse shtrohen konditat që kërkojnë nga zhvilluesi të ndërmarrë hapa për të siguruar mbrojtjen e tyre. Kuvendi Komunal zotohet për t'i mbrojtur drunjët që nuk hyjnë në tokë pyjore² si dhe tokat pyjore³ të definuara me Ligjin mbi Pyjet.

Zhvillimet që mund të dëmtojnë ose shkatërrojnë një dru të mbrojtur ose një drurend i cili është nën mbrojtje, normalisht do të refuzohen. Në lokacionet që nuk janë "toka pyjore" (Ligji mbi Pyjet) në të cilat lejohet preja e drunjëve ose drurendeve të mbrojtura, do të kërkohet zëvendësimi i tyre (rimbjellja) me lloj, madhësi të duhur dhe në lokacion të përshtatshëm.

10.9 Kuvendi Komunal është zotuar se do të sigurojë mbrojtje të drejtë të burimeve natyrore me vlerë. Kjo veçori do të konsiderohet gjatë procesit të planifikimit detal të zonës në funksion të promovim dhe avancim të mjedisit ekologjik në tërë Prizren.

10.10 Drunjët dhe gjelbërimi rrethues ofrojnë biodiversitet të rëndësishëm për gjallesa dhe kontribuojnë në pamjen vizuale dhe kualitetin e mjedisit. Drunjët dhe gjelbërimi



rrethues gjithashtu mund të ofrojnë strehim dhe mund të ndihmojnë në uljen e zhurmës dhe të ndotjes atmosferike. Zhvillimet që mund të rezultojnë me humbje ose dëmtim të biodiversiteteve natyror (përfshirë këtu drunjët dhe gjelbërimin rrethues) do të trajtohen konform rezultateve të VNM-së.

10.11 Kuvendi Komunal pajtohet me rëndësinë që kanë drunjët për karakterin dhe hapësirën e lirë planifikuese të zonës. Prandaj drunjët do të mbrohen për shkak të kontributit në karakterin dhe shtrirjen e tyre pejsazhore, për hirë të funksionit të mbikqyrjes dhe

¹ Burimet Natyrore me Vlerë: Fenomeni i njohur natyror që është shumë i vlefshëm, i paktë dhe unik, dhe që është konsideruar si i tillë me ligj apo me akte normative; një burim i tillë natyror mund të përfshijë fenomen unik gjeografik siç janë fosilet, mineralet të pazakonshme, akumulime apo formacione, shpella, gërxhe, ujvara, liqene, lumej, fusha me ujë, bimë dhe kafshë unike, si dhe ekosisteme dhe pejsazheve. (Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit).

² Pemishtet; Toka brenda zonave të banimit, përfshirë parqet urbane; Parqet dhe zonat e tjera për mbrojtjen e resurseve natyrore të përcaktuara me ligje; Tokat ku drunjët janë mbjellë në radhë parësisht për të kontrolluar erozionin, krijuar mburojë nga era, për hije ose përmirësim të estetikës; Anët e rrugëve që janë mbjellë me drunj, dhe Toka ku parcela e përshtatshme për kultivimin e drunjëve është më e vogël se 0.1hektar. (Ligji mbi Pyjet)

³ Sipërfaqja e tokës e cila shërben për prodhimin e drurit ose prodhimeve të tjera pyjore respektivisht sipërfaqja e tokës e destinuar për kultivimin e pyjeve". (Ligji mbi Pyjet)

potencialit për minimizimin e ndotjes së ajrit. Faktorët tjerë, si rëndësia që kanë për shtazët, gjithashtu mund të merret parasysht.

- 10.12 Kuvendi Komunal pranon faktin, që sidoqoftë, forma të caktuara të zhvillimit mund të jenë të pranueshme pasi që të jenë adoptuar kushtet planifikuese për mbrojtje ose avancim të biodiversitetit. Në disa instanca, do të kërkohet që zhvillimet e reja, nëse kanë leje, të ofrojnë zëvendësim të avancuar për humbje apo shqetësim të ndonjë biodiversiteti, përfshirë planin e menaxhimit i cili demonstroi se si do të arrihej një gjë e tillë dhe se sa e qëndrueshme do të jetë në periudhë afatgjate. Në raste kur ruajtja e drunjëve ose e gjelbërimit rrethues të mbrojtur (ekzistues) nuk është më praktike, do të kërkohet provizion për zëvendësim adekuat.

ORIENTIMI MA 4 - PROMOVIMI I EKOSISTEMIT NË LOKACIONET E ZHVILLIMIT

Kuvendi Komunal do të kërkojë projektet e shtrirjes së zhvillimit për t'a bërë më të lehtë ruajtjen e ekosistemit përfshirë edhe resurset ujore.

- 10.13 Kuvendi Komunal është zotuar për promovim dhe avancim të ekosistemit. Propozimet për zhvillime të reja duhet të përfshijnë masa adekuate të cilat do t'a inkurajonin barazpeshimin e ekosistemit. Kjo mund të bëhet përmes (ose si pjesë e) zonave të përshtatshme peizazhore, brenda lokacionit të zhvillimit. Në rrethana adekuate, Kuvendi Komunal i Prizrenit do të parashtrojë kushte ose politika planifikuese për të siguruar marrëveshje për menaxhim mjedisor, përmes së cilës do t'i ipej ndihmë qëndrimit dhe avancimit të lokacionit me vlera ekologjike.

ORIENTIMI MA 5 - MBROJTJA E TOKËS AGRARE

Zhvillimet që mund të rezultojnë me humbje të përhershme ose degradim të tokës agrare të klasifikuar si tokë më e mirë dhe më e plleshme, do të refuzohen përveç nëse dëshmohet ekzistenca e një kërkese qenësore për zhvillim dhe se nuk ka alternativë tjetër të përshtatshme dhe me kualitet më të ulët agrar.

- 10.14 Kuvendi Komunal njeh faktin se toka më e mirë dhe e frytshme paraqet burim natyral të çmueshëm, e që është e rëndësishme si në kontekstin kombëtar ashtu edhe në atë lokal. Në interes të parimeve për zhvillim të qëndrueshëm, humbja e një toke të tillë normalisht nuk do të lejohej. Sidoqoftë, Kuvendi Komunal njeh faktin se mund të ketë nevoja të reja që involvojnë humbjen e tokës agrare. Për zhvillimin e lokacioneve të kategorizuara si tokë e mirë dhe plleshme, do të vendoset sipas dispozitave ligjore në fuqi.

ORIENTIMI MA 6 - SHFRYTËZIMI EKONOMIK I RESURSEVE NATYRORE, MENAXHIMI I HEDHURINAVE

Kuvendi Komunal i Prizrenit do të:

- Përkrahë zhvillimet e reja që në vete kanë propozim për minimizim në konsumimin e burimeve kryesore të ujit, energjisë elektrike, dhe gasit;
- Përkrahë përfshirjen e masave për konzervim të energjisë si dhe eksplotimin e energjisë alternative;
- Përkrahë sistemin integruar të ngrohjes dhe të energjisë, nëpër ndërtesa të propozuara;
- Pret që propozimet të demonstrojnë se si do të minimizohen gjenerimi i hedhurinave si dhe shfrytëzimi i ujit dhe i energjisë, nëpër ndërtesa të propozuara; dhe
- Inkurajojë që sipas mundësisë, të bëhet inkorporimi i shërbimeve/mjeteve për reciklim të ujit dhe hedhurinave, të cilat do të vehen në dispozicion të shfrytëzimit publik.

10.15 Si pjesë e synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, Kuvendi Komunal inkurajon ndërtesa efektive në aspektin mjedisor dhe atë të energjisë. Kuvendi Komunal i Prizrenit do të shfrytëzojë autoritetin e vet për planifikim, për të negociuar ndërtimin e ndërtesave të qëndrueshme në aspektin mjedisor, përmes shfrytëzimit dhe operimit me konsumim të energjisë elektrike dhe të prodhimit të hedhurinave në ndërtesë.

10.16 Mbrojtja e resurseve të shterrshme për gjeneratën e tanishme dhe të ardhshme, është ngusht e lidhur me menaxhimin e hedhurinave. Menaxhimi i hedhurinave do të bëhet konform parimeve evropiane (psh. trajtimin e hedhurinave përmes sortimit, reciklimit⁴ dhe djegies).

ORIENTIMI MA 7 – HAPËSIRA E LIRË PLANIFIKUESE DHE NDOTJA

Zhvillimet që mund të cenojnë shëndetin, mjedisin, ose hapësirën e lirë planifikuese, për arsye të lëshimit ose për arsye të të qenit afër ndotësve të ujit, tokës ose ajrit (përfshirë ndotjen përmes zhurmës, vibrimeve, kundërmimeve, tymit, pluhurit dhe hedhurinave do të trajtohen konform rezultateve të VNM-së.

⁴ Riciklim, me ligj është definuar si, mbledhje selektive e mbeturinave komunale me qëllim të riprodhimit dhe ripërdorimit. Materiali i njëjtë përdoret për të prodhuar një produkt të njëjtë ose të ngjashëm me të përparshmen. (Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit)

10.17 Sistemi i planifikimit luan rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, të banorëve, bizneseve dhe të pjesëve publike në përgjithësi, nga të gjitha format e zhvillimeve që mund të shkaktojnë rritjen e ndotjes. Ndotja mund të ketë forma të ndryshme dhe përfshin materiet e ngurta, lëngëta dhe të gazëta që lëshohen në ajër, tokë dhe ujë, nga të gjitha llojet e zhvillimeve.



10.18 Propozimet do të gjykohen mbi baza të prioriteteve dhe ndikimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor të llojit të caktuar të zhvillimit

ORIENTIMI MA 8 - NDOTËSIT E MJEDISIT

Burimi kryesor i ndotjes së ajrit janë industria dhe ndotja nga trafiku. Oksidet e sulfurit karbonit dhe nitrogjenit, halogjenet dhe materialet e rënda janë ndotësit kryesor bashkë me pluhurin që gjenerohet nga menaxhimi i mbeturinave.

10.19 Në mungesë të të dhënave të mëvonshme nga niveli qëndror dhe në pritje të përcaktimit të standardeve të emisioneve apo shkarkimeve, KK Prizren është në pamundësi që të bëjë vlerësimin e nivelit konkret të ndotjes së mjedisit. Prandaj, projektimi i gjendjes ashtu që të ulët koeficienti i ndotjes në Prizren, do të finalizohet pasi që të jenë siguruar kushtet për te. Në vijim janë dhënë vlerësimet për burimet e ndotjes si dhe vizioni për trajtimin e kësaj problematike. Burimet kryesore të ndotjes rrjedhin nga:

- **Trafiku automobilistik** – Trafiku automobilistik është trajtuar në Kapitullin “Promovimi i Trafikut të Integruar”. Zgjidhjet e këtij plani për avancimin e rrjetit rrugor do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë së trafikut në përgjithësi dhe njëherit, uljen e ndotjes e cila rrjedh nga trafiku. Masat dhe aktivitetet për menaxhim të trafikut, të dhëna në Orientimin TI 10, përfshirë masat për qetësim të trafikut dhe masat tjera që do të ulnin efektet negative në mjedis (shndërrimin e rrugëve automobilistike në shtigje për këmbësorë, etj.), synimi për përdorim të karburanteve që kanë përqindje më të vogël të ndotjes e që lidhet me aprovimin e standardeve në nivelin qëndror.
- **Industria** – në momentin që të përvetësohen standardet në nivelin qëndror, do të bëhet rishqyrtimi i ndotësve industrial të ambientit (shif Aneksin 1 – Ndërmarrjet në Prizren) dhe do të ipen të gjitha parametrat (matjetet, sygjerimet dhe projektet e duhura). Pasi të jetë përfunduar një proces i tillë, do të bëhet



shqyrtimi dhe modifikimi i nevojshëm i kësaj pjese të planit të përgjithëm, gjegjësisht, i Planit për Mbrojtjen e Mjedisit.

- **Pompat e benzinës** – sipas të dhënave të MMPH, shpenzimet për person në Kosovë gjatë gjithë vitit 2002 të derivative për automjete janë:
 - Dizel – 14.831 L/person
 - Benzinë – 12.227 L /person


Për shkak të mungesës së shënimeve të sakta për qytetin e Prizrenit, si dhe në mungesë të parametrave të nivelit lokal dhe qendror për ndërtimin dhe planifikimin e pikave shërbyese të karburanteve, ky plan nuk mund t'a parashf rrjetin, gjegjësisht, numrin e duhur të punkteve të karburanteve në qytet. Konsiderojmë se rrjeti i tanishëm i plotëson nevojat e shërbimieve të tilla kurse për lagjet e reja, gjatë hartimit të planeve rregulluese, do të mirret parasysh edhe vendosja e punkteve të karburanteve. Deri në kohën e implementimit të planeve të veçanta rregulative, shpresojmë se, stadardet më se të nevojshme, do të jenë aprovuar nga niveli qendror.

- **Kanalet e hapura**, duhet të rregullohen dhe duhet të jenë kanale për ujëra të pastra. Të gjitha ujërat e zeza dhe të ndotura duhet të futen në rrjetin e projektuar dhe planifikuar të kanaleve për ujëra të zeza, me çka kanalet e hapur pastrohen nga ndotja. Kanalet e hapura, aty ku është e mundur, duhet ta luajnë rolin e indit të stabilizimit të vërshimeve. Rrjeti i kanaleve të hapura (ekzistuese dhe të reja) do të parashifet me plane rregulluese..

ORIENTIMI MA 9 – DEPONITË E MBETURINAVE

10.20 Menaxhimi e hedhurinave si dhe mirëmbajtjen/pastrimin e rrugëve në qytetin e Prizrenit e bën Ndërmarrja Publike "Higjiena", në bashkëpunim me Drejtoratin për Shërbime Publike praën Kuvendit Komunal, KFOR-in, BE-në dhe me organizatat qeveritare dhe joqeveritare. Në ditë mbledhen rreth 630 m³ ndërkaq në muaj rreth 13,860 m³; Mbeldhja e hedhurinave nga shtëpitë bëhet një herë në javë. Meqë kapacitetet dhe fondet për këtë veprimtari janë të mangëta, Është e shprehur nevoja për asistencë të mëtutjeshme në mënyrë që të arrihet kualitet më i mirë i shërbimeve të dhëna.

10.21 Është panifikuar deponia regjioale e quajtur Deponia Sanitare Regjionale në Prizren, (Landovicë). Kjo deponi do të ofrojë shërbime për Rajonin e Prizrenit, Therandës, Gjako-



vës, Malishevës, Rahovecit, dhe ka kapacitet prej 2.500.000 m³, (sipas AER), e projektuar për 500.000 banorë. Kohëzgjatja e përdorimit të kësaj deponie është paraparë të jetë 18-20 vjet. Objektet përcjellëse të parapara në këtë lokacion janë: peshorja, administrata shtëpia për mbledhjen e gasit, sipërfaqet për selektim; të parapara me projekt janë zonat e reciklimit (3 sektorët kryesorë janë të punuar me gjeomembranë).

Mbeturinat urbane të llogaritura në kg/person (marrë nga Pamkos, Prishtinë):	
kg mbeturina për 1 person / ditë	= 0.6 - 0.8 kg/ditë/banor

Deponimi ihedhurinave të ngurta regjionale	Minimumi isynimit apo standardit përfundimtar evropian
	<ul style="list-style-type: none"> Standarde minimale për mbrojtje shëndetësore *Së paku një në nivel regjional *1 ha/ 2500 amvisëri

ORIENTIMI MA 10 - RICIKLIMI LOKAL DHE INDUSTRIA E PROCESIMIT TE HEDHURINAVE LOKALE

Leja do të ipet për reçiklim të hedhurinave në përmasa të vogla dhe për industritë për procesimin e tyre nëpër lokacione të përshtatshme, me kusht që:

- Nuk cenohet aspektin vizuel i hapësirës së banorëve të asaj rrethine; dhe
- Nuk ka implikime të papranueshme të transportit

10.22 Burimet natyrore të Tokës janë të harxhueshme prandaj ekziston nevoja për t'u siguruar se mundësitë për sortim, djegie dhe reciklim të hedhurinave janë hulumtuar tërësisht. Kuvendi Komunal dëshiron t'i shoh provizionet për reçiklim të hedhurinave të përmasave të vogla dhe industritë për procesimin e tyre nëpër lokacione të përshtatshme.

Zhvillimi i shërbimeve për menaxhim të hedhurinave të përmasave të vogla është fundamental në arritjen e strategjisë për procesim të hedhurinave të integruara, duke përfshirë këtu rishfrytëzimin dhe riçiklimin e hedhurinave. Shërbimet/mjetet me kapacitet deri 25'000 tonelata në vit përfaqësojnë shërbime të përmasave të vogla.

ORIENTIMI MA 11 - NDRIÇIMI I RRUGËVE DHE NDRIÇIMET TJERA TË JASHTME

Do të kërkohet që ndriçimet e jashtme të vëzhgohen dhe të drejtohen ashtu që të mbisundohet terri gjatë natës dhe të ulet ndotja e panevojshme me ndriçim.

10.23 Aty ku propozimet e zhvillimeve involvojnë ndriçim të jashtëm, Kuvendi Komunal i Prizrenit do të kërkojë ndërmarrjen e masave të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e hapësirës së lirë planifikuese, gjegjësisht, intimitetin e banorëve në fqinjësi si dhe mbrojtjen e karakterit vizuel të zonës. Ndriçimi i jashtëm i ndërtesave dhe i hapësirave mund të shkaktojë ndriçim të padëshirueshëm që pengon në sytë e njerëzve. Kjo gjithashtu mund të shkaktojë pengesa të shfrytëzuesit e rrugëve. Brengat tjera dalin nga efekti ndriçues (reflektimi) i qiellit që në veçanti bëhet gjatë natës. Ndriçimi i padëshirueshëm që pengon në sytë e njerëzve përveç që konsiderohet si ndotje vizuale, gjithashtu paraqet shfrytëzim joefikas të energjisë elektrike dhe humbje të resurseve natyrore.

ORIENTIMI MA 12 - NDRIÇIMI ME REFLEKTORË I QENDRAVE SPORTIVE

Ndriçimi me reflektorë i qendrave sportive ekzistuese ose të reja do të lejohet me kusht që:

- Nuk shkakton shqetësime vizuale të papranueshme;
- Nuk shkakton shqetësime të papranueshme në zonën përreth;
- Nuk shkakton rrezik në rrugë.

10.24 Ndriçimi me reflektorë i qendrave sportive shpesh rezulton me shfrytëzim më efektiv të qendrës duke e zgjatur kështu kohën e shfrytëzimit për njerëz të cilët në të kundërtën nuk do të ishin në gjendje të marrin pjesë nëpër aktivitete të sportit. Si përjashtim nga orientimi i përgjithshëm për restriksion të ndriçimit të jashtëm, leja për planifikim do të ipet për ndriçim me reflektorë të qendrave sportive, në situata ku shfrytëzimi i tyre nuk rezulton me humbje të papranueshme të hapësirës autonome. Aty ku është e përshtatshme, do të vendosen restriksione në natyrën dhe intenzitetin e ndriçimit si dhe në orarin e shfrytëzimit të tij, për të siguruar mbrojtje adekuate të hapësirës vizuale dhe të hapësirës (autonome) të lirë planifikuese të banorëve.

ORIENTIMI MA 13 - NDËRTIMET NE AFËRSI TË UJIT TË RRJEDHSHËM

Do të refuzohen zhvillimet në fqinjësi të lumit Lumbardh dhe në rrjedhat tjera ujore ku projektet dhe shtrirja e zhvillimit të propozuar dështon në përfitim të plotë nga pejsazhi i qytetit, pejsazhi natyror dhe mundësitë për grupqëndrimeve natyrore të cilat mundësohen përmes karakteristikave të ujërave në natyrë dhe margjinave të tyre.

Për propozimet për zhvillim në fqinjësi të Lumbardhit do të kërkohej VNM, përfshirja e shtigjeve të përshtatshme të ecjes dhe e vendqëndrimeve për pushim. Çdo propozim që kërkon provizion të ndonjë ure të re, duhet të sigurojë min. 2,3m përfundi urës nga niveli i ujit, për të mundësuar kështu shfrytëzimin e lumit dhe për të ofruar pasazh të përshtatshëm për faunën, të përshtatshme për korridore të florës dhe faunës.

10.25 Lumbardhi dhe brigjet e tij janë element madhor në formimin e karakterit të Prizrenit si zonë urbane. Këto mundësojnë që gjelbërimi i rrethinës të futet nëpër zona të


ndërtuara duke lidhur kështu parqet dhe hapësirat publike me shtigje për ecje dhe çiklizëm, si dhe me korridore për florë dhe faunë. Vlerat vizuale dhe hapësirore të lumit duhet të vehen në shërbim publik së bashku me rrjetin e vlerave rekreative të shtigjeve për ecje dhe çiklim dhe me avancim të pjesëve të hapura, në ndërkohë që të respektohen grupqëndrimet e florës dhe faunës ekzistuese.

- 10.26 Në Prizren, ujërat rrjedhëse shpesh ofrojnë mundësi për brigje ujore publike të avancuara. Ndërtesat nëpër brigje ujore të tilla duhet të jenë përballë ujit dhe të krijojnë hapësira publike. Potenciali për rekreim dhe argëtim që i shfrytëzojnë këto brigje, së bashku me krijimin e hapësirave të dëshirueshme për jetesë, duhet hulumtuar në tërësi.

Aneks 1/K10

Ndërmarrjet shtetërore dhe private të cilat prodhojnë/deponojnë materiale/mbeturina të rrezikshme dhe të tjerat që konsiderohen ndotës të ambientit janë:				
	Ndërmarrja	Lloji i veprimtarisë	Materiale të rrezikshme	shënim
1	I.F.K "Farmakos" PZ	Prodhime farmaceutike	Etanol, propanol	
2	"Abi-Elif19" PZ	Industri e qumështit dhe ushqimit	Amonjak	Përdoret për ngrirje të thellë në sasi të ndryshme (prej 1000-5000 litra)
3	"Fruktus" Prizren	Fabrika e mishit	Amonjak	
4	"As Petrol"	Pompë e furnizimit me karburante	Gaz-Butan	Shitje e gazit në Sasi prej 40 m ³
5	"Pagarusha-Petrol"	Pompë e furnizimit me karburante	Gaz-Butan	Shitje e gazit në Sasi prej 12 m ³
6	Firma tjera që nuk janë nën kontroll sepse nuk janë të regjistruara		Gaz-Butan	Shitje e gazit në sasi më të vogla
7	"Cvileni"		Klori	Klorifikim i ujit të pijes
	Punëtoritë e ndryshme si:	serviset për ndërrimin e vajit motorik, autolarjet, etj.		Gjithashtu, nuk ka bërë përmirësime në rrjetin e kanalizimit për sistemim të ujërave të zeza
	"Higjiena"	Pastrami dhe grumbullimi i mbeturinave		Menaxhon me Deponinë e fshatit Korishtë
		Ekzistojnë edhe gjeneratorë tjerë aktual të mbeturinave të rrezikshme (spitali, qendra e veterinarisë...) – për të cilët ka shënime të pakta		

Stacionet e derivate të naftës në Komunën e Prizrenit, 2003					
<i>Të dhënat KK Prizren, 2003</i>					
#	LOKACIONI	Nr.	#	LOKACIONI	Nr.
1	Qyteti i Prizrenit	9	7	Mamushë	6
2	Dushanovë	4	8	Piranë	5
3	Gjonaj	1	9	Poslisht	1
4	Korishtë	3	10	Reçanë	1
5	Krushë e Vogël	1	11	Romanjë	1
6	Lubizh. E qytetit	1	12	Vlashnjë	1
			13	Zhur	2
GJITHSEJ					36



Kuvendi Komunal i Prizrenit dëshiron që të gjitha zhvillimet të projektohen mirë dhe të formojnë pjesë integrale të qytetit të cilat vazhdojnë t'u shërbejnë kërkesave, gjithnjë në ndryshim, të shfrytëzuesve të tyre. Projektimi i mirë ndihmon shfrytëzim të qëndrueshëm të tokës, përshtat format fizike të lokacioneve dhe të konteksteve, si dhe siguron që zhvillimi i ri të bëhet vlerë e përhershme e mjedisit.

Forma fizike e zhvillimit duhet t'i reflektojë orientimet e këtij plani dhe duhet t'i përmbushë kërkesat për shfrytëzim të tokës. Njëkohësisht, forma fizike paraqet rast të mirë për t'i kontribuar karakterit të zonës. Kuvendi Komunal i Prizrenit synon që zhvillimi të gjenerojë një sens tipik për secilin pjesë të zonës. Është përgjegjësi e atyre që do të punojnë në plane rregulative që të njohin rëndësinë e projektit të mirë për hirë të suksesit të zhvillimit si dhe të imazhit dhe kualitetit të zonës më gjerësisht. Kuvendi Komunal do të kërkojë projekte të shkëlqyeshme urb-arkitektonike për të fuqizuar imazhin e qytetit të Prizrenit.

Arritja e kualitetit në zhvillime të reja kërkon qasje bazuar në objektivat projektuese:

- propozimet për zhvillime që dalin nga të kuptuarit e plotë të lokacionit dhe të kontekstit;
- vlerësimi i opsioneve për lokacionet; zhvillime të projektuara për lokacionin përkatës e jo zhvillime të ashtuquajtura “projekte tipike të ndërtimit” të cilat pastaj “paqetohen” në lokacion;
- zhvillime të testuara përballë standardeve numerike e jo të udhëhequra nga ato.

11.1 Themelet e secilit zhvillim duhet të vihen në bazën e vlerësimeve të lokacionit dhe të kontekstit. Një gjë e tillë bën që të kuptohen karakteristikat specifike të lokacionit, si dhe pengesat dhe mundësitë. Vlerësimi i tillë shqyrton topografinë, ekologjinë, peisazhin dhe arkeologjinë e lokacionit, shtigjet ekzistuese dhe strukturat e ndërtuara, natyrën e kufijve të lokacionit dhe pronat fqinje, vizurat brenda dhe jashtë lokacionit, peisazhin rrethues dhe objektet, pikat referente, formën urbane dhe përmasën e rrethinës. Ky vlerësim u ndihmon projektantëve që t’i respektojnë pengesat fizike të lokacionit dhe karakterin e zonës përreth.

11.2 Këto orientime synojnë realizimin e vizionit të Kuvendit Komunal për Prizrenin si një qytet në rritje si dhe avancimin e kualiteteve të rrethinës.

11.3 Ky vizion është përfaqësuar përmes katër parimeve të projektit urb-arkitektonik:

- **Kualiteti më i mirë i jetesës** - përmes zhvillimeve që u përgjigjen kërkesave të banorëve;
- **Ndërtesat dhe peizazhi të projektuara bashkërisht/njëkohësisht** - në mënyrë që të pasurohet karakteri i zonës;
- **Zhvillime të lidhura dhe të integruara me zonat përreth;** dhe
- **Shtirirja e zhvillimit të jetë e sigurt dhe njëkohësisht e afërt për njerëz.**

ORIENTIMI AK 1 – PROJEKTIMI NË PËRPUTHSHMËRI ME KONTEKSTIN

Të gjitha ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese, të trajtuara sipas orientimeve të përcaktuara me këtë Plan, duhet të jenë në harmoni me lokacionin e tyre në mënyrë që ta fuqizojnë, avansojnë ose ta mbrojnë karakterin e zonës përkatëse. Kjo nënkupton që:

- Zhvillimi i ri të ketë lidhje të mirë dhe të jetë i integruar në zonë dhe më gjerë;
- Shtirirja, vëllimi dhe projekti i zhvillimit të propozuar të formojë raport të përshtatshëm vizuel me formën, veçantitë, përmasën, materialet dhe detalet e zonës përreth;

- Projekti i ndërtesës të bëhet veçmas për lokacionin dhe kontekstin e tij, duke respektuar dhe jo detyrimisht, ndryshuar karakteristikat lokale, si dhe të jetë i përshtatshëm me stilin e vet të zgjedhur;
 - Zhvillimet e propozuara në lokacionet me perceptim vizuel të lartë t'a avansojnë imazhin dhe perceptimin e zones në përgjithësi.
- 11.4 Kuvendi Komunal i Prizrenit do të kërkojë që zhvillimet e reja t'i përshtaten qartazi kontekstit lokal dhe të avansojnë karakterin e zonave të ndërtuara; zhvillimi i ri i çfarëdo përmase ka potencial që të ndikojë mjaft në pamjen dhe karakterin e zonës. I gjithë zhvillimi është pjesë e një procesi të vazhdueshëm të riformësimit, plotësimit, zgjerimit ose avancimit të formës së ndërtuar dhe të pejsazhit të një lokaliteti. Ndërtesa gjithmonë shifet në raport me rrethinën e jo vetëm si e veçantë. Zgjerimi gjithnjë shifet në raport me ndërtesën ekzistuese. Prandaj zhvillimet e reja duhet të përputhen me shtrirjen, formën dhe pamjet e zhvillimeve në rrethinë. Projektet e zhvillimeve duhet të respektojnë formën dhe pjesët e definuara të zonës përkatëse.
- 11.5 Se sa do të ndikojë konteksti në projektim varet nga:
- shkalla e perceptimit vizuel
 - ndikimet e zhvillimeve të reja ndaj ndërtimit ekzistues ose pejsazhit;
 - koherenca (reciprociteti) dhe pajtueshmëria e situimit në kuptimin e kualitetit të avansuar, vijave ndërtimore, formave të ndërtuara, përmasës, detaleve, materialeve dhe hapësirave në mes të ndërtesave; dhe
 - objektivat projektuese që janë relevante për zona specifike.
- 11.6 Zona Qëndrore Orientuese ka karakter të definuar dhe posedon forma të qëndrueshme të zhvillimit të cilat duhet respektuar, në ndërkohë që zonat tjera në kuadër të Tërësive Qarkore Orientuese do të mbështeten në zhvillime të reja për të përmirësuar formën e tyre fizike ose për të ngritur karakterin e tyre.
- 11.7 Kuvendi Komunal do të synojë standard të lartë gjatë projektimit, sidomos nëpër lokacionet e rëndësishme brenda zonave të mbrojtura, si dhe do të kërkojë detale (të hollësishme) të materialeve dhe të projekteve arkitektonike.

ORIENTIMI AK 2 - ZONAT URBANE TË REJA SI MJEDISE TË SUKSESSHME

Propozimet për zhvillim që përmbajnë një ose më shumë ndërtesa të reja duhet të projektohen ashtu që të krijojnë mjedis të suksesshëm për jetë dhe punë si dhe kualitet të lartë të hapësirës publike. Zhvillimet do të lejohen me kusht që:

- blloqet e ndërtesave, rrugët dhe hapësirat të jenë të ndërlidhura qartësisht mes vete;
- të gjitha funksionet të jenë të integruara në formë fizike;
- shtrirja e zhvillimit të ketë shtigje për këmbësorë ku do të lëvizet pa pengesa;

- zonat publike të jenë qartësisht të ndara nga zonat private;
- ndërtesat individuale të shifen si pjesë e një grupi në mënyrë që të krijohet sensi i një zone të përkufizuar;
- frontet e ndërtesave t'i definojnë rrugët, sheshet dhe hapësirat e gjelbëruara; ose duke i fuqizuar hapësirat ekzistuese, ose duke formuar hapësira tërësisht të reja;
- frontet e ndërtesave të jenë aktive me hyrje dhe të kenë dritare kah rrugët dhe kah hapësirat publike;
- sipërfaqet e jashtme të jenë funksionale, të sigurta dhe të këndshme;
- të mënjanojnë dhe të shmangen kërcënimet nga krimi dhe pasiguria; dhe
- të evitohen efektet e dëmshme mikroklimatike.

11.8 Kualiteti i zhvillimit të ri përfundimisht do të vlerësohet në bazë të asaj se sa është një zhvillim i këndshëm për të qëndruar dhe vizituar, se sa është i lehtë orientimi dhe lëvizja nëpër te, sa është e shprehur ndjenja e sigurisë, çfarë raporti ka ndërtesa me hapësirat përreth dhe sa atraktive është ndërtesa në përgjithësi. Këto veçanti janë të rëndësishme në të gjitha zhvillimet, qofshin ato zhvillime të vogla apo të mëdha.

11.9 Forma dhe shtrirja e zhvillimeve, e menduar mirë, janë çelës për krijim të vendeve të suksesshme për banim dhe punë. Forma tridimensionale, kualiteti i hapësirave dhe llojllojshmëria e shfrytëzueshmërisë së tokës, e gjeneron sensin e një vendi. Ndarja e qartë e hapësirave publike nga ato private, rrugët me qasje të mirë dhe dritaret e orientuara kah rruga, çojnë në vende të sigurta dhe funksionale, me mundësi të zvogëluara për krim.

ORIENTIMI AK 3 – PËRMBUSHJA E KËRKESAVE FUNKSIONALE

Zhvillimet e propozuara duhet të vendosen ashtu që të sigurojnë që:

- qasja në lokacion të jetë e mirë
- lëvizja/qarkullimi nëpër situacion dhe lokacion të gjerë të jetë e planifikuar ashtu që të reflektojë hierarkinë e modaliteteve [këmbësorët, personat me vështirësi në të lëvizur, çiklistët, shfrytëzuesit e transportit publik, mjetet motorrike me dy rrota, shfrytëzuesit e bizneseve komerciale, vizitorët dhe blerësit që lëvizin me vetura; dhe punëtorët që udhëtojnë me vetura për në vend të punës - shif Orientimin TI 4, Kapitulli "Trafiku i Integruar].
- ndërtesat të jenë të orientuara mirë dhe të kenë ndriçim, vizura dhe intimitet të duhur; dhe
- mos të cenohet destinimi ose intimiteti i pronave tjera.

11.10 Pavarësisht nga madhësia apo destinimi i zhvillimit, kërkohet planifikim i kujdesshëm i lokacionit në mënyrë që të sigurohet shfrytëzimi efikas i tokës. Kërkesat funksionale

të destinim të propozuar duhet të situohen ashtu që të qëndrojnë në raport me karakteristikat specifike të situacionit. Pikat e kyçes për në lokacion do të duhej të vendosen ashtu që të kenë lidhje të mirë me rrjetin ekzistues të rrugëve dhe të shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë.

- 11.11 Kuvendi Komunal synon mbrojtjen e hapësirës planifikuese meqë zhvillimet mund ta blokojnë ndriçimin, vizurat dhe të rrezikojnë sigurinë. Prandaj, vendosja, madhësia dhe orientimi i strukturave të propozuara, nuk do të duhej të dëmtonin intimitetin, ndriçimin, vizurat apo sigurinë e banorëve të pronave në fqinjësi.

ORIENTIMI AK 4 – PROJEKTIMI I PEIZAZHIT

Kuvendi Komunal i Prizrenit do të kërkojë që të gjitha hapësirat në të hapur të kenë projekt peizazhor (projekt për hortikulturë) si pjesë integrale e zhvillimit të propozuar, në mënyrë që të avancohet funksioni dhe karakteri i hapësirave si dhe që të arrihet integrimi i zhvillimit në rrethinë. Leja për planifikim do të ipet me kusht që:

- projekti i peizazhit (projekt për hortikulturë) të përputhet me funksionin dhe karakterin e hapësirave dhe të rrethinës së ndërtesës;
- drunjët, gjelbërimi i ulët, brezet gjelbëruese dhe elementet karakteristike me vlera peizazhore të integrohen në planifikim të ri;
- ndërtesat dhe platotë në të hapur të kenë distanca të mjaftueshme nga drunjët dhe nga gjelbërimi i ulët ekzistues në mënyrë që të evitohet dëmtimi i rrënjëve gjatë punëve të dheut;
- trajtimi i kufijve të lokacionit të ipet si pjesë integrale e zhvillimit; dhe
- shtruarja e platove dhe “orenditë” e rrugës të projektohen ashtu që të lehtësohet lëvizja e këmbësorëve dhe e çiklistëve, si dhe të avansohet siguria e këmbësorëve.

- 11.12 Gjelbërimi i ri i propozuar duhet të vendoset dhe të mirëmbahet në mënyrë të duhur. Në rastet kur lejohet ndërtimi afër drunjëve, është e nevojshme mbrojtja e tyre gjatë punëve në punishte.

- 11.13 Peizazhi i sipërfaqeve të shtruara (rrugët, trotoaret, etj.) dhe i hapësirave të jashtme të gjelbëruara e bën zhvillimin më atraktiv. Shtrirja dhe trajtimi i hapësirave në të hapur e përcakton mënyrën e shfrytëzimit të asaj hapësire dhe të lëvizjes së njerëzve në te, Kjo është veçanërisht e rëndësishme aty ku zhvillimet përfshijnë rrugë të reja publike ose hapësira të lira të reja.

- 11.14 Projektimi i sipërfaqeve të lira, përreth ose ndërmjet ndërtesave, është i rëndësishëm sa vetë projekti i ndërtesave. Projekti peizazhor i të gjitha sipërfaqeve të shtruara dhe i hapësirave të jashtme të gjelbëruara duhet të jetë pjesë integrale në planifikim. Projektimi jo adekuat i hortikulturës rezulton me gjelbërim nëpër vende joadekuate. Këto projekte duhet të përfshijnë mbjelljen e drunjëve dhe të brezeve gjelbërues të

rinjë. Hapësirë e mjaftueshme do të ofrohet për të krijuar elemente karakteristike peisazhore si dhe hapësirë për drunjë të lartë dhe të moshuar.

- 11.15 Projektimi i peizazhit duhet t'i mbajë elementet karakteristike natyrore me vlerë, aty ku është e mundur, dhe të njejtat duhet të mbrohen nga dëmtimet gjatë ndërtimit. Punët ndërtimore dhe deponimi e materialeve, normalisht nuk do të lejohen nën hijet e drunjëve ekzistues.
- 11.16 Muret rrethuese, rrethojat dhe gjelbërimi rrethues në fqinjësi të pjesëve publike duhet të projektohen si pjesë përbërëse e ndërtesave dhe e peizazhit dhe të veprojnë si mjet efektiv dhe atraktiv.

ORIENTIMI AK 5 - MADHËSIA DHE INTIMITETI I KOPSHTEVE

Do të kërkohet që të gjitha hapësirat e propozuara të kenë nivel të lartë të intimitetit dhe shfrytëzim adekuat të kopshteve private, varësisht nga lloji i destinimit dhe lokacioni i tij. Kuvendi Komunal i Prizrenit do të japë lejen për zhvillim me kusht që të jetë konform me madhësinë e kopshtit dhe me kritueriumin e intimitetit.

- 11.17 Kopshtet dhe ballkonet funksionale dhe të këndshme janë të rëndësishme për arritjen e kualitetit në zhvillimet e reja të banimit. Hapësira e kopshtit për pronarin nënkupton hapësirën personale në të hapur, për rekreim, rregullim të kopshtit dhe për deponim. Kopshti gjithashtu ofron sensin qenësor të të qenit në të hapur, ndërkaq nëpër shtëpi, ofron mundësi për zgjerime të mundshme të ndërtesës. Intimiteti dhe kualiteti i kopshteve duhet të jetë në raport të ngushtë me llojin e ndërtesës dhe llojin e lokacionit.
- 11.18 Përveç që i përmbush kërkesat e banorëve, kopshti siguron raport të duhur mes ndërtesave dhe të hapësirave nëpër zonat e banimit. Në zhvillimet e dendura, rrugët me karakter urban duhet të balancohen me një mjedis privat të qetë dhe të hapur. Në zhvillimet me dendësi të ulët, kopshtet private i ndajnë shtëpitë dhe mundësojnë zhvillimin e karakterit të peizazhit.

ORIENTIMI AK 6 - PROJEKTIMI I DESTINIMEVE JORESIDENCIALE

Zhvillimet komerciale të përmasave të mëdha duhet të projektohen ashtu që të kontribuojnë në karakterin dhe identitetin e zonës. Leja për planifikim do të ipet me kusht që:

- shtrirja dhe projekti i strukturës i konsideron në mënyrë të duhur elementet karakteristike të lokacionit dhe kontekstin e tij;
- forma e ndërtesave të ketë raport të drejtpërdrejtë me rrugët dhe hapësirat;
- shërbimet dhe parkingjet e veturave të jenë të vendosura larg rrugëve dhe peizazhit të projektuar, në raport me ndërtesën;

- **hyrjet, zonat publike, zyrat dhe elementet karakteristike të jenë të dhëna në etazhe dhe në këndet kyçe të zhvillimit; dhe**
- **materialet, ngjyrat dhe shenjat duhet të përcaktohen në të njejtën kohë kur edhe forma e ndërtesës.**

11.19 Zhvillimet industriale, depotë, rekreimi, shoppingu me shtrirje të madhe sipërfaqësore, bloqet e biznesit privat me sallat për prezentim, kanë përmasa të mëdha dhe enterier efektiv të ndërtesës. Konstruksionet metalike me sistemet e mureve zakonisht projektohen me vëmendje minimale ndaj shtrirjes dhe pamjes së jashtme të ndërtesës, por shpesh janë më se të dukshme dhe të shëmtuara.

11.20 Edhe pse vëllimi dhe teknologjia e ndërtimit, që kërkohet për këto destinime, nuk mund të krahasohen me formën dhe karakterin tradicional të ndërtesave, ato duhet t'u përshtaten parimeve bazike të projektimit urb-arkitektonik, që nënkupton: respektimin e lokacionit dhe të kontekstit, sigurimin e lidhjeve direkte me rrugët dhe me rrethinën, adaptimin e formës së kufijve të situacionit gjegjësisht vijave të rrugës, dhe krijimin e pamjeve interesante dhe atraktive.

11.21 Kuvendi Komunal do të insistojë që ndërtesat e reja dhe ato të ridestinuara komerciale t'i kontribuojnë kualitetit vizuel dhe të gjenerojnë karakter adekuat për zona komerciale.

ORIENTIMI AK 7 - DEKLARATA MBI PROJEKTIN

Për lokacione të mëdha dhe komplekse, Kuvendi Komunal do të kërkojë hartimin e një raporti i cili duhet të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësiror. Ky raport, gjegjësisht, deklaratë e projektit urbanistik, do të përmbajë:

- **dëshminë për vlerësimin e lokacionit dhe të kontekstit;**
- **identifikimin e pengesave dhe mundësive;**
- **objektivat e projektit;**
- **opcionet alternative të projektit urbanistik;**
- **qasjen racionale për shtrirjen dhe në vëllimin; dhe**
- **sqarimet për trajtimin e projektit bashkë me detalet e propozuara.**

11.22 Deklarata e projektit urbanistik, sipas rekomandimit të kwtij Planit të Përgjithshëm të Qytetit të Prizrenit, do të duhej të ofrojë sqarime lidhur me atë se si janë adresuar pengesat dhe mundësitë e situacionit, se çfarë raporti ka zhvillimi me kontekstin lokal, si dhe sqarime lidhur me qasjen e propozuar për situim, vëllim, funksion dhe pamje. Një gjë e tillë është e nevojshme për t'i ndihmuar Kuvendit Komunal gjatë përzgjedhjes së propozimeve aty ku projekti është çështje kyçe.

11.23 Në hartimin e planit rregulativ - detal, projektantët duhet të demonstrojnë se e kanë analizuar kontekstin e rrethinës dhe duhet të dëshmojnë se si zhvillimi i propozuar përmbush objektivat projektuese për zonën gjegjëse.

12

IMPLEMENTIMI

Ky kapitull përcakton se si do të implementohen propozimet dhe orientimet e këtij Plani, të parashtruara në Kapitujt 2-11, si dhe popozimet madhore të cilat do të përshkruhen më vonë në këtë kapitull. Pjesët Grafike të Propozuara prezentojnë orientimet që ndikojnë në çdo fushë të veçantë.

Mospërputhjet eventuale në të kuptuarit përmbajtësor në mes të Pjesëve Tekstuale dhe Pjesëve Grafike të Planit të Përgjithshëm për Qytetin e Prizrenit dhe, Pjesa Grafike ka përparësi.

ORIENTIMI IMP1 - KONTROLLI I ZHVILLIMIT

Që të sigurohet shfrytëzim sa më i mirë i tokës dhe planifikim i duhur i zonës, Kuvendi Komunal do të vendos kushte, aty ku është e mundshme, për sigurim të marrëveshjes legale.

- 12.1 Shumë nga orientimet e Planit hyjnë në fuqi përmes procesit të kontrollit të zhvillimit. Kuptimi dhe qëllimi i "Planit të Përgjithshëm për Qytetin e Prizrenit 2003-2013" është përcaktuar në Kapitullin 1. Ky Plan krijon mundësi për zhvillime, në ndërkohë që nuk mund t'a bëjë të obligueshëm inicimin apo realizimin e zhvillimeve. Nuk është rol i këtij Plani të destinojë burime publike financiare për projekte siç janë, përmirësimi i rrugëve, përmirësimet ambientale dhe hapësirat e hapura publike. Plani vetëm mund t'i identifikojë lokacionet dhe tokat për projekte të tilla.
- 12.2 Inicimatorët kryesorë të ndryshimeve dhe zhvillimeve në Prizren gjatë periudhës së Planit do të jenë aplikantët për leje planifikimi/ndërtimi. Prandaj, Kuvendi Komunal, kryesisht, do ta implementojë këtë Plan përmes kompetencave që ka për dhënie ose refuzim të lejeve planifikuese. Gjatë shqyrtimit të aplikimeve për zhvillim, Kuvendi Komunal do të udhëzohet përmes orientimeve të këtij Plani. Kushtet relevante dhe të arsyeshme do t'i bashkangjiten lejeve, kudo që të jetë e nevojshme, duke rregulluar kështu formën dhe destinimin e zhvillimeve të aprovuara.
- 12.3 Aplikimi preciz i orientimeve të këtij Plani do të varet nga kombinimi i destinimeve të dëshiruara, lloji i lokacionit si dhe nga objektivat specifike për fusha relevante të projektimit. Prandaj Kuvendi Komunal do t'u ndihmojë aplikantëve për leje planifikimi/ndërtimi që të dalin me projekte sa më të mira, si dhe do t'u ndihmojë zyrtarëve dhe këshilltarëve për planifikim, në vlerësimin e propozimeve.
- 12.4 Zhvillimi i kualitetit të mirë fillon me njohjen e fakteve nga ana e aplikantëve lidhur me ndertesën në fjalë. Ndërtesa ekzistuese apo e re ka vlerë publike dhe kërkon përzgjedhje të projektanteve të duhur e të kualifikuar, të cilët kanë njohuri të projektimit urbanistik. Shkathtësitë e projektanteve janë çelës në kërkesat për njohje të orientimeve dhe në aftësinë e tyre për t'a analizuar lokacionin dhe kontekstin, për

të hulumtuar opcionet dhe për të projektuar me origjinalitet dhe talent. Shumë nga zhvillimet në Prizren janë bërë pa asistencë të arkitektit apo të projektantit të duhur, prandaj është rezultuar me kualitet të dobët.

- 12.5 Materialet e prezentuara me aplikacione shfrytëzohen për konsultime publike dhe legale, si dhe për vlerësim të kualitetit të skemave projektuese. Ky material duhet të jetë i kompletuar, i saktë dhe lehtë i kuptueshëm. Fakti se është kuptuar konteksti bashkë me spjegimet e bazave të projektit urbanistik, duhet gjithashtu ta shoqërojë aplikacionin. Udhëzuesi për aplikantët do të jetë në dispozicion për metodat për projektim urbanistik dhe për informatat e kërkuara për aplikacione.
- 12.6 Procesi i kontrollit të zhvillimit ka për qëllim ta lehtësojë projektimin e mirë dhe shfrytëzimin sa më racional të tokës. Kuvendi Komunal i inkurajon të gjithë aplikantët, e sidomos ata të zhvillimeve të mëdha, që t'i fillojnë negociatat për projekte sa më herët që të jetë e mundur para se të bëhet aplikimi për planifikim.
- 12.7 Kuvendi Komunal do t'a promovojë dhe varësisht nga resurset, do ta iniciojë avancimin e ambientit, për ta përmirësuar kualitetin vizuel, qasjen e lehtësuar, destinimin, si dhe vlerat e sigurisë dhe të intimitetit të hapësirave dhe rrugëve publike ekzistuese.
- 12.8 Zhvillimet dhe përdorimet e paautorizuara, aty ku është e mundshme, do të largohen, modifikohen apo të ndalohen, përmes vendosjes në fuqi të veprimeve gjegjëse.
- 12.9 Nga zhvilluesit do të kërkohet që t'i sigurojnë kërkesat sociale, ambientale dhe të infrastrukturës, si dhe kostot që dalin si rezultat i drejtpërdrejtë i propozimeve zhvillimore. Marrëveshjet legale gjithashtu do të nënshkruen në mes të Kuvendit Komunal dhe zhvilluesve. Duhet punuar në qasjen e gjithëmbarshme vendore për masat që kanë të bëjnë me trafikun. Shembujt e avantazheve planifikuese të cilat i synon Kuvendi Komunal janë të dhëna më poshtë:
- Provizionet për shkolla dhe instiucione tjera të arsimit
 - Bibliotekat
 - Shendetësia primare
 - Hapësirat e hapura publike
 - Shërbimet komunale, përfshirë vendet sakrale
 - Rekreimi, artet, argëtimi dhe sporti
 - Shërbimet/objektet e trafikut publik dhe profitet përkrähëse për shërbimet
 - Infrastruktura e re e qarkores së qytetit;
 - Shërbimet për parkim dhe trafiku urban;
 - Kontrollimi i parkimit në rrugë;
 - Qetësimi fizik i trafikut dhe masat tjera;
 - Shërbimet për këmbësorë, çiklistë dhe motoçiklistë;
 - Avancimet ambientale;

- Arti publik, dhe
- Banimi ekonomik

ORIENTIMI IMP 2 - PLANIFIKIMI I HUMBJEVE

Kuvendi Komunal i Prizrenit kërkon që aplikacionet për ndërtim t'i përfshijnë propozimet të cilat:

- Kanë të bëjnë me kërkesat për infrastrukturë të zhvillimeve; dhe
- Sigurojnë që mos të ketë humbje planifikuese konsekuente të komunitetit ekzistues.

12.10 Të gjitha zhvillimet do t'i kenë shpenzimet e komunitetit ekzistues për infrastrukturë sociale, ambientale dhe të infrastrukturë komunale. Që të mundësohet mirëvajtja e zhvillimit, Kuvendi Komunal sipas mundësisë, do të kërkojë nga zhvilluesit të bëjnë provizion për komunitetin në tërësi për shpenzimet që dalin direkt nga zhvillimet e tilla.

ORIENTIMI IMP 3 - PËRFSHIRJA E BANORËVE NË PROCES TË PLANIFIKIMIT

Kuvendi Komunal i Prizrenit synon pjesëmarrjen aktive të palëve të interesuara në vendimmarrje për çdo veprim të paraparë me këtë Plan.

12.11 Plani i Përgjithshëm për Qytetin e Prizrenit siguron kornizën për vendimmarrje racionale dhe konsistente. Konsultimet publike në Plan i mundësojnë komunitetit afarist prizrenas, organizatave tjera dhe publikut, gjegjësisht, banorëve në përgjithësi, që të marrin pjesë plotësisht në formësimin e orientimeve planifikuese për zonat e tyre. Mbi të gjitha, ky Plan e formon besimin se Plani i Përgjithshëm do të jetë elementi kyç në përcaktimin e zhvillimit dhe në ndryshimin e destinimeve (shfrytëzimin e tokës) në Qytetin e Prizrenit gjatë dhjetë viteve të ardhshme dhe më tej.

ORIENTIMI IMP 4 – MONITORIMI

Kuvendi Komunal do t'a monitorojë efektivitetin e orientimeve dhe propozimeve të Planit, si dhe progresin drejt përbushjes së qëllimeve, në baza vjetore, pasi të jetë adoptuar Plani.

12.12 Në mënyrë që të vlerësohet efektiviteti i orientimeve dhe propozimeve të këtij Plani, është esenciale që të ndërmerret monitorimi i ndryshimeve që shfaqen në Qytet.

12.13 Monitorimi do t'i mundësojë Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe të tjerëve që të vlerësojnë se sa efektive apo jo efektive janë orientimet dhe propozimet e Planit, në përkrahjen apo ndalimin e tipeve të ndryshme të shfrytëzimit të tokës si dhe në ngritjen e ndërtesave të reja dhe të tokës ndërtimore në nivele që plotësojnë kërkesat e Planit.

12.14 Në vijim janë dhënë pikat që do të monitorohen në baza vjetore:

- kompletimi i zhvillimeve të reja të banimit, zhvillimeve industriale, komerciale, të argëtimit, rekreimit dhe shoppingut;
- Vendimet mbi ankeset;
- Detalet e pronave të lira industriale dhe komerciale të përfshijnë sipërfaqen e dyshemesë dhe nivelet e qiradhënies;
- Detalet e të gjithë Punëdhënësve në Qytet t'i përcaktojnë detalet e llojeve të firmave, si dhe llojin dhe numrin e të punësuarve;
- Detalet e pronave të reja industriale dhe komerciale të përfshijnë hapësirat e reja si dhe hapësirat e reja të dhëna me qira, llojin e firmave, si dhe llojin dhe numrin e të punësuarve; dhe
- Frontet e shoppingut të monitorojnë ndërrimin e destinimeve dhe të pronarëve.

12.15 Këto informata do të përdoren në lidhshmëri me shënimet mbi tokën në dispozicion, papunësinë, postet e punës, rritjen e popullsisë dhe nivelin e formacioneve të njëjësive familiare, të cilat ipen nga agjensionet tjera.

ORIENTIMI IMP 5 – SHQYRTIMI, VERIFIKIMI

Shqyrtimi i plotë i Planit do të ndërmirret më 2005 pasi të jenë bërë publike statistikat e reja të dala nga regjistrimi i populates, më tej, do të vazhdojë nëpër periudha të ndërtimit të infrastrukturës ligjore. Pas secilit shqyrtim kritik, sipas nevojës, do të bëhen ndryshimet formale.

12.16 Autoritetet e planifikimit lokal janë të detyruar që t'i mbajnë nën shqyrtim të gjitha çështjet që mund të ndikojnë në zhvillimin e zonave të tyre apo në planifikimin e zhvillimeve në ato zona.

12.17 Edhe pse ky Plan ofron udhëzues të padyshimtë për t'i drejtuar zhvillimet dhe shfrytëzimin e tokës në Qytetin e Prizrenit deri më 2013, është i paevitueshëm fakti se rrethanat në të ardhmen do të nxisin shqyrtim formal.

12.18 Planet duhet të azhurohen sa më shpesh, e sidomos në aspektin e statusit dhe rolit të tyre në përcaktimin e aplikimeve për planifikim, si dhe në të qenit si mjet për të mbështetur dhe për t'i drejtuar zhvillimet nëpër lokacione të duhura. Një gjë e tillë do të çojë në shqyrtim të plotë të Planit, përfshirë këtu, sipas nevojës, edhe ndryshimet formale. Kjo gjë siguron që objektivat dhe qëllimet e Planit, si dhe orientimet dhe porpozimet e tij, të jenë në përputhshmëri me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

ORIENTIMI IMP 9 – PROPOZIMET IMPLEMENTUESE PËR TËRËSITË ORIENTUESE

Zonat orientuese të Qytetit të Prizrenit janë përcaktuar me Kapitullin 3 – “Zonimi Strategjik i Qytetit”. Në vijim janë dhënë propozimet implementuese për Tërësinë Qëndrore Orientuese, Tërësitë Qarkore Orientuese dhe për Zonat e Veçanta të këtij Plani.

12.19 Kuvendi Komunal i Prizrenit do të synojë që të gjitha zhvillimet madhore, qofshin ato ridestinime, zhvillime të reja, rikonstruime apo rrënimë për qëllim të përfitimit të hapësirës të konsistojnë arsyeshmëritë e cekura në vijim:

- a) përmirësimi i rrjetit të rrugëve (conform hierarkisë së rrugëve: rezidenciale dhe publike jorezidenciale, sipas nivelit të rëndësisë);
- b) përmirësimi i qasjes (hapësirave hyrëse) nëpër monumente kulturore-historike (“shkarkimi” i hapësirave hyrëse në veçanti dhe i lokacionit të mbrojtur në përgjithësi);
- c) përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve publike komunale (përmes dislocimit dhe krijimit të hapësirave të reja për shërbime të reja të nevojshme për lokacionin përkatës, conform standardeve të aplikueshme).

12.20 Gjithashtu, Kuvendi Komunal i Prizrenit do t'i orientojë zhvillimet madhore në tokat të cilat pohimisht janë pronë shoqërore/shtetërore, në ndërkohë që do të parashohë që ato toka të cilat janë private por janë të rëndësishme për funksionim të këtij Plani, të shpallen si toka me interes të posaçëm. Format e trajtimit dhe të kompenzimit të pronave private të shpallura si toka të posaçme të interesit komunal do të rregullohen përmes akteve dhe normativave të fuqizuara për plane detale përkatëse.

ORIENTIMI IMP 7 – IMPLEMENTIMI NË TËRËSINË QËNDRORE ORIENTUESE


12.21 Tërësia Qëndrore Orientuese përfshin pjesën territoriale ekzistuese të qytetit të Prizrenit dhe zhvillimi i saj do të trajtohet konform normativave të përvetësuara me këtë plan për trajtimin e ndërtesave/komplekseve të mbrojtura (zonat I, II të Mbrojtjes dhe Zona e Kontaktit), dhe conform standardeve të aplikueshme për funksionin rezidencial dhe jorezidencial të strukturave ekzistuese urb-arkitektonike. Njëherit, për qëllime të prezentimit më të kuptueshëm të trajtimit të kësaj tërësie në kontekstin urb-arkitektonik, është përvetësuar nëndarja fiktive e territorit në kuadratë orto-foto, me dimensione 750 x 750 [m²].

Vërejtje: Objektet ose lokacionet ekzistuese nëpër kuadrante të cilat nuk janë përfshirë në pikat shpjeguese do të trajtohen në kontekste të zhvillimeve të zonave në veçanti, përmes planeve rregullative.

I KUADRANTI [D5]

Në kuadër të kuadranit [D5] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e banimit dhe të shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

[D5.1] Gjimnazi "Gjon BUZUKU"	restaurim dhe sanim
[D5.2] Sh. M. Teknike "G. Çavdërbasha"	restaurim dhe sanim
[D5.3] Shkolla Speciale "Nëna TEREZE"	restaurim dhe sanim
[D5.4] Stadioni Rekreativ , Parku i Qytetit	ridizajnim
[D5.5] Varrezat e Karabashit	zhvillim si Zonë e Re e Piknikut
[D5.6] Ura me Observatorium	zhvillim i ri
[D5.7] Lokacioni pranë Karabashit	ridestrinim/ridizajnim në Qendër Multidisciplinare
[D5.8] Transporti Urban "Prizrentrans"	ridestrinim/ridizajnim në Hotel të kat. "A"
[D5.9] Sektori i Banimit të Ri	ridizajnim në Banim të lartë P+3 deri P+5
[D5.10] Banimi Ekzistues Individual	rehabilitim



[D5.1] Gjumnazi “Gjon BUZUKU” – kompleks nën mbrojtje:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillimet në vijim:

- rregullimi i jashtëm që përfshin oborrin e shkollës dhe fushëlojën;
- restaurimi dhe sanimi i objekteve ekzistuese;
- inkuadrimi i fushëlojës në kuadër të Sistemit të Rekreimit – krijimi i rrjetit me Shkollën e mesme teknike “G. Çavdërbasha”, ndërlidhja në Sistem të Rekreimit (shif Orientimi KOM 27) me Stadionin Rekreativ, Parkun e Qytetit, Zonën për Piknik dhe Qendrën Universale. Në këtë mënyrë
- revidimi i numrit të nxënësve konform udhëzuesve qeveritar dhe parametrave të këtij plani, të elaboruara në Kapitullin “Përmbushja e Kërkesave të Komunitetit- Institucionet Edukative-Arsimore” (standardi 5m² hapësirë shkollore / 1 nxënës)

[D5.2] Shkolla M. Teknike “Gani ÇAVDËRBASHA”: - objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillimet në vijim:

- rregullimi i jashtëm që përfshin oborrin e shkollës dhe fushëlojën;
- restaurimi dhe sanimi i objekteve ekzistuese;
- inkuadrimi i fushëlojës në kuadër të Sistemit të Rekreimit – ndërlidhja fizike me Qendrën për rehabilitimin e fëmijëve me të meta në të folur dhe dëgjim-shkollën Speciale “Nëna Terese, me Stadionin Rekreativ, Parkun e Qytetit, Zonën për Piknik dhe Qendrën Universale.
- revidimi i numrit të nxënësve konform udhëzuesve qeveritar dhe parametrave të këtij plani, të elaboruara në Kapitullin “Përmbushja e Kërkesave të Komunitetit- Institucionet Edukative-Arsimore”

[D5.3] Qendra për rehabilitimin e fëmijëve me të meta në të folur dhe dëgjim - Shkolla Speciale “Nëna TEREZE” - objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillimet në vijim:

- rregullimi i jashtëm që përfshin oborrin e shkollës dhe fushëlojën;
- restaurimi dhe sanimi i objekteve ekzistuese;
- inkuadrimi i fushëlojës në kuadër të Sistemit të Rekreimit – ndërlidhja fizike me shkollën m. Teknike “G. Çavdërbasha” (me këtë arrihet gjithëpërfshirja e të gjithë fëmijëve, e inkurajuar me Orientimin KOM 17 – Arsimi Special), me Stadionin Rekreativ, etj si në pikën [D5.3].
- Përmirësimi i kushteve të mësimi konform udhëzuesve qeveritar dhe parametrave të këtij plani, të elaboruara në Kapitullin “Përmbushja e Kërkesave të Komunitetit- Institucionet Edukative-Arsimore”

[D5.4] Stadioni Rekreativ dhe Parku i Qytetit - hapësira ekzistuese:

KK Prizren do të inkurajojë përmirësimet/ridizajnimin dhe zhvillimet në vijim:

- Zhvillimi i mëtejshëm i parkut sipas standardeve të zbatueshme (Orientimi KOM 27): planifikimi i hortikulturës, shtigjetve të këmbësorëve dhe hapësirave për rekreim pasiv dhe aktiv; ndërlidhja e shtigjeve në system të rekreimit me zonat përreth.

- Katër (4) fusha të reja të tenisit në pjesën jugore të stadionit
- restaurimi dhe sanimi i stadionit dhe tribinave ekzistuese; vazhdimi i tribinave në gjatësi për shikueshmëri të fushave të tenisit, përmbajtjet e reja si zhveshtoret dhe nyjat sanitare për qëllime të rekreimit të këto hapësira

[D5.5] Varrezat e Karabashit - kompleks nën mbrojtje:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillimin e kësaj zone si **Zonë e Re e Piknikut** :

- rregullimi i hapësirës së gjelbruar sipas standardeve të zbatueshme: pyllëzimi, planifikimi i hortikulturës, shtigjet për këmbësorë dhe hapësira për rekreim pasiv dhe aktiv; ndërlidhja e shtigjeve në sistem të rekreimit me zonat përreth përmes urës lidhëse që kalon mbi rrugë.

[D5.6] Ura me Observatorium – zhvillim i ri:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillim të ri:

- strukturë e re që kalon mbi rrugë; lidh shtigjet për këmbësorë të Zonës së re të Piknikut dhe Stadionit me Park. Kjo strukturë do të përmbajë një pyrg për vështrime në largësi (Observatorium) prej ku do të sigurohet "Pika Vështruese Panoramike e Qytetit të Prizrenit, nr. 2"

[D5.7] Lokacioni pranë Karabashit - Objekte ekzistuese -

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin dhe ridizajnimin e këtij lokacioni në

Qendër Universale Multidisciplinare. Zhvillimet që do të ndërmerren janë:

- shfrytëzimi eventual ose rrënimi i strukturave ekzistuese
- ndërtimi i kompleksit ose ndërtesës multidisciplinare; konform standardeve të zbatueshme për këtë lloj objekti (akomodon, sporte rekreative të lidhura me sistemin rekreativ si dhe aktivitete tjera shoqërore, kulturore, edukative, komerciale, etj. Mund të përmbajë auditorium, galeri artesh, bibliotekë, muze, dhe hapësirë për arte performuese: dramatike, korale, orkestrale, vallëzime, arte visuale dhe arte kreative.
- rregullimi i jashtëm i hapësirës (pyllëzimi, shtigjet për këmbësorë, fontana dhe hapësira për rekreim pasiv dhe aktiv; ndërlidhja e shtigjeve në sistem të rekreimit me zonat përreth përmes Urës me Observatorium .

[D5.8] Transporti Urban "Prizrentrans"– Objekt ekzistues

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin dhe ridizajnimin e këtij lokacioni në

Hotel të kategorisë "A":

- shfrytëzimi eventual ose rrënimi i strukturave ekzistuese
- ndërtimi i hotelit të kategorisë A në kompleks me përmbajtje të pishinës dhe me përmbajtje përcjellëse komerciale, tregëtare-zejtare, shërbime, etj.
- rregullimi i jashtëm i hapësirës, ridizajnimi i rrugës për në spital "9a"si depërtim i drejtpërdrejtë e cila do të sigurojë lidhje direkte dhe të shpejtë me Kompleksin Spitalor.

[D5.9] Sektori i Banimit të Ri – Sektor ekzistues i banimit individual

KK Prizren do të inkurajojë ridizajnimin e këtij sektori nw **Banim të Lartë P+3 deri P+5**. Shkalla maksimale e ndërtimit do të jetë 40%-50%. Një ose dy nivele nëntokësore do të përmbajnë garazha parkuese me të gjitha përmbajtjet përcjellëse të ndërtesave. Në akset qendrore kati i parë nëntokësor mund të shfrytëzohet edhe për përmbajtje komerciale; përdhësa gjithashtu akomodon përmbajtjet komerciale dhe serviset. Sipërfaqja shfrytëzuese e kateve përdhësë duhet të jetë nën përqindjen e caktuar të ndërtimit. Zhvillimi i këtij sektori nënkupton:

- shfrytëzimin eventual ose rrënimin e strukturave ekzistuese
- ndërtimin e banimit të ri me etazhitet P+3 i cili do të shtrihet kryesisht nëpër fronte (tangjenta) të rrugëve që e rrethojnë këtë sektor; dhe
- ndërtimin e banimit të ri me etazhitet P+5 i cili mund të vendoset në pjesët qendrore dhe i cili duhet të jetë larg shiritit anësor të rrugëve rreth sektorit në largësi min. prej 6.0-8.0 m.
- Rregullimi i rrugëve që mbështjellin Sektorin e Banimit të Ri dhe kategorizimi në "rrugë me fronte shopping" në tangjentat e sektorit , si dhe kategorizimi i rrugëve brenda sektorit në "rrugë të qeta rezidenciale" me mundësi të zhvillimit të destinimeve të përziera për shërbimet kyçe nëpër përdhësa.

[D5.10] Banimi Ekzistues Individual – banim ekzistues


KK Prizren do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë zonë duke i vendosur kushtet për Rekonstruim:

- Nuk do të lejohet thërmimi i mëtejme i ngastrave kadastrale
- Në Kushtet Urbanistike për rastet kur ngastra kadastrale është e ndërtuar (shfrytëzuar) më tepër se 50%, do të kërkohet zvogëlimi në gabarit deri në 50% të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe do të mundësohet rikonstruimi i objektit deri në P+2.
- Në Kushtet Urbanistike për rastet kur ngastra kadastrale është e ndërtuar (shfrytëzuar) më pak se 50%, nuk do të lejohet rritja e gabaritit ekzistues të objektit, dhe do të mundësohet rikonstruimi i objektit deri në P+2.

II KUADRANTI [D6]

Në kuadër të kuadranit [D6] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

[D6.1] Sh. Fillore "Mustafa BAKIA"	restaurim dhe sanim
[D6.2] Shtypshkronja "Kosova"	ridest./ridizajn. në Përmbajtje të Reja Shkollore
[D6.3] Objekti i ish "Famipës"	ridestitim në Qendër Administrative Lokale
[D6.4] Shkolla Fillore "Lidhja e Prizrenit"	restaurim, sanim dhe ridizajnim
[D6.5] Sh. M. e Medicinës "L. Motroni"	restaurim dhe sanim (opcionale – ridestitim)
[D6.6] Ndërtesa tregëtare e Famullisë	ristrukturim
[D6.7] Shtëpia e Shëndetit II – e vjetër	ridestitim në QMF Kryesore
[D6.8] Objekti i Bashkësisë Lokale	ridestitim në punkt të shërbimit policor
[D6.9] Banimi Ekzistues Individual	rehabilitim



[D6.1] Sh. Fillore “Mustafa BAKIA” – objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillimet në vijim:

- rregullimi i jashtëm që përfshin oborrin e shkollës dhe fushëlojën;
- restaurimi dhe sanimi i objekteve ekzistuese;
- ndërlidhja në kompleks me ndërtesat e Shtypshkronjës (shif D6.2)
- revidimi i numrit të nxënësve ose/dhe ridizajnimi i klasëve, konform udhëzuesve qeveritar dhe parametrave të këtij plani, të elaboruara në Kapitullin “Përmbushja e Kërkesave të Komunitetit- Institucionet Edukative-Arsimore” (standardi 5m² hapësirë shkollë / 1 nxënës)

[D6.2] Shtypshkronja “Kosova” – kompleks ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin dhe pjesërisht ridizajnimin e këtij kompleksi, në **Përmbajtje të Reja Shkollore** përmes zhvillimeve në vijim:

- rrënimi selektiv i strukturave ekzistuese dhe shfrytëzimi/ridestinimi i ndërtesave të mbetura për qëllime të aplikimit të standardeve të zbatueshme për kulturë dhe rekreim në funksion të shkollës fillore “Mustafa BAKIA”. Gjithashtu, ridestinimi do të përfshijë përmbajtje për arsim/aftësim profesional si dhe hapësira për aktiviteteve të asociacioneve dhe organizatave rinore.
- krijimi i hapësirave të lira dhe i gjelbrimit të nevojshëm për sistem të rekreimit.
- Ndërlidhja e këtij lokacioni në një kompleks me sh.f. “M. Bakia” dhe rregullimi i jashtëm i hapësirës së përbashkët (gjelbrimi, shtigjet për këmbësorë)

[D6.3] Objekti i ish “Famipës”, tani N.SH. “LIRIA” – kompleks ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin dhe pjesërisht ridizajnimin e këtij kompleksi, në **Qendër Administrative Lokale**, përmes zhvillimeve në vijim:

- rrënimi selektiv i strukturave ekzistuese dhe ridestinimi/ridizajnimi i ndërtesave të mbetura për qëllime të aplikimit të standardeve të zbatueshme për Qendër të Administratës Lokale (të Njësisë Administrative - Bashkësisë Lokale) e cila do të ketë pjesën e administratës lokale në nivel të njësisë për 10.000 banorë, konform standardeve të zbatueshme për këtë lloj të shërbimit.
- rregullimi i jashtëm i hapësirës për nevoja të destinimeve të reja.

[D6.4] Shkolla Fillore “Lidhja e Prizrenit” (ish Bajram Curri) – objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë zgjerimin e kësaj shkolle dhe zhvillimet në vijim:

- rregullimi i jashtëm që përfshin oborrin e shkollës dhe fushëlojën;
- restaurimi dhe sanimi i objektit ekzistues;
- ridizajnimi i platosë hyrëse, shfrytëzimi nëntokësor i hapësirës nën plato për nevoja të shkollës dhe lidhja fizike me ana tjetër të rrugës me platonë e ish shkollës Normale – sh. mesme e medicinës “Luçiano Motroni”.

- revidimi i numrit të nxënësve në ndërtesë, konform udhëzuesve qeveritar dhe parametrave të këtij plani, si dhe distribuimi i një numri të tyre në ndërtesën e ish-shkollës Normale.

[D6.5] Sh. Mesme e Medicinës “Luçiano Motroni” – objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë **ridestinimin** e këtij objekti në funksion të shkarkimit të objektit shkollor “L. Prizreni”, gjegjësisht, aneksimin e këtij objekti shkollës fillore “L.Prizren:.. Opcion kalimtar mbetet mbajta e destinimit për shkollim të mesëm dhe shkarkimi përmbajtësor i numrit të nxënësve të kësaj shkolle (shif Orientimin KOM 16 – Arsimi Profesional). Zhvillimet në vijim janë:

- rregullimi i jashtëm që përfshin oborrin e shkollës dhe fushëlojën;
- restaurimi dhe sanimi i objektit ekzistues;
- lidhja fizike nëntokësore me sh.fillore “L. Prizrenit”
- opioni i zhvillimit të qëndrueshëm - dislocimi i mësimi të mesëm të mjekësisë në objekt të ri në kuadër të zhvillimeve të reja, konform udhëzuesve qeveritar dhe parametrave të këtij plani-Opcioni 1, ose shkarkimi përmbajtësor i nxënësve për arritje të standardeve të zbatueshme.

[D6.6] Ndërtesa tregëtare e Famullisë– objekt ekzistues :

KK Prizren do të inkurajojë **ridestinimin** e këtij objekti në kuadër të rihvillimit të asaj zone përmes transformimit të strukturës në njësi më të vogla, përmes:

- ristrukturimit arkitektural të ndërtesës ekzistuese, me qëllim që vlerat e katedrales të vijnë në shprehje në aspektin vizuel;
- rregullimi i jashtëm sipas kërkesave të reja.

[D6.7] Shtëpia e Shëndetit II – e vjetër – objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë **ridestinimin** e këtij objekti dhe zhvillimet në vijim:

- rregullimi i jashtëm i hapësirës;
- restaurimi dhe sanimi i objektit ekzistuese,;
- ristrukturimi i shtëpisë së Shëndetit në **Qendër Kryesore të Mjekësisë Familiare**, konform udhëzuesve qeveritar dhe parametrave të këtij plani (shif Orientimin KOM 24)

[D6.8] Objekti i Bashkësisë Lokale”– objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë ristrukturimin e funksioneve të këtij objekti në dhe ridizajnimin në **punkt të shërbimit policor** (për 25.000 banorë), përmes zhvillimeve në vijim:

- restaurimi dhe sanimi i objekteve ekzistuese,;
- ristrukturimi për qëllime të aplikimit të standardeve të zbatueshme rregullimi i jashtëm i hapësirës për nevoja të destinimeve të reja.

[D6.9] Banimi Ekzistues Individual”– banim ekzistues


KK Prizren do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë zonë duke i vendosur kushtet për Rekonstruim:

- Nuk do të lejohet thërmimi i mëtejme i ngastrave kadastrale
- Në Kushtet Urbanistike për rastet kur ngastra kadastrale është e ndërtuar (shfrytëzuar) më tepër se 50%, do të kërkohet zvogëlimi në gabarit deri në 50% të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe do të mundësohet rikonstruimi i objektit deri në P+2.
- Në Kushtet Urbanistike për rastet kur ngastra kadastrale është e ndërtuar (shfrytëzuar) më pak se 50%, nuk do të lejohet rritja e gabaritetit ekzistues të objektit, dhe do të mundësohet rikonstruimi i objektit deri në P+2.

III KUADRANTI [D7]

Në kuadër të kuadranit [D7] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

[D7.1] ish Hotel "TURISTI"	ridizajnim në Kompleks të Hotelit të Ri
[D7.2] ish Kinemaja "PUNËTORI"	ridizajnim në Qendër të Arteve Skenike
[D7.3] Oborri i xhamisë së Sinan Pashës	zhvillim i ri i Vargut të Dyqaneve
[D7.4] Banimi Ekzistues Individual	rehabilitim
[D7.5] Zona e lirë e gjelbër	Rehabilitim



[D7.1] ish Hotel “TURISTI” – objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillimin e **Kompleksit të Hotelit të Ri**, si në vijim:

- Ridizajnimi në hotel të kategorisë së lartë – hotel me më pak se 10 dhoma;
- ridizajnimi i strukturave përreth në funksion të hotelit si dhe ndërlidhja e tyre me kompleksin e hotelit, për të plotësuar nevojat dhe kapacitetet e hotelit
- rregullimi i jashtëm dhe projektimi i përmbajtjeve të reja në të hapur për qëllime të hotelit;

[D7.2] ish Kinemaja “PUNËTORI” (Radnik) – lokacion i zbrazët:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillimin e **Qendrës së arteve skenike**, si në vijim:

- ridizajnim i hapësirës me përmbajtje me të cilat do të arrihet lidhshmëria me shkollën e mesme të muzikës dhe njëkohësisht të fitohet një kualitet më i lartë i jetës kulturore si ofertës më atraktive turistike (përmbajtjet e reja do të përfshijnë sallat kamertale, sallat e kinemasë, objekte komerciale me destinime në harmoni me funksionin themelor të kompleksit të ri;
- vëllimet, trajtjat, kulmet, materialet, etj, të njësive të reja duhet të harmonizohen me strukturat e imta përreth.

[D7.3] Oborri i xhamisë së Sinan Pashës – lokacion ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë zhvillimin e **Vargut të Dyqaneve**, si në vijim:

- dizajnimi i oborrit të xhamisë me njësi të dyqaneve në murin rrethues i cili do të jetë pjesë përbërëse e këtyre njësive. Nga rruga, njësitë do të strukturohen vetëm në përdhësë, ndërkaq pjerrtësia e terrenit mundëson edhe një etazhë në brendi të oborrit të xhamisë.
- rregullimi i jashtëm që përfshin shtegun për këmbësor i cili njëkohësisht do të shërbejë si rrugicë për komunikim me njësitë e dyqaneve dhe me parkun e xhamisë;
- vëllimet, trajtjat, kulmet, materialet, etj, të njësive të reja duhet të harmonizohen me strukturat e imta përreth.

[D7.4] Banimi Ekzistues Individual”– banim ekzistues

KK Prizren do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë zonë duke i vendosur kushtet për Rekonstruim:

- rekonstruimi i të gjitha objekteve të shkatërruara edhe nga lufta edhe pas saj; për objektet e mbrojtura - rekonstruimi do të bëhet konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e monumenteve të kulturës; për objektet tjera - rekonstruimi do të bëhet sipas rregullave të dhëna në shtojcën 1 (për “Ndërtimet e Reja në Zonat e Mbrojtura”).
- nuk do të lejohet thërmimi i mëtejshmë i ngastrave kadastrale
- ridestiniimi në banim dhe akomodim hotelier të tipit “shtrat e mëngjes” për turizëm.

[D7.5] Zona e lirë e gjelbër- zonë ekzistuese


KK Prizren nuk do të lejojë ndërtime në këtë zonë. Hapësira e lirë do të avancohet përmes zhvillimit të ri që do të përkrahë rekreimin pasiv dhe shëtitjet në këtë zonë, si në vijim:

- inkurajohet mbrojtja dhe kultivimi i mëtutjeshëm i gjelbërimit
- projektimi i përmbajtjeve të rekreimit në të hapur
- inkurajohen edhe struktura të imta me vëllim të gjithëmbarshtëm prej max. 10% të sipërfaqes së gjelbruar;
- do të ipet mundësia e disa vendpushimeve si krojet, etj,.. duke mos e cenuar gjelbrimin ekzistues;

IV KUADRANTI [E5]

Në kuadër të kuadrantit [E5] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

[E5.1] Zonë banimi"	rizhvillim në Qendër të Re të Qytetit
[E5.2] Gjykata dhe Burgu i Qarkut, ...	ridestitim në Kompleks Shkollor
[E5.3] Objekti i Prokurorisë	ridestitim në përmbajtje publike
[E5.4] Brigjet e Lumbardhit	ridestitim në shetitore - Kej i Lumbardhit
[E5.5] ish Spitali i Përgjithshëm	ridestitim në Çerdhe fëmijësh
[E5.6] ish trasa e hekurudhës	ridestitim në park të qytetit
[E5.7] Banimi Ekzistues Individual	ridizajnim në Banim të Kombinuar në kuadër të Q.Re
[E5.8] Banimi Ekzistues Individual	Rehabilitim dhe front i ri i shoppingut
[E5.9] ish Stac. i Autobusëve Ndërrurb.	Ridestitim në Stacion të Autobusëve Urban
[E5.10] Banim ekzistues dhe industri ekz.	Ridizajnim për qëllime të biznesit



[E5.1] zonë banimi” – objekte ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë rihvillimin e kësaj zone në **Qendër të Re të Qytetit** (përshkrimi i kësaj zone është dhënë në Kapitullin 3 “Zonimi Strategjik i Qytetit- Zonat e Veçanta”). Ridizajnimi i tërësishëm i zonës me funksione publike do të bëhet me plan rregulativ – detal.

[E5.2] Gjykata dhe Burgu i Qarkut, Gjykata për kundërvajtje

Stac. Kryesor Policor dhe i zjarrfikësve - ” – objekte ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin e këtyre objekteve në **Kompleks Shkollor**, rrjedhimisht, dislocimin e funksioneve në lokacione të reja, si kompleks i veçantë Kompleks i veçantë jashtë zonës së banimit, përveç gjykatës për Kundërvajtje funksionet e së cilës do të barten në Qendrën e Re të Qytetit. Në këtë Kompleks shkollor do të inkurajohet bartja e nxënësve të shkollës fillore “Emin Duraku, gjëgjësisht, shkolla në fjalë do të dislocohet në këtë kompleks. Kompleksi shkollor gjithashtu do të pranojë numër shtesë të filloristëve, varësisht nga kapaciteti i lokacionit të ridizajnuar. Do të kërkohet edhe:

- restaurimi dhe sanimi i objektit ekzistues;
- projektimi i hapësirave në të hapur dhe rregullimi i jashtëm që përfshin oborrin e shkollës dhe fushëlojën, sipas kërkesave për objekte shkollore.

Ridizajnimi i tërësishëm i zonës me funksione publike do të bëhet me plan rregulativ – detal.

[E5.3] Objekti i Prokurorisë – objekte ekzistuese:

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin e këtyre objekteve në **përmbajtje publike**, rrjedhimisht, dislocimin e funksionit të prokurorisë në Qendrën e Re të Qytetit, në afërsi të Gjykatës për Kundërvajtje.

- restaurimi dhe sanimi i objekteve ekzistuese,;
- rregullimi i jashtëm i hapësirës dhe projektimi i hapësirave të nevojshme, sipas kërkesave për objektet e përzgjedhura publike.

[E5.4] brigjet e Lumbardhit – objekte ekzistuese:

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin e brigjeve të Lumbardhit në shetitore si **Kej i Lumbardhit**, sipas specifikave të dhëna në kapitullin 3 “Zonimi Strategjik i Qytetit- Zonat e Veçanta”).

[E5.5] ish Spitali i Përgjithshëm – objekte ekzistuese:

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin e këtyre objekteve në **Çerdhe fëmijësh**. Ridizajnimi i tërësishëm i këtij lokacioni do të bëhet me plan rregulativ – detal, që përfshin:

- shfrytëzimin eventual - restaurimin dhe sanimin e objekteve ekzistuese ose rrënimin e tërësishëm / pjesërisht të tyre

- rregullimin e jashtëm të hapësirës dhe projektimin e hapësirave të nevojshme, sipas kërkesave për objekte shkollore.

[E5.6] ish trasa e hekurudhës – lokacion i lirë

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin e kësaj zone në **park të qytetit** i cili njëherit do të kryejë funksionin e “tamponit mbrojtës”, si izolues i zonës së industrisë. Do të inkurajohet:

- rregullimi i hapësirës së gjelbruar sipas standardeve të zbatueshme: pyllëzimi, planifikimi i hortikulturës, shtigjet për këmbësorë dhe hapësira për rekreim pasiv dhe aktiv; ndërlidhja e shtigjeve në sistem të rekreimit me zonat përreth përmes urës lidhëse që kalon mbi rrugë.

[E5.7] Banimi Ekzistues Individual – objekte ekzistuese

KK Prizren do të inkurajojë rihvillimin e kësaj zone në **Banim të Kombinuar (P+3 deri P+4) në kuadër të Qendër të Re të Qytetit**. Ridizajnimi i tërësishëm i kësaj zone do të bëhet me plan rregulativ – detal. Zhvillimet që propozohen në këtë lokacion janë:

- ridizajnimi i zonës në zonë të banimit të lartë, sipas kushteve të dhëna për ndërtimin e objekteve për banim të lartë me funksione të tregëtisë dhe të shërbimeve përcjerrlëse të vendosura në përdhesë dhe në katin mbi përdhesë. Fronti i rrugës mbështjellëse e cila fillon prej parkut (në perëndim) dhe vazhdon më tej në drejtim të veriut, do të jetë Front i Shoppingu Primar.
- Rikonstruimi i banimit të lartë i cili aktualisht gjindet në lindje të stacionit të autobusëve, me të njëjtin parim skur edhe në pikën e lartëpërkthuar;
- Aplikimi i të gjitha standardeve të zbatueshme për përmbajtjet e nevojshme brenda zonave të banimit dhe respektimi i orientimeve për frontet e shoppingut.

[E5.8] Banimi Ekzistues Individual – banim ekzistues

KK Prizren do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë, konform kushteve të dhëna për rikonstruim të banimit të ultë, si dhe **frontin e ri të shoppingut** përgjatë rrugës së ridizajnuar :

- Nuk do të lejohet thërmimi i mëtejme i ngastrave kadastrale
- Në Kushtet Urbanistike për rastet kur ngastra kadastrale është e ndërtuar (shfrytëzuar) më tepër se 50%, do të kërkohet zvogëlimi në gabarit deri në 50% të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe do të mundësohet rikonstruimi i objektit deri në P+2.
- Në Kushtet Urbanistike për rastet kur ngastra kadastrale është e ndërtuar (shfrytëzuar) më pak se 50%, nuk do të lejohet rritja e gabaritit ekzistues të objektit, dhe do të mundësohet rikonstruimi i objektit deri në P+2.
- Do të inkurajohet Front i Shoppingu Primar përgjatë rrugës mbështjellëse të lokacionit.

[E5.9] ish Stacioni i Autobusëve Ndërrurban– kompleks ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë dislocimin e ish Stacionit të Autobusëve Ndërrurban “Kosovatransi Prizren” në Zonën e re të Terminalit, dhe ridestinimin e këtij kompleksi në **Stacion të Autobusëve Urban** (ndërtesa kryesore cca 3703 m²). Ridizajnimi i tërësishëm i kësaj zone do të bëhet me plan rregulativ – detal.


[E5.10] banim ekzistues dhe pjesë të industrisë - objekte ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë ridizajnimin e kësaj zone për **qëllime të biznesit** duke e përvetësuar formën urb-arkitektonike të ndërtimit të lartë (ndërtim i shkallëzuar) si në arteriet tjera të rrugëve kryesore. Ridizajnimi i tërësishëm i kësaj zone do të bëhet me plan rregulativ – detal.

V KUADRANTI [E6]

Në kuadër të kuadranit [E6] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

- | | |
|---|---|
| [E6.1] Zona e qytetit ish Entit Social, Sh.f. "E. Duraku, ... | ridizajnim në Shesh të Ri |
| [E6.2] Keji i lumit, banimi, objektet e mbrojtura, ... | ridizajnim, trajtim i obj. të mbrojtura |



[E6.1] Zona e qytetit (ish objekti i Entit Social, Sh.f. "Emin Duraku", objekte tjera në mes të lokacioneve objekteve të lartëshënuara) – zonë ekzistuese:

KK Prizren do të inkurajojë **rrënimin** e objekteve të lartëpërmendura **dhe ridizajnimin e tërësishëm** të kësaj zone. Që të realizohet një qasje sa më të mirë në këtë pjesë vitale të qytetit, propozohet që disa objekte në këtë kuadrant të rrenohen dhe të formohet një **shesh i ri (park)** i përmasave më të mëdha. Në katet nëntokësore të këtij sheshi parashifet një parking në një ose dy nivele ku gjithashtu mund të vendosen përmbajtje tjera kulturore, komerciale etj. Realizimi i këtij sheshi do të mundësojë definimin e të gjitha rrugëve si dhe lidhshmërinë shumë më të mirë me objektet kapitale të kulturës së lashtë prizrenase me ç'rast do të ngritet niveli i ofertave turistike.

- Funkzioni i Entit Social do të dislocohet në Qendrën e Re të Qytetit.
- Shkolla fillore "Emin Duraku" do të dislocohet në Kuadrantin E5 – lokacioni i Gjykatës dhe Burgut të Qarkut, ... (shif pikën E5.2)

Me një hapje të tillë të vizurave, gjegjësisht, krijimin e sheshit, do të vijnë në shprehje disa objekte me vlera arkitekturale dhe do të formohet një tërësi shumë më kompakte e objekteve me kompleks të vlerave të trashëgimisë.

Gjithashtu, kjo zgjidhje e propozuar do të krijojë kushtet për të trafikut automobilistik dhe këmbësorik, dhe në fakt, ky ky shesh do të jetë një nyje e ardhshme që lidh një pjesë të Qendrës së Vjetër të qytetit me Qendrën e Re të Qytetit - kalimi prej së vjetrës në të renë – duke mos e ndërprerë kontinuitetin e lëvizjeve të këmbësorëve, të përmbajtjeve dhe të qarkullimit në tërësi.


[E6.2] Keji i lumit, banimi, objektet e mbrojtura, etj... do të trajtohen si në propozimet e përshkruara në kuadrantet tjera

Ridizajnimi i tërësishëm i kësaj zone do të bëhet me plan rregulativ – detal.

VI KUADRANTI [E7]

Në kuadër të kuadranit [E7] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

[E7.1]	Kompleksi i Marashit	restaurim dhe rehabilitim
[E7.2]	Kompleksi i L. Sh. P.	zhvillim konform legjislacionit
[E7.3]	Objekti i Kuvendit Komunal	ridestinin për nevoja të LSHP
[E7.4]	Objekti aneks i KK Prizren	ridestinin në hapësirë të lirë, për LSHP
[E7.5]	Posta Qëndrore	ridestinin në Postë filialë – admin. pa CAT
[E7.6]	Shtëpia e Kulturës	rikonstruim
[E7.7]	Kinemaja	Rrënim dhe ndërtim i strukturave të imta të qarshisë
[E7.8]	Kompleksi i ndërtesave të larta	v1. rrënim / v2. ridizajnim / v3. ristrukturim
[E7.9]	Bazhdarana (A.Jashari)	rehabilitim i Frontit të Shoppingut
[E7.10]	Banim ekzistues	rehabilitim
[E7.11]	Ura e Arastës	restaurim dhe rehabilitim



- [E7.1] Kompleksi i Marashit**– kompleks i mbrojtur
 KK Prizren, në zonën e banimit, do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të jetesës duke i vendosur kushtet për restaurim dhe rehabilitim, Gjithashtu, do të inkurajohet ruajtja e zonës së gjelbruara dhe zhvillime të reja për qëllime të rekreimit.
- Restaurimi i objekteve do të bëhet konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e monumenteve të kulturës me qëllim të tërë kompleksi, sipas këtij plani, është nën mbrojtje;
 - nuk do të lejohet thërmimi i mëtejshëm i ngastrave kadastrale;
 - ridestini në banim dhe akomodim hotelier të tipit “shtrat e mëngjes” për turizëm, në mënyrë që të fitohet lidhshmëria e drejtpërdrejtë me kompleksin e L.SHP.
 - ruajtja e hapësirave të gjelbëruara dhe rregullimi i hapësirës (shtigje, fushëloja, vendpushime, etj) për qëllime të rekreimit dhe të sportit pasiv;
 - ndërtime të reja për t’i plotësuar nevojat e rekreimit do të realizohen me koncepte dhe përmbajtje bashkëkohore por në frymë tradicionale.
- [E7.2] Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**– kompleks i mbrojtur
 KK Prizren do të inkurajojë zhvillimin e këtij kompleksi, **për nevojat e LSHP**. Objektet e mbrojtura do të trajtohen konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e monumenteve të kulturës.
- [E7.3] Objekti i Kuvendit Komunal** – objekt ekzistues
 KK Prizren do të inkurajojë dislocimin e funksioneve të Kuvendit Komunal në Qendrën e Re të Qytetit dhe ridestininimin e objektit kryesor të KK Prizren **për nevojat të LSHP** (psh: muze historik, bibliotekë, auditorium, hapësira për punë shkencore, hulumtime, prezente, etj).
- [E7.4] objekti aneks i KK Prizren** – objekt ekzistues
 KK Prizren do të inkurajojë rënimin e objektit-aneks të KK Prizren dhe ridestini e lokacionit në hapësirë të lirë, **për nevojat të LSHP**. Do të inkurajohet rregullimi i jashtëm (projektimi i hortikulturës, shtigjeve dhe vendpushimeve për vizitorë)
- [E7.5] Posta Qëndrore** – objekt ekzistues
 KK Prizren do të inkurajojë dislocimin e funksioneve të Postës Qëndrore në Qendrën e Re të Qytetit dhe ridestininimin e objektit të Postës në **Postë filialë – administratë pa CAT**.
- [E7.6] Shtëpia e Kulturës** – objekt ekzistues
 KK Prizren do të inkurajojë rikonstruimin e tërësishëm të korpusit të kësaj ndërtese në mënyrë që të arrihet zvogëlimi i masave të mëdha. Hapësira përreth kinemasë duhet të lirohet (të zhvendosen dy objekte (lokale) që të mund të

realizohet aksi rrugor pa devijim. Me këtë do të arrihet zgjerimi i psheshit para shtëisë së kultuës.

[E7.7] Kinemaja – objekt ekzistues

KK Prizren do të inkurajojë rrënimin e këtij objekti dhe të disa objekteve përreth (kapitullin 5 “Mbrojtja e trashëgimisë Kulturore) të cilat aktualisht e degradojnë ambientin. Në lokacionin e kinemasë do të ndërtohen **struktura të imta** në mënyrë që qarshia të përkufizohet në tërësi. Strukturat e reja të imta të cilat do të jenë në afërsi të kinemasë së hapur do të destinohen për nevoja të saj (psh: videoprojeksioni, dhe shërbesa tjera teknike dhe logjistike).

[E7.8] Kompleksi i ndërtesave të larta - objekte ekzistuese

KK Prizren do të inkurajojë trajtimin e këtij kompleksi, në tri verzionet e parashtruara në vijim:

Versioni 1: Ndërtesa P+7 përballë Hotel “Therandës” do të rrënohet dhe në këtë hapësirë do të ndërtohen struktura të imta, si reminishencë në tregun e mëhershëm. Strukturat e reja do të kenë vëllim, kulme dhe në përgjithësi, arkitekturë karakteristike për Prizrenin.

Versioni 2: Ndërtesa P+7 përballë Hotel “Therandës” do të ridizajnohet duke e ulur etazhitetin në P+3, dhe kulmi i objektit do të transformohet në njësi më të imta, karakteristike për kulmet e Prizrenit. Efekti i arritur është hapja e vizurave të lira në drejtim të anës tjetër të lumit.

Versioni 3: Ndërtesa P+7 përballë Hotel “Therandës” do të ruhet dhe do të rishtrukturohet vetëm fasada e saj. Propozohet mbështjellja me fasadë qelqi. Efekti i arritur do të jetë një iluzioni optik i dëshiruar i cili e minimizon vëllimin e objektit ekzistues dhe njëkohësisht, krijohet një kontrast me materiale bashkëkohore, i cili shkon në favor të potencimit të vlerave urb-arkitektonike të strukturave ekzistuese dhe siluetës së asaj ane të qytetit.

Versioni 1, 2, 3: Në të tri rastet, objektet tjera të këtij kompleksi do të rehabilitohen konform standardeve dhe kërkesave për avancim të cilësisë së jetesës dhe të punës në atë lokacion. Trajtimi urb-arkitektonik do të përfshijë ridizajnimin e fasadave, në harmoni me tërë kompleksin.

[E7.9] aksi rrugor – Bazhdarana (A.Jashari) – Front ekzistues i shoppingut

KK Prizren do të inkurajojë avancimin e **frontit të shoppingut** konform orientimeve të këtij plani për fronte shoppingu si dhe konform propozimeve të këtij plani për trajtim të kompleksit të Bazhdaranës (shif kapitullin 5 “Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore). Trajtimi i kësaj zone do të bëhet me plan rregulativ – detal.

[E7.10] banim ekzistues - objekte ekzistues:

KK Prizren, në zonën e banimit, do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të jetesës duke i vendosur kushtet për restaurim dhe rehabilitim.

- restaurimi i objekteve të vendosura nën mbrojtje do të bëhet konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e monumenteve të kulturës,
- objektet tjera të banimit do të rehabilitohen në mënyrë që të ngritet niveli i jetesës
- nuk do të lejohet thërmimi i mëtejshëm i ngastrave kadastrale;
- do të inkurajohet Front i Shoppingu Primar pjesërisht nëpër lagje.


[E7.11] Ura e Arastës - objekt ekzistues:

KK Prizren, do të inkurajojë rikthimin e formës së mëhershme të urës sipas shënimeve për te (fotografi, të dhëna tjera), në suaza të një plani rregulativ-detal për lokacionin e ngushtë.

VII KUADRANTI [F5]

Në kuadër të kuadranit [F5] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

[F5.1]	Qendra Tregëtare	Rehabilitim, zhvillim i Qendrës tregtare-zejtare
[F5.2]	Pjesë e zonës ekz. industriale	Ridizajnim në shirit të banimit të lartë
[F5.3]	Shtëpia e Shëndetit I – e re	ridestinin në Qendër të Mjek. Urgjente
[F5.4]	lokacioni i Kërëk xhamisë	Rehabilitim, zgjerim i zonës së gjelbruar
[F5.5]	Pjesë e zonës industriale	Ridizajnim në shirit të banimit të lartë
[F5.6]	Pjesë e zonës industriale	Ridizajnim në Park të Biznesit dhe Zonë Panairi
[F5.7]	Fabrika e Filigranit	rehabilitim
[F5.8]	Qendra e re tregëtare dhe Tregu	Ridizajnim në Treg të Hapur dhe të Mbyllur



[F5.1] Qendra Tregëtare – objekte ekzistuese:

KK Prizren do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të kësaj qendre dhe përkufizimin e lëtij lokacion (në formë oaze) si **Qendër tregëtare-zejtare**. Zhvillimet që do të inkurajohen janë:

- Rrënimi i ndërtesave të banimit përgjatë rrugës në anën e djathtë të lokacionit dhe riorganizimi i tërë lokacionit për qëllime të tregëtisë-zejtarisë
- Rregullimi i jashtëm që nënkupton shtigje për këmbësorë dhe vendparkingje, duke e krijuar kështu ndërlidhjen e kësaj qendre me Frontet e shoppingut të lokacionit më të gjerë.

[F5.2] pjesë e zonës ekzistuese industriale – depo / objekte ekzistuese:

KK Prizren do të inkurajojë ridizajnimin e plotë të kësaj zone në **shirit të banimit të lartë** (ndërtim i shkallëzuar) përfshirë këtu edhe **parkimin nëntokësor dhe parkimin publik në të hapur**. Rihvillimi i kësaj zone do të bëhet me plan rregulativ – detal.

[F5.3] Shtëpia e Shëndetit I – e re – objekt ekzistues:

KK Prizren do të inkurajojë ridestinimin e funksioneve të këtij objekti në **Qendër të Mjekësisë Urgjente** me zhvillimet në vijim:

- rregullimi i jashtëm i hapësirës;
- restaurimi dhe sanimi i objektit ekzistues,;
- ristrukturimi i shtëpisë së Shëndetit në Qendër të Mjekësisë Urgjente, konform udhëzuesve qeveritar dhe parametrave të këtij plani.

[F5.4] lokacioni i Kërëk xhamisë– objekt i ri:

KK Prizren do të inkurajojë përmirësimin e hortikulturës si dhe zgjerimin e këtij lokacion duke e përmbyllur gjithë oazën (deri në udhëkryq) në funksion të **zonës së gjelbëruar**.

[F5.5] Pjesë e zonës industriale – objekte ekzistuese

KK Prizren do të inkurajojë rihvillimin e kësaj zone në Shirit të **Banit të Lartë P+5** (modeli i shkallëzuar) . Ridizajnimi i i këtij shiriti do të bëhet me plan rregulativ – detal. Zhvillimet që propozohen në këtë lokacion janë:

- ridizajnimi i zones shiritore në zonë të banimit të lartë, sipas kushteve të dhëna për ndërtimin e objekteve për banim të lartë me funksione të tregëtisë dhe të shërbimeve përcjerllëse të vendosura në përdhesë dhe në katin mbi përdhesë të cilat formojnë Front Primar të Shoppingut
- Aplikimi i të gjitha standardeve të zbatueshme për përmbajtjet e nevojshme brenda zonave të banimit dhe respektimi i orientimeve për frontet e shoppingut.

[F5.6] Pjesë e zonës industriale – objekte ekzistuese

- KK Prizren do të inkurajojë rizhvillimin e kësaj zone në **Park të Biznesit**, në të cilën gjithashtu do të vendoset edhe hapësira për **Panaire**. Ridizajnimi i këtij shiriti do të bëhet me plan rregulativ – detal. Veprimi i veçantë në kuadër të kësaj zone është objekti i Filigranit i cili do të shkoqitet si pikë e veçantë.

[F5.7] Fabrika e Filigranit – objekt ekzistuese

KK Prizren do të inkurajojë ruajtjen, përmirësimin e kushteve k, onform standardeve dhe mbrojtjen e këtij objekti, përmes zhvillimeve në vijim:

- rregullimi i jashtëm;
- restaurimi dhe sanimi i objekteve ekzistuese;

[F5.8] Qendra e re tregëtare dhe Tregu – objekt ekzistuese

- KK Prizren do të inkurajojë zhvillimin e kësaj zone në **Treg të Hapur dhe të Mbyllur**, me të gjitha funksionet përcjellëse për këtë lloj të veprimtarive.

VIII KUADRANTI [F6]

Në kuadër të kuadranit [F6] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

[F6.1] Lagjia e Lakuriqit


ridefinim-shqyrtim dhe riprojektim

[E6.2] Shiriti i Banimit Ekzistues Individual

ridizajnim në banimit të lartë

[E6.3] Banimi Ekzistues Individual

rehabilitim dhe front i ri i shoppingut



[F6.1] Lagjia e Lakuriqit – lagje ekzistuese

Edhe pse Lagjia e Lakuriqit është një ndër pjesët e para “të urbanizuara” të Prizrenit, kërkesat specifike për zonat e banimit janë të numërta, prandaj KK Prizren do të inkurajojë **ridefinimin** e të gjitha hapësirave të lira si dhe **shqyrtimin dhe riprojektimin** e planit detal ekzistues.

[E6.2] Shiriti i Banimit Ekzistues Individual – objekte ekzistuese

KK Prizren do të inkurajojë rihvillimin e kësaj zone në shirit të **Banimit të Lartë** (modeli i shkallëzuar) Zhvillimet që propozohen në këtë lokacion janë:

- ridizajnimi i zonës në zonë të banimit të lartë, sipas kushteve të dhëna për ndërtimin e objekteve për banim të lartë me funksione të tregëtisë dhe të shërbimeve përcjerrlëse të vendosura në përdhesë dhe në katin mbi përdhesë.
- Aplikimi i të gjitha standardeve të zbatueshme për përmbajtjet e nevojshme brenda zonave të banimit dhe respektimi i orientimeve për frontet e shoppingut.

[E6.3] Banimi Ekzistues Individual – banim ekzistues

KK Prizren do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë, konform kushteve të dhëna për rikonstruim të banimit të ultë, si dhe **frontin e ri të shoppingut** përgjatë rrugës së ridizajnuar :

- Nuk do të lejohet thërmimi i mëtejme i ngastrave kadastrale
- Në Kushtet Urbanistike për rastet kur ngastra kadastrale është e ndërtuar (shfrytëzuar) më tepër se 50%, do të kërkohet zvogëlimi në gabarit deri në 50% të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe do të mundësohet rikonstruimi i objektit deri në P+2.
- Në Kushtet Urbanistike për rastet kur ngastra kadastrale është e ndërtuar (shfrytëzuar) më pak se 50%, nuk do të lejohet rritja e gabaritit ekzistues të objektit, dhe do të mundësohet rikonstruimi i objektit deri në P+2.
- Do të inkurajohet Front i Shoppingu Primar përgjatë rrugës mbështjellëse të lokacionit.

IX KUADRANTI [F7]

Në kuadër të kuadranit [F7] - Harta e Propozimeve - Kuvendi Komunal do të inkurajojë zhvillimin, avancimin dhe ridizajnimin e shërbimeve ekzistuese. Propozimet do të konsiderohen në kontekstin e Planit të Përgjithshëm të propozuar për atë lokacion.

[E7.1] Ridefinimi i rrugës


[E7.2/3] Lokacioni i shtëpisë së ish armatës

[F7.4] Banimi Ekzistues Individual

Ridefinim dhe parkim nëntokësor

ridizajnim në Qendër Multidisciplinare

rehabilitim



[E7.1] Ridefinimi i rrugës – (shif Hartën e Trafikut të Integruar)

KK Prizren do të inkurajojë rihvillimin e kësaj zone. Te sheshi i cili ndodhet në rrugën Adem Jashari, para ish shtëpisë së armatës, propozohet një **parking nëntokësor**;

[E7.2/3] Lokacioni i shtëpisë së ish armatës – objekt ekzistues

Me krijim e kushteve për lirim të këtij lokacioni për përmbushje të kërkesave komunale, preferohet që ky lokacion të destinohet në **Qendër Multidisciplinare** - kulturore-rekreative, si dhe krijimi i një oaze gjelbruese.

[F7.4] Banimi Ekzistues Individual – banim ekzistues

KK Prizren do të inkurajojë përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë zonë, me kushtet dhe udhëzimet e parashtruara edhe në pjesët tjera të lokacionit më të gjerë.

SHTOJCAT

Për qëllime të orientimeve të këtij plani, Shtojcat janë dhënë në formë të kriterëve dhe standardeve të cilat Kuvendi Komunal i Prizrenit i përvetëson në kuadër të planifikimit të qytetit të Prizrenit.

SHTOJCA 1	KRITERET PËR NDËRTIMIN DHE RINDËRTIMIN E OBJEKTEVE NË ZONAT E MBROJTURA	2
SHTOJCA 2	STANDARDET E PJESËVE TE HAPURA PUBLIKE	5
SHTOJCA 3	STANDARDET E PARKIMIT PUBLIK	8
SHTOJCA 4	KRITERIUMI PËR MADHËSI DHE INTIMITET TË KOPSHTEVE	18
SHTOJCA 5	KLASËT E DESTINIMEVE - NË KUADËR TË PLANIFIKIMIT TË QYTETIT	22

Shtojca 1

KRITERET PËR NDËRTIMIN DHE
RINDËRTIMIN E OBJEKTEVE NË
ZONAT E MBROJTURA

Kuvendi Komunal i Prizrenit do të vendos kritere (rregulla) të ndërtimeve në zonat nën mbrojtje të Tërësisë Qendrore Orientuese, në interes të ruajtjes dhe ngritjes së vlerave urb-arkitektonike, historike, ambientale si dhe ngritjes së nivelit të jetesës. Këto rregulla nuk kanë të bëjnë me ndërtesat dhe komplekset nën mbrojtje brenda TQO ruajtja dhe mbrojtja e të cilave vendoset në përputhje me kriteret dhe parimet të parapara me Ligjet e Aplikueshme për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, por janë të nevojshme që të ndalohen tendencat e tejkalimeve vëllimore të objekteve, etazhiteti i lartë, gjatësitë dhe thellësitë më të mëdha të korpuseve, materialet e përdorura, përfshirja e tërësishme e hapësirës.

ZONA E PARË E MBROJTUR :

- P+0; P+1 për terrene të rrafshta,

P+1 dhe P+2 për terrene të pjerrëta (me vendosjen e kateve në shkallëzim në mënyrë që secili kat të këtë mbështetje në truall)

- Nuk do të tejkalojë vëllimin e ndërtesës origjinale. Themelet e ndërtesës zëvendësuese nuk do të tejkalojnë në m² ndërtesën origjinale.

Përshkrimi i mëposhtëm do të vlej për pjesën dërmuese të ndërtimeve, por do të respektohen edhe trajtat dhe shtresimet tjera të cilat paraqesin tipare të rëndësishme të kohës.

Përpunimi i përdhesës, katit dhe kulmit të shprehet me trajtë dhe material, kontrast i cili duhet të mbahet edhe më tutje në mjedisin e qytetit të Prizrenit. Lartësia e përdhesës max. 2.80 m, ndërsa lartësitë e katit më të ulëta se lartësia e përdhesës.

Të dalat në kat dimensionohen në përputhshmëri me hapësirat të cilave u përkasin, konform mundësive të cilat i ofrojnë materialet tradicionale-konstruktive.

Kulmet në shum ujra, me pjerrtësi të lehtë (rreth 30° të mbuluara me qeramidhe, pa nënkulm, kalkan dhe mure të formave të tjera, me strehë të thella (deri në 2m), pa mveshje të trajeve të strehës me dërrasa ose materiale tjera.

- Harmonia e proporcioneve të ndërtimeve të vjetra të Prizrenit (pozita e hapjeve brenda mases, rradhitja e tyre, parapeti i ulët etj.), vazhdojnë të jetë orientim në ndërtimet e mëtutjeshme. Andaj proporcionet lëvizin në raportet të tilla:
 - dritaret prej 1:1 deri 1:2;
 - dyert në marrëdhënje me hapjet tjera dhe me volumin e ndërtesës.
 - Insistohet në përdorimin sa më të madh të materialeve tradicionale, por aty ku nuk është e praktike përdoren materialet e përafërta me ato tradicionale. Nuk do të lejohet përdorimi i aluminit, plastikës, qelqit reflektues, ose imitimi i materialeve tradicionale.
 - Koloriti tradicional i Prizrenit (kaltërt, verdhë dhe kuqërremt në kontrast me të bardhë), druri i mbyllet dhe kulmi i kuqërremt, përbëjnë komponenten tjetër të stukturës harmonike të veprës arkitektonike. Ky kolorit në objektet e reja është i preferuar që të shpreh edhe më tutje veqorinë e koloritit prizrenas.
 - Muret ndarëse të oborreve vazhdojnë të kultivohen, por përgjatë rrugëve ku parashihen funksione të ekonomisë familjare, hapjet duhet të jenë minimale (në këtë kontekst për këto hapësira duhen gjetur destinimet përkatëse që nuk kushtëzojnë hapje të dritareve)
-
- Lejohen ato ndërtimet e reja të cilat me strukturën e tyre ruajnë maksimalisht kushtet natyrore të mikrolokacioneve ekzistuese (pamjen, insolimin, "ajrin").

Ndërtimi brenda lagjes lejohet vetëm nëse ka qasje të mirëfilltë, që do të thotë se komunikimi bëhet nëpër hapësirë publike dhe nuk degradon shfrytëzimin nga njësitë fqinje.
 - Duhet edhe më tutje të kultivohet veçantia e formës urbane të Prizrenit (rrugica e pandërprerë në përdhese ndërsa e larmishme /me sekuenca në kat)
 - Lartësia e këtyre objekteve duhet të korespondojë me strukturat përreth (nuk mund të tejkalojë lartësinë më të madhe të trashëguar), dhe të mundësojë ruajtjen maksimale të vizurave. Ndërtesat të cilat kanë nevojë për lartësi më të madhe do të plotësojnë atë duke shfrytëzuar hapësirën nën nivelin e truallit (nën kotën ± 0.00);
 - Arkitektura e objekteve jobanimore duhet të jetë refleksi i arkitekturës përreth. Në këtë kontekst elementet që e karakterizojnë arkitekturën e trashëguar duhet të jenë frymëzim e jo kopje në ndërtesat e reja, në ndërkohë që duhet të shprehin qartë karakterin e ndërtesës. Është e rëndësishme që raporti i masave të hapura dhe mbyllura, dyert, dritaret, trajtat e kulmeve, materialet të jenë në marrëdhënie me traditën e ndërtimit.
-
- Rrugët, rrugicat dhe sheshet për këmbësor të shtrohen me materiale natyrore të formave të ndryshme ose të kombinuara dhe duhet t'i kenë këto veti: të qëndrueshme në fërkim, në ngrica, në kripëra, të mos jenë të rrëshqitshme, të kenë ngjyrën dhe strukturën konstante etj.

Rrugët dhe rrugicat në pjerrtësi duhet të shtrohen me strukturë më të imët të materialit, në mënyrë që të evitohet sa më shumë rrëshqitja.

Drugët me destinim të trafikut automobilistik mund të shtrohen edhe me asfalt të kombinuar me elemente të gurit ose betonit të kualitetit të lartë.

- Elementet e mikrourbanizmit (kiosqet, ulset, trupat ndriques, shtyllat për informata, shportat për hedhurina, rrethojat, elementet e ujit, gjelbërimet etj.) duhet të projektohen ashtu që me material, trajtë dhe ngjyrë të krijojnë identitetin prizrenas.
-

ZONA E DYTË E MBROJTUR :

- P+1 dhe P+2
-
- Vëllimi, vendosja në truall, fasadat, kulmi, hapjet etj. të objektit të ri do të pasqyrojë ato që është tradicionalisht karakteristike për arkitekturën e Prizrenit ;
-
- Përpos udhëzimeve të dhëna për zonën e parë këtu parashifen edhe trajta, elemente dhe materiale tjera të cilat nuk i çenojnë udhëzimet paraprake
-
- Përparësi do t'i jepet përdorimit të materialeve tradicionale. Por mund të përdoren edhe materialet bashkëkohore të cilat nuk bien ndesh me hapësirën përreth.
-

ZONA E KONTAKTIT :

- P+1; P+2 dhe P+3
-
- Të gjithë udhëzuesit e Zonës së parë të transformuar me materiale dhe hollësira të reja/bashkëkohore;
-
- Përveç materialeve tradicionale lejohet përdorimi i materialeve bashkëkohore por gjithnjë në harmoni me materialet tradicionale.
-

Shtojca 2

STANDARDET E PJESËVE TE
HAPURA PUBLIKE

1. PARQET LOKALE

Standardi: Provizioni të bëhet për 0.2025 Ha / person

Situimi: Parqet Lokale duhet të situohen ashtu që secila amvisëri të ndodhet brenda 1km larg shërbimit.

përshkrimi:

Parqet Lokale janë zona të gjelbëruara përfshirë, aty ku është e mundur, zonat me peisazh ornametal (drunjët, gjelbërimi i ulët dhe lulet) të cilat kanë atraktivitet artistik; hapësirat joformale të rekreimit; ulëset për rekreim pasiv si dhe gjelbërimin natyral. Natyrisht, këto parqe do të kenë hyrje qartësisht të identifikuar për këmbësorë, të hapura për publik, përfshirë këtu personat me aftësi të kufizuara fizike dhe ata me karrige hendikepi. Elementet tjera karakteristike përcjellëse mund të situohen në brendi ose në fqinjësi të parqeve lokale varësisht nga rrethanat lokale. Këto do të duhej të përfshijnë:

- 1) Zonat e lojës për juniorë
- 2) Fushat e sportit dhe ndërtesat përcjellëse
- 3) Fushëlojat
- 4) Zonat e aktiviteteve specifike, psh. shtegu për vrapim, qendrat për sportet dimërore, kopshtet aromatike;
- 5) Pylltaria urbane
- 6) Arti publik dhe
- 7) Ndërtesat për qëllime rekreimi.

2. ZONAT JOFORMALE TË LOJËS PËR FËMIJËT

Standardi: provizioni standard është 0.405Ha/1000 banorë.

Madhësia minimale e zonave duhet të jetë:

Zona për lojë për parashkollorë – 600m²

Zona për lojë për fëmijë – 1,200m²

Zona për lojë për juniorë – 2400m², edhe pse mbi 500m² nga kjo sipërfaqe mund të jetë e ngjitur në, ose si zonë e veçantë, për zonë çiklizmi për të rinjë.

Zona për lojë joformale me top – 1 Ha – secila prej tyre të përmbajë postin për basketboll ose zonë me dysHEME të fortë me dimensione minimale 10 x 10 [m].

Situimi: Zonat e lojës për parashkollorë dhe fëmijë dhe zonat joformale të lojës me top do të duhej të situohen brenda 400m.

Përshkrimi:

Zonat për Parashkollorë - Këto projektohen për fëmijë të grupmoshës deri 5 vjec dhe duhet të përmbajnë së paku 3 lloje të mjeteve prej të cilave së paku njëra përmban lëvizje me max. një mekanizëm dhe së paku një mjet duhet të jetë i lehtë për qasje të atyre me paaftësi lokomotore. Gjithashtu duhet të përfshihet së paku një ulëse dhe një shportë hedhurinash për shoqëruesit e rritur.

Zonat e Lojës për Fëmijë - Këto zona projektohen parësisht për fëmijë të grupmoshës 5-8 vjec edhe pse duhet të përfshihet zona edhe për fëmijët nën 5 vjec. Zona e lojës duhet të përmbajë së paku 6 aktivitete të ndryshme të lojës (disa prej të cilave mund të jenë të kombinuara në një strukturë 'shumëllojëshe') me së paku dy pjesë lëvizëse në një mjet dhe jo më shumë se një mekanizëm në te. Së paku tri mjete duhet të kenë qasje të lehtë për ata me paaftësi lokomotore. Gjithashtu duhet të përfshihet së paku një ulëse dhe një shportë hedhurinash për shoqëruesit e rritur.

Zonat e Lojës për Juniorë - Këto zona projektohen parësisht për fëmijë të grupmoshës 9-12 vjec edhe pse duhet të përfshihen edhe zonat për grupmoshat 5-8 dhe për atë nën 5 vjec. Zona e lojës duhet të përmbajë së paku 6 aktivitete të ndryshme të lojës (disa prej të cilave mund të jenë të kombinuara në një strukturë 'shumëllojëshe'), për fëmijë prej 9-12 vjec. Përveç kësaj, duhet të përmbajnë edhe 4 aktivitete të ndryshme të lojës për fëmijë parashkollorë deri 9 vjec me jo më shumë se 3 mjete rrotulluese dhe së paku 4 mjete lëvizëse. Së paku gjysma e aktiviteteve për secilën grupmoshë duhet të ketë qasje të lehtë për të paaftit lokomotorë. Provizioni për zonë të lojës për juniorë nuk e përjashton kërkesën për të siguruar gjithashtu edhe zona të lojës për parashkollorë dhe fëmijë, nëse kjo kërkohet. Gjithashtu duhet të përfshihen së paku dy ulëse dhe dy shporta hedhurinash për shoqëruesit e rritur. Të gjitha zonat e lojës për fëmijë duhet tu përgjigjen standardeve aktuale për siguri si: rrethojën, sipërfaqe e shtruara absorbuese, shenjzimin, materialet, projektin dhe ndërtimin e zonave të lojës. Të gjitha zonat e lojës duhet të kenë rrethojë, portë dhe shenjën sinjalizuese përe ndalim të qenëve në brendi. Për promovim të sigurisë për fëmijët,

të gjitha zonat e lojës duhet të jenë nën mbikqyrje, ose nga prona banuese më e afërt, ose nga shtigjet frekvente për këmbësorë.

Zonat për Lojëra Joformale me Top - Këto zona dizajnohen për lojëra joformale me top, të fëmijëve të të gjitha moshave. Në disa raste fëmijët mund të shoqërohen nga prindërit e tyre. Pjesët e duhura të zonës duhet të jenë të rrethuara dhe të kenë portë si dhe shenjë për ndalim të qenëve në brendi.

3. ZONAT JOFORMALE - LOJA PËR TË RINJË

Standardi: 0.405 Ha/1000 banorë

Situimi: Madhësia minimale e këtyre zonave duhet të jetë 1,200 m²

Përshkrimi:

Këto zona kanë për qëllim mundësimin e takimeve joformale dhe lojën për të rinjë. Këto fillimisht do të shtrihen në sipërfaqe të gjelbëruar (bari) dhe do të përmbajnë strehim për tinxherë. Në këto vende rëndësi e veçantë duhet kushtuar zhurmës apo kërcënimeve të mundshme.

4. HAPËSIRA E LIRË PLANIFIKUESE

Standardi: 0.405 Ha/1000 banorë

Situimi: Nuk ka kërkesa për situim specifik apo për madhësi minimale

Përshkrimi:

Hapësira e lirë planifikuese është ajo pjesë e tokës e cila kërkohet me qëllim që të avansohet situata ekzistuese, shtrirja dhe ndikimi vizuel i shtëpive dhe ndërtesave tjera. Edhe pse këto toka nuk kanë vlerë rekreative (zakonisht për shkak të madhësisë, shtrirjes apo situimit), ato paraqesin element të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi jetësor atraktiv dhe të këndshëm.

5. FUSHAT E SPORTIT (JOFORMAL) DHE FUSHËLOJAT

Standardi: 0.93Ha/1000 banorë.

Situimi: Në paqe, kombinim park-shkollë, në kuadër të fushave të sportit

Përshkrimi:

Zhvillimet e reja duhet të përmbajnë min. 0.93 Ha/1000 banorë të fushave të sportit. Aty ku ndërtohen qendra/shërbime tërësisht të reja, gjithashtu do të kërkohet provizion për shërbimet përcjellëse, parkingjet etj.

Shtojca 3

STANDARDET E PARKIMIT PUBLIK

Standardet e Parkimit, të parashtruara në këtë Shtojcë, janë të bazuara në standardet e propozuara nga Kuvendi Komunal I Prizrenit dhe janë në përputhje me standardet Evropiane për parkim publik. Synohet që këto standarde të aplikohen në gjithë Komunën e Prizrenit dhe më gjerë. Këto standarde formojnë bazë të qëndrueshme për diskutim.

Standardet përfshijnë standardet për parkim të veturave. Këto janë standarde maksimale. Standardet për parkim të bicikletave dhe motocikletave janë gjithashtu të përfshira. Këto standarde përfaqësojnë minimumin, e provizionit të lejuar, duke reflektuar kështu natyrën e qëndrueshme të këtyre modaliteteve të udhëtimit. Janë përfshirë gjithashtu edhe standardet për parkimit për persona me aftësi të kufizuara fizike.

APLIKIMI I STANDARDEVE PËR PARKIM TË VETURAVE

Baza e Standardeve

Standardet për parkim, të bazuara në standardet Evropiane, aplikohen për sipërfaqe bruto të dyshemesë së zhvillimeve të reja ose të zgjeruara, përveç nëse deklarohet ndryshe.

Aspekti Hapësiror

Aplikimi i standardeve duhet t'i përshtatet lokacionit të zhvillimit të propozuar. Provizioni minimal i parkingut privat do të duhej aplikuar në lokacionet siç janë vendkycjet në qendrat/shërbimet e parkim publik dhe format alternative të transportimit të mallërave. Ndërkaq, zhvillimeve që propozohen në zona të lira ose më të izoluara, do t'u lejohen nivele më të larta të parkimit, aty ku vetura paraqet mjet të vetëm real për qasje.

Parkimi Operativ dhe Jooperativ

Hapësira parkuese operative është e definuar si hapësirë e nevojshme për veturat të cilat në mënyrë të rregullt apo obligative janë të involvuara në operim të biznesit për të cilin qëllim edhe shfrytëzohet objekti. Këtu përfshihen hapësirat për vetura komerciale dhe për ngarkim-shkarkim të mallërave, mirëpo nuk përfshihen vendet për strehim/deponim të veturave, përveç nëse kjo është e nevojshme si pjesë e biznesit që funksionin në atë objekt. Hapësirat jooperative të parkimit janë të rezervuara për vetura të cilat nuk kanë nevojë të parkohen në brendi të lokacionit. Dallimi në mes të standardeve për parkim operativ dhe jooperativ është në mes të provizioneve për parkim të veturave dhe provizioineve për veturave shërbyese të cilat bartin mallëra në dhe jashtë objektit. Këto standarde, prandaj, përfshijnë referenca për provizion të hapësirave për shërbim të ngarkim-shkarkimit të veturave për secilën Klasë të Destinimit, sipas nevojës.

Kalkulimi i Kërkesave të Parkimit

Shumica e standardeve aplikohen për sipërfaqe të dyshemesë. Prandaj, kur psh., standardi është i përcaktuar: 1 vendparkim/4m² të sipërfaqes së dyshemesë, ndërsaq zhvillimi ka sipërfaqe relevante prej 19m², kalkulimi prej 4m² në 19m² jep 4.75 vendparkingje. Kjo shifër rrumbullakësohet në numrin e plotë më të vogël të përafërt për t'i siguruar kërkesa totale për, në këtë rast, 4 vendparkingjeve.

Kur zhvillimi përmban dy ose më shumë destinime për të cilat janë të aplikueshme standarde të ndryshme të parkimit, standardet e përshtatshme për secilin destinim do të duhej të aplikoheshin njëkohësisht (në mënyrë simultante), në proporcion për destinimet respektive. Psh., kur zhvillimi përmban banim dhe zyra, secili destinim vlerësohet në veçanti përballë standardeve respektive dhe shuma e vendparkingjeve të rezultuara reflekton maksimumin e numrit të vendparkingjeve që do të duhej siguruar.

Shfrytëzimi i përbashkët

Kur shfrytëzimi i zonave të parkimit është i përbashkët dhe si ti tillë nuk shkakton konflikte, (psh. kur shfrytëzimi është i rregulluar në orare ditore apo javore të caktuara për secilin grup shfrytëzuesish), kjo gjë është më se e dëshirueshme, me kusht që provizioni të hyjë brenda standardeve të aplikueshme më të nevojshme për këtë rast. Një gjë e tillë mund të rezultojë me reduktim të numrit të vendparkingjeve të cilat i ofron zhvilluesi.

Kontributi i Zhvilluesit

Nga zhvilluesit pritet që të japin kontributin e tyre në avancimin e infrastrukturës lokale të transportit përmes aplikimit të duhur për planifikim. Këto kontribute do të mundësojnë akomodimin e çfarëdo rritjeje në trafik, si dhe do të përkrahin provizione të modaliteteve alternative të udhëtimit në ato lokalitete ku niveli i aktiviteteve e tejkalon provizionin maksimal të identifikuar të parkimit.

Automjetet e Shërbimeve

Automjetet e shërbimeve janë ato automjete të cilat bartin mallëra në dhe jashtë objektit. Është i njohur fakti se kërkesat për shërbime mund të jenë unike për lokacione të veçanta. Trafiku i shërbimeve variron varësisht nga tipi i ndërmarrjes për nga klasa e destinimeve (psh., trafiku që shërben për furnizim të dyqanit të orëdivave mund të jetë krejtësisht i ndryshëm, për nga frekuenca dhe karakteri, prej atij që e furnizon një supermarket). Për këtë arsye, nuk janë dhënë dimensionet standarde për parkim dhe manovrim të automjeteve të shërbimeve. Konsiderohet se ndërmarrjet komerciale duhet t'i analizojnë kërkesat e veta në aspektin e madhësisë, numrit dhe tipit të automjeteve komerciale që e vizitojnë objektin e tyre, si dhe duhet t'i dëshmojnë autoriteteve lokale se të gjitha propozimet zhvillimore përfshijnë provizion të mjaftueshëm të automjeteve të shërbimeve për përmbushje të kërkesave të zakonshme. Një provizion i tillë i shërbimeve duhet të shenjohej qartësisht dhe të vihet mbishkrimi i duhur në mënyrë që të evitohet parkimi i pakontrolluar i veturave të zakonshme.

Parkimi i Bicikletave dhe Motocikletave

Standardet për parkim të bicikletave dhe motocikletave janë parashtruar në këto standarde. Këto janë të shprehura si standarde minimale, në mënyrë që të reflektohet natyra e qëndrueshme e këtyre modaliteteve të udhëtimit.

Vlerësimet e Transportit dhe Planet e Udhëtimit

Vlerësimet e Transportit kërkohen në rastet e zhvillimeve të përmasave të mëdha, e sidomos kur ato pritet të krijojnë rritje të dukshme të kërkesave të udhëtimit. Zhvillimet që krijojnë nivele të dukshme të punësimit të ri, përfshirë spitalet dhe shkollat, do të detyrohen të bëjnë adoptimin e Planeve të Udhëtimit. Përmbajtja e Vlerësimeve të Transportit do të variojë varësisht nga natyra e zhvillimit të porpozuar.

STANDARDET MAKSIMALE PËR PARKIM TË VETURAVE

Dyqanet

Standardi: 1 vendparkim/20m². Standardi absolut maksimal i një vendparkimi për 18m² mund të aplikohet në zhvillimet e e dyqaneve të artikujve ushqimorë.

Vërejtje: Në të gjitha klasët do të bëhen provizione adekuate për parkim dhe manovrim të automjeteve të shërbimeve të cilan bartin mallëra në objekte dh aty ku është e mundur, të automjeteve për bartje që operojnë nga objekti.

Shërbimet Finansiare dhe Profesionale

Standardi: 1 vendparkim/20m².

Artikujt Ushqimor dhe Pijet

Standardi:

tregjet	1 vendparkim/20m ²
Kafeteritë dhe Klubet	1 vendparkim/5m ²
Restoranet	1 vendparkim/5m ²
Kafeteritë e Transportit	1 vendparkim për transportues/2m ²

Vërejtje: 1) provizioni më i ulët është i përshtatshëm për lokacionet në qendra të qytetit në vendet ku ka qasje të mira për forma alternative të transportit dhe shërbime ekzistuese të parkimit të veturave
2) Vend-Tregjet në tranzit në të cilat kalohet me vetura duhet të konsiderohen në kuadër të grupit 'restoranet përgjatë rrugës'.

Biznesi

Standardi: 1 vendparkim/35m². Vlerësimi I Transportit (përfshirë Planin e Udhëtimeve) kryesisht do të kërkohet për zhvillime të reja ose zgjerime me 2,500m² e më tepër

Vërejtje: Në të gjitha rastet do të kërkohet parkim dhe manovrim adekuat për automjete të shërbimeve të cilan bartin mallëra në objekte dhe aty ku është e mundur, të automjeteve për bartje që operojnë nga objekti

Industria e Përgjithshme

Standardi: 1 vendparkim/50m². Vlerësimi I Transportit do të kërkohet për zhvillime me 10,000m² e më tepër

Vërejtje: Në të gjitha rastet do të kërkohet parkim dhe manovrim adekuat për automjete të shërbimeve të cilan bartin mallëra në objekte dhe aty ku është e mundur, të automjeteve për bartje që operojnë nga objekti

Deponimi dhe Distribuimi

Standardi: 1 vendparkim/150m². Vlerësimi I Transportit do të kërkohet për zhvillime me 5,000m² e më tepër.

Vërejtje: Në të gjitha rastet do të kërkohet parkim dhe manovrim adekuat për automjete të shërbimeve të cilan bartin mallëra në objekte dhe aty ku është e mundur, të automjeteve për bartje që operojnë nga objekti

Hotelet

Standardi: 1 vendparkim/1 dhomë (mysafir apo punëtor hoteli).

Vërejtje: Provizioni më i ulët është i përshtatshëm për lokacionet në qendra të qytetit në vendet ku ka qasje të mira për forma alternative të transportit dhe shërbime ekzistuese të parkimit të veturave

Institucionet Rezidenciale

Standardi:

Mbrojta Sociale	1 vendparkim/1 banor-punëtor +1 vendparkim/3 shtretër
Spitalet	1 vendparkim/4 punëtor +1 vendparkim/3 vizitorë ditorë
Banimi në	1 vendparkim/1 banor-punëtor +1 vendparkim/2 punëtorë tjerë
Institucionet e arsimit	(parkingjet për studentë që posedojnë veturë ipet në kuadër të kësaj shifre)

Vërejtje: Vlerësimi I Transportit do të kërkohet për zhvillime të reja ose zgjerime me 2,500M² e më tepër.

Shtëpitë

Standardi: Në zonat kryesore urbane dhe në lokacionet me lidhje të mira me transportin publik, është I përshtatshëm maksimum 1 vendparkim për një shtëpi.

Vërejtje: Në zhvillimet me dendësi të lartë, në zonat e hapura në maksimum siç janë qendrat e qytetit, mund të lejohen zhvillimet me parkim të vogël përgjatë rrugës ose fare pa parkim, varësisht nga niveli I ruajtjes së karakterit dhe dukjeve të zonës gjegjëse.

Institucionet e Reja Jorezidenciale

Standardi:

Qendrat shëndetësore	1 vendparkim/ 1 punëtor me orar të plotë+2vendparkingje për pritore
Qendrat e përkujdesit ditor	1 vendparkim/1 punëtor me orar të plotë+1 vendparkim/ 4 persona pjesëmarrës+ zona e rezervuar për mbledhjen dhe shpërndarjen e klientëve
Kopshtet/Cerdhet Shkollat (Arsimi fillor dhe I mesëm)	1 vendparkim/1 punëtor me orar të plotë+pritoret sipas kërkesës si udhëzues I përgjithshëm: 1 vendparkim / 2 mësimdhënës që punojnë në 2 ndërrime. Duhet konsideruar gjithashtu edhe pritoret dhe provizionet për transport publik/shkollor, sipas nevojës
Shkollat (Arsimi i lartë)	si udhëzues I përgjithshëm: 1 vendparkim / 2 mësimdhënës që punojnë në 2 ndërrime (parkingjet për studentë përfshihen këtu). Sipas nevojës edhe pritoret, përfshirë zonën e prioritetit për transport publik/shkollor
Galeritë e arteve, muzetë, sallat publike, ekspozitat	1 vendparkim/25m ²
Objektet sakrale, bibliotekat/dhomat e leximit	1 vendparkim/10m ²

Vërejtje lidhur me shkollat: Zhvillimet në lokacionet urbane pritet të arrijnë provizion maksimal më të ulët në mënyrë që të promovojnë mënyra më të qëndrueshme të udhëtimit për në shkolla. Vlerësimet e Transportit dhe Planet e Udhëtimeve (përfshirë Rrugëtimet e Sigurta për në Shkollë) zakonisht kërkohen prej shumicës së aplikacioneve për zhvillime.

Sallat dhe Argëtimi

Standardi:

Kinematë	1 vendparkim për 5 ulëse
Destinimet tjera	1 vendparkim për 15 m ²

Vërejtje: Qendrat e konferencave dhe Stadia janë të mbuluara me standarde tjera.

STANDARDET TJERA

Tabela më poshtë përmban standarde për destinime tjera.

Destinimi	Standardi
Pompat e benzinës	1 vendparkim për 20 m ² të hapësirës shitëse. Kërkohe hapësirë e duhur për automjetet e shërbimeve.
Shërbimet automekanike	1 vendparkim / 1 punëtor + 1 vendparkim / 35 m ²
Sallonet e veturave	1 vendparkim / 45 m ² të hapësirës ekspozuese
Huazimi I taksit/veturave	1 vendparkim / 1 punëtor permanent në zyrën bazë + 1 vendparkim / 5 vetura të regjistruara
Bujtinat	1 vendparkim/1 banor-punëtor + 1 vendparkim/2 punëtorë tjerë
Vendqëndrimet e Karavaneve	1 vendparkim/1 fushë + 1 vendparkim/1 banor-punëtor + 1 vendparkim/2 punëtorë tjerë
Qendrat e konferencave & teatrot	1 vendparkim / 5 ulëse. Mund të kërkohe Vlerësimi I Transportit
Stadiumet	1 vendparkim / 15 ulëse. Mund të kërkohe Vlerësimi I Transportit & Plani I Udhëtimeve

STANDARDET PËR PARKIM TË BICIKLETAVE

Standardet për parkim të bicikletave, të dhëna më poshtë, do të aplikohen në të gjitha aplikacionet për zhvillime ose zgjerime të reja. Parkimi për bicikleta paraqet provizionin minimal të kërkuar.

Përshkrimi I Destinimit	Standardi Minimal për Parkim të Bicikletave
Dyqanet - ushqimore joushqimore	1/100m ² per punëtor dhe 1/100m ² per blerës 1/100m ² per punëtor dhe 1/200m ² per blerës
Shërbimet financiare dhe profesionale	1/100m ² per punëtor dhe 1/200m ² per blerës
Kafeteritë, klubet dhe restorantet	1/ 4 punëtorë dhe 1/25m ² per blerës
Restorantet përgjatë rrugëve dhe kafenetë e transportuesve	1/ 4 punëtorë dhe 1/25m ² per blerës
Hi-tech Industria/zyrat	1/50m ² per punëtorë dhe 1/100m ² per vizitorë
Industria	1/50m ² per punëtorë dhe 1/200m ² per vizitorë
Depotë	1/100m ² per punëtorë dhe 1/400m ² per vizitorë
Hotelet dhe Motelet	1/ 4 punëtorë; 1 / 10 shtretër 1/25m ² të restorantit/zonës për argëtim

Banimi strehues	1/ 4 punëtorë, 1 / 20 shtretër
Spitalet	1/ 4 punëtorë; 1 / 20 shtretër
Banimi	Asnjë në rast se ka garazha. 2 / njësi banimi (2 e më shumë dhoma gjumi) 1 / njësi banimi (1 dhomë gjumi) + 1/8 njësi (për vizitorë).
Qendrat e përkujdesit ditor	1/ 4 punëtorë; 1/200m ² për vizitorë
Qendrat familiare	1/ 5 punëtorë; 1 / dhomë të konsultimeve
Ndërtesat kulturore	1/ 4 punëtorë + 1/35m ²
Ndërtesat publike për argëtim	1/ 4 punëtorë; 1 / 20 vende të uljes
Shkollat dhe kolexhet	1/ 5 punëtorë dhe 1 / 3 studentë
Përkujdesi ditor	1/ 5 punëtorë dhe 1 / 30 fëmijë
Bibliotekat	1/ 4 punëtorë; 3 në bibliotekë; 10 në bibliotekën Kryesore
Sallat e mëdha	1/10m ²
Fushat e sportit	1/ 4 punëtorë dhe 1/ 4 lojtarë
Palestrat sportive	1/ 4 punëtorë dhe 1/ 4 vizitorë
Pompat e benzinës	1/ 5 punëtorë; 1/100m ² të sipërfaqes së shitores
Sallonet shitëse të veturave	1/100m ² për punëtorë dhe 1/200m ² për blerës
Lokacionet e kampimit	1/ 4 punëtorë ; 1/ 10 fusha
Parkingjet e veturave	1 / 10 vendparkingje
Stacionet e autobusëve	4 / vendndalje të autobusit
Vendndalet [bus stops]	4 / një bus-stop

STANDARDET PËR PARKIM TË MOTOCIKLETAVE

Standardet për motoçikleta, shprehen në kërkesën për provizion minimal.


Standardi: Një vendparkim, plus një vendparkim shtesë për çdo 10 vendparkingje të veturave, të nevojshme sipas standardit maksimal për parkim të veturave.

PARKIMI PËR TË HENDIKEPUAR

Parkimi për të hendikepuarit duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane.

Vendparkingjet për të hendikepuar duhet të kenë minimum gjerësi prej **3.3m** dhe gjatësi prej **6.6m**, në mënyrë që t'i mundësohet dalja/hyrja e sigurtë në veturë e ngasësit apo pasagjerit, si dhe deponimi i hendikep-karriges në pjesën e prapme të veturës. Aty ku

mundësohet qasja direkte në shteg të këmbësorëve në pjesët anësore apo të prapme, hapësira duhet të jetë së paku **2.7m ose 4.8m**, në atë radhitje (shif diagramin më poshtë).



STANDARDET E PARKIMIT		
PARKIMI TË VETURAVE TË TË HENDIKEPUARVE		
Qëllimi i Parkimit të Veturave	Madhësia e Parkimit të Veturave	
	Deri 200 Vendparkingje	Mbi 200 Vendparkingje
Punëtorët dhe vizitorët në ndërtesën e biznesit	Vendparkim individual për secilin punëtor të hendikepuar + 2 vendparkingje ose 5% I kapacitetit total, cilido që të jetë më I madh	6 vendparkingje plus 2% I totalit
Shoppingu, rekreimi dhe argëtimi	3 vendparkingje ose 6% I kapacitetit total	4 vendparkingje plus 4% I kapacitetit total

PROJEKTI DHE SHTRIRJA


Përveç nivelit të duhur për parkim të veturave, është e rëndësishme që zhvillimi i zgjeruar të inkorporojë desinj të mirë të shtrirjes, peisazhit dhe ndriçimit të parkingjeve. Këto duhet të jenë të përdorshme dhe mos t'i pengojnë magjistralet publike apo qasjet për në zonë të parkimit.

DIMENSIONET E GARAZHËS / VENDPARKIMIT	
Standardi:	
Dimensionet e preferuara për vetura	5.5m x 2.4m
Dimensionet minimale	4.8m x 2.4m
Dimensionet minimale të parkingjeve kur ato janë të vendosura 'prej skajit në skaj'	6.0m x 2.4m
Dimensionet minimale të garazhës për vetura	4.8m x 2.4m
Vërejtje: 1) Dimensionet minimale për garazha janë në përputhje me standardet evropiane për garazha publike. Përvoja ka treguar se garazhat zakonisht nuk përdoren për parkim të veturave, përveç nëse i pet hapësirë e mjaftueshme për deponim në kuadër të garazhës.	
2) Parkimi 'prej skajit në skaj' është hapësira paralele me, dhe e ngjitur me, rrugën automobilistike, e cila mundëson manovrimin e veturave (apo parkimin paralel) në vendparkim kur vendparkingjet fqinje janë të zëna.	
Dimensionet e vendparkingjeve për furgonë	7.5m x 3.5m
Dimensionet e vendparkingjeve për kamionë	(12.0 - 16.0m) x 3.5m


SHTRIRJA E ZONAVE PARKUESE

Shtrirja më ekonomike, në kuptim të shfrytëzimit të tokës, është parkimi në 90 shkallë me kalim veturash paralel me te, të cilat mund të shfrytëzohen në mënyrën më të përshtatshme kur kalimi për vetura është njëkahësh. Shembujt e aranzhimit të parkingjeve janë të dhëna më poshtë.



Kur zhvilluesi synon rrugë njëkahëshe, duhet të shenjohej drejtimi i ngasjes në mënyrë të qartë përmes shenjave të komunikacionit dhe shigjetave në rrugë.



Kur pikat hyrëse dhe dalëse janë njëkahëshe, kërkohen shenja të duhura, ndërkaq leja për planifikim do të jetë e kushtëzuar për këtë provizion. Kërkohej përcaktim i qartë i vazhduar për drejtimet e hyrjes dhe daljes. Në lokacionet e vështira për nga natyra e shtrirjes, kjo mënyrë mundson qasje të sigurtë të veturave përmes vijëzimit të përshtatshëm sinjalizues.



Parkimi i këndëzuar në të djathtë ngjitur me magjistralen publike me qasje direkte në te, nuk do të lejohet përveç në rastet e deëllings-ave private apo industriale, nëpër rrugët madhore apo minore të hapura për qasje në te, ku përkujdesi përqendrohet në sigurim të këmbësorëve.



Dimensionimi i shtigjeve automobilistike të parkingjeve

Gjerësia prej 6.0m kërkohet për të gjitha shtigjet automobilistike nga të cilat hyhet direkt në vendparkingje nën kënd 90 shkallë. Duhet të bëhet provizion adekuar për pastërti të magjistrales për lëvizje dhe manovrim të autometeve të rënda, sipas parashtrimeve të bëra në "Dizajnimi për Transportuesit" të Asociacionit të Transportit të Rëndë.

Mbrojtja e Ambientit

Autoritetet lokale të planifikimit mund ta konsiderojnë si të dëshirueshme një pjesë shtesë të tokës për të mundur vështrimin dhe peisazhin e përshtatshëm. Konsiderohet se një provizion i tillë i tokës është çështje negociuese në mes të zhvilluesit dhe autoriteteve lokale të planifikimit.

Është nënvizuar rëndësia e disenjimit të mirë. Zonat e parkingjeve janë rrallë herë atraktive, prandaj vendosen në atë pozitë që të mos imponohen vizuelisht, në ndërkohë që të inkurajohet shfrytëzimi i tyre. Ato duhet të projektohen ashtu që njerëzit të ndihen mirë edhe gjatë përdorimit të tyre natën.

Shtojca 4

KRITERIUMI PËR MADHËSI DHE
INTIMITET TË KOPSHTEVE

Kopshte e shfrytëzueshme, të këndshme dhe private si dhe balkonët, janë të rëndësishme në krijimin e kualitetit afatgjatë të banimit. Objektivat e intimitetit për hapësirat private janë:

- **INTIMITETI** – hapësirë personale e mbyllur, pa mundësi të vëzhgimit nga jashtë
- **VIZURAT** – ndjenja e të qenit në të hapur
- **MADHËSIA DHE FORMA E PËRDORSHME** – që i përshtatet tipit të banimit për rekreim, kopshtari, skajim të hedhurinave dhe për deponim.
- **ZGJERIMI** – mundësia e zgjerimit të ardhshëm të ndërtesës

Kuvendi Komunal i Prizrenit synon që kualiteti i kopshteve të jetë në raport me llojin e ndërtesës dhe me tipin e lokacionit. Në Tërësitë Qarkore orientuese, kopshtet e mëdha janë pothuajse të zakonshme, ndërkaq në atë Qendrore, kërkesat e banorëve për sipërfaqe private ndryshojnë varësisht nga përparësitë e lokacionit – qasja e lehtë dhe afërsia me shërbimet publike, që kanë karakter të zonës qendrore. Kopshtet e vogla kompenzohen me një lloj të tillë të të mirave të jetës urbane.

Përvec plotësimit të nevojave të bannorëve, kopshtet sigurojnë raport të përshtatshëm ndërmjet ndërtesave, dhe hapësirave në shtrirjet e ndërtesave të banimit. Në zhvillimet intensive, rrugët që kanë karakter urban kërkojnë të plotësohen me një hapësirë private dhe të qetë. Ndërkaq, në zhvillimet me intenzitet më të ulët, kopshtet private i ndajnë shtëpitë dhe mundësojnë zhvillimin e karakterit peizazhor. Në shemat plotësimit me ndërtesa të reja madhësia e kopshteve do të varet nga forma kopshteve të zhvillimeve ekzistuese.

Prandaj, kopshtet duhet të sigurojnë hapësirë të përshtatshme si për banim ashtu edhe për karakterin e përgjithshëm të asaj hapësire. Kërkesat planifikuese për shtrirje të hapësirave private ndryshojnë varësisht nga lokacioni dhe intenziteti i zhvillimit të paramenduar. Për zhvillimet në Zonën Qendrore Orientimore, kriteriumet mundësojnë zhvillim me intenzitet më të lartë, ndërkaq për Zonat Urbane dhe Vendbanimet e Definuar, kriteriumet synojnë hapësirë private intime më gjeroze që ndërlidhet drejtpërdrejt me madhësinë e ndërtesës. Në raste të vecanta, kriteriumet janë fleksibile në mënyrë që të mundësohet shfrytëzim optimal i lokacionit.

**TABELA -1-
MADHËSIA E KOPSHTEVE**

	Tërësia Qëndrore Orientuese	Tërësitë Qarkore Orientuese
Shtëpitë me kopsht		Madhësia minimale e kopshtit varet nga kriteriumi I intimitetit dhe vizurave Madhësia maksimale: e barabartë me madhësinë e sipërfaqes së përdhësës së shtëpisë Të gjitha kopshtet duhet të përfshijnë zonë private min. 10 m ²
Shtëpitë me kopsht të përbashkët	<i>E përcaktuar sipas kriterëve të dhëna në shtojcën 1 dhe orientimeve të këtij plani (shif kapitullin 5 "Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore)</i>	Zona private min. 10m ² , plus min. 25m ² . për shtëpitë me kopsht të përbashkët
Banesat në etazhe mbi përdhësë		Shfrytëzimi I hapësirave private të përbashkëta me sipërfaqe min. 200m ² dhe/ose balkon me së paku 3m ² .

Rastet e veçanta:

- Kur banesat janë në fqinjësi me zonë të rëndësishme të hapësirës publike, qasja në këtë hapësirë mund ta zëvendësojë hapësirën e përbashkët.
- Kur zhvillimet plotësuese e restaurojnë formën urbane, ndodh që kopshtet të jenë më të vogla ose më të mëdha në mënyrë që ta përmbushin atë rol.
- Në lokacionet me pengesa fizike ku zhvillimet janë të nevojshme për qëllime të interesit publik, prioritet do të kenë hapësirat publike të sigurta dhe atraktive, në krahasim me madhësitë e kopshteve.
- Njësitë për jetesë-punë: sipërfaqja e kopshtit duhet të jetë e barabartë me sipërfaqen e dyshemesë së objektit të banimit, por sipërfaqja e jashtme mund të ketë destinim të dyfishtë, ndoshta edhe për deponim të elementeve komerciale të kontrolluar përmes kushteve planifikuese.
- Shtëpitë strehuese dhe ato me kërkesa speciale – kualiteti I hapësirës private do të vlerësohet varësiht nga kërkesat e banorëve.

**TABELA - 2 –
INTIMITETI DHE
DISTANCAT E VIZURAVE**

	DISTANCA MINIMALE SHPINË-MË - SHPINË	DISTANCA MINIMALE NË MES TË ANËS SË PRAPME TË NDËRTESES DHE KUFIRIT EKZISTUES TË NDOJË PRONE
Ndërtesat 2 katëshe që qëndrojnë përballë njëra tjetrës	25 m	15 m
3 ose më shumë kate ku ana e prapme qëndron përballë dhomave të fjetjes	35 m	25 m
Ndërtesat nën kënd 30 shkallë	15 m midis këndeve më të afërta	
Ndërtesa dhe kufiri i ndonjë pronë nën kënd 30 shkallë		1m- 15m nga këndi më i afërt

Rastet e veçanta:

- Kur zhvillimet plotësuese e restaurojnë formën urbane, Intimitet më i vogël si dhe distanca më të vogla të vizurave mund të jenë të pranueshme nëse dritaret dizajnohen ashtu që që të mos përballen drejtpërdrejt mes veti.
- Kur ndërtesat janë në fqinjësi me destinime jorezidenciale, ato mund të kenë distanca më të vogla në mes të kufijve të prapme përderisa vizurat e përparme janë të mira
- Njësitë e veçanta kanë zonë private më të madhe dhe/ose vizura shumë të mira.

SHËNIMET SHPJEGUESE

Zona e kopshtit	Përfshin të gjitha hapësirat e jashtme brenda parcelës së ndërtesës
Zona private	Zona e jashtme plotësisht private është e nevojshme për cdo banim të ri. Kjo nënkupton hapësirën në kuadër të një kopshti të madh ose balkonit. Kërkoheq që të jetë e mbyllur (pa mundësi të vëzhgimit nga jashtë) dhe preferohet që të jetë e eksponuar ndaj rrezeve të diellit
Madhësia e kopshti në raport me sipërfaqen e ndërtesës	kjo nënkupton sipërfaqen e përgjithshme: sipërfaqen e secilës etazhë përfshirë muret e brendshme dhe të jashtme, me përjashtim të garazhave. Një gjë e tillë mundëson që kopshtet të jenë në raport të drejtë me madhësinë e ndërtesës, dhe kështu, operon si standard maksimal në Zonën Qëndrore Orientimore dhe si standard minimal jashtë kësaj zone
Shtëpitë	kriteriumet bazohen në shtëpitë në varg apo në kaskada dhe si të tilla mundësojnë shfrytëzimin e kopshteve të përbashkëta në zona qëndrore. Shtëpitë e vecanta trajtohen si të vecanta nga kriteriumi I madhësisë në raport me sipërfaqen e dyshemesë. Kopshtet në shtëpitë e vecanta gjithashtu bëjnë ndarjen adekuate midis shtëpive, përmes mbjelljes së drunjëve si kërkesë që del vendosje të karakterit peizazhor
Kopshtet e përbashkëta	duhet të jenë private dhe të kenë qasje të mirë vetëm për banorët që i shfrytëzojnë ato. Kopshti I përbashkët duhet të jetë I ngjitur për ndërtesën që e shfrytëzon atë
Intimiteti minimal dhe distancat e vizurave	hapësira e në dispozicion për kopshte të pasme dhe për parkingje përcaktohet direct nga hapësira e nevojshme ndërmjet ndërtesave . Distanca prej 25m është minimumi I pranueshëm për ndërtesa dykatëshe dritaret e të cilave qëndrojnë ballë për ballë. Për ndërtesa më të larta kërkoheq hapësirë e pasme më e madhe . Këto distanca minimale mund të jenë më të relaksuara nëse dritaret kanë dizajn të vecantë ose nëse intervenohet me mure-pëlhura për t'el mbrojtur kështu intimitetin dhe vizurat e mira njëkohësisht

Shtojca 5

KLASËT E DESTINIMEVE në kuadër të planifikimit të qytetit

KLASËT	SHFRYTËZIMI PËR QËLLIM KRYESOR APO PRIMAR
A1 Dyqanet e hapura për publik	<ul style="list-style-type: none"> a) Shitja e të mirave me përjashtim të ushqimeve të ngrohta b) zyra postale c) agjencionet turistike d) kiosqet për shitjen e sendviqueve dhe ushqimeve të ftohta e) sallon ondulimi (frizer) f) menaxhimi i funeraleve g) prezentimi I të mirave për shitje h) huazimi /marja me qira e të mirave shtëpiake ose personale i) lajra/pastrimi I rrobave/pëlhurave, pastrimi kimik j) huazimi /marja e të mirave për larje, pastrim dhe servisim
A2 Shërbimet profesionale dhe Financiare	<ul style="list-style-type: none"> a) shërbimet financiare b) Shërbimet profesionale (me përjashtim të shërbimeve shëndetësore ose mjekësore) c) Shërbime tjera (përfshirë destinimn e qendrave për baste (lotari) të përshtatshme për zonë të shoppingut
A3 Ushqimi dhe pijet	Shitja e ushqimit ose pijeve për konsumim në hapësirë ose të ushqimit të ngrohtë për konsumim jashtë hapësirës
B1 Biznesi - me kusht që destinimi të mund të ekzistojë në zona banimi pa pasur ndikime negative në kontekstin e mjedisit të pastër dhe ekologjik.	<ul style="list-style-type: none"> (a) zyrat, në përjashtim të destinimeve të cekura në Klasin A2 (b) hulumtimet dhe zhvillimet e produkteve apo proceseve (c) Të gjitha proceset industriale
B2 Industri e Përgjithshme	Proceset industriale me përjashtim të atyre të cekura në klasët B1 ose B4-B7.
B4 Industria speciale e Grupit B	<ul style="list-style-type: none"> (a) Shkrirja, kalcifikimi, nxjerrja e xeheve, mineraleve, koncentrateve ose materialve të papërpunuara. (b) Konvertimi, rafinimi, ringrohje, kalitja, ngurtësimi, shkrirja, farkimi apo flakërmimi I metaleve ose legurave (c) Përfitimi(rikëthimi) I metaleve nga mbeturinat, zgjyra apo hiri (e) pastrimi I skorjeve ose trajtimi I metaleve në acid (f) galvanizimi I kromit

KLASËT	SHFRYTËZIMI PËR QËLLIM KRYESOR APO PRIMAR
B5 Industria speciale e Grupit C	(a) Djegia e tullave ose gypave (b) Djegia e llamarinës ose dolomitit (c) Prodhimi I oksidit të zinkut, cimentos ose gëlqeres (d) Shkumbëzimi, shkatërrimi, ekzaminimi apo nxehta e mineraleve ose baltës xeherore (e) Procesimi I hirit ose nxehtëisë nga karburantet e pulverizuara (f) prodhimi I karbonateve të gëlqeres ose gëlqeres së hidratizuar (g) Prodhimi I pigmenteve joorganike përmes pjekjes ose bluarjes
B6 Industria speciale e Grupit D	(a) Destilimi, rafinimi ose përzierja e vajërave (përvec naftës dhe produkteve të saj, (b) Prodhimi/përdorimi I celulozës ose përdorimi I lustrimeve metalike përmes spërkatjes me presion (përvec në serviset për vetura ku bëhen riparime të vogla, ose aplikimi I pluhurit plastik (c) Zierja e farës së lirit ose derdhja e kaucukut (d) Proceset që involvojnë përdorimin e katranit të ënxehtë ose bitumenit (përvec përdorimit të bitumenit për prodhimin e rripave për kulm në temperatura nën 220°C (e) pjekja e artikujve të emaluar (f) prodhimi i estere alifatike të acideve me sasi të vogël të yndyrës, caramelit, farëravve, etj.(përveç masave plastike) (g) prodhimi i gomës prej mbeturinave (h) prodhimet kimike ku klorfenolet përdoren për proces (i) prodhimi i acetilenit
B7 Industria speciale e Grupit E	Materiet organike (tharja e lëkurës, përpunimi i lëkurës së peshkut, shkrija e përpunimi i dhjemit, përpunimi i eshtrave të shtazëve, etj)
B8 Deponitë ose distribuimi	Deponitë ose si qendra distribuimi
C1 Hotelet dhe hostelet	Hotel, pension, shtëpi për mysafirë ose hostel, ku në cilindo rast nuk ofrohet përkujdesi i nivelit të lartë
C2 Institucionet rezidenciale	Akomodimet rezidenciale dhe kujdesi për njerëzit (të gjithat përveç destinimit të klasit C3) ; Spitalet ose shtëpitë e pleqëve qendrat rezidenciale të trajnimit, në shkolla, në koxhe
C3 Njësi e banimit (rezidenciale)	(a) shtëpitë / banesat familiare (b) për jo më shumë se 6 banorë që jetojnë në një njësi banimi (përfshirë amvisëritë me përkujdesje për banorët)

KLASËT	SHFRYTËZIMI PËR QËLLIM KRYESOR APO PRIMAR
D1 Institucionet jo rezidenciale	(a) shërbimet medikale apo shëndetësore përveç të atyre që ndodhen brenda rezidencës (shtëpisë) së punëtorit shëndetësor (b) përkujdesi ditor (c) për edukim (d) për prezentim të veprave artistike (përveç për qëllim të shitjes dhe qiradhënies) (e) Muzetë (f) Bibliotekat publike, dhomat e leximit (g) Sallat publike, sallat e ekspozitave (h) falëtoret për besimtarë religjiozë
D2 Asambletë (vendtakimet) dhe Argëtimi	a) Kinematë b) Salla e koncerteve c) kazinot dhe sallat e fatit d) Salla të vallëzimit (diskotekat) e) sallat e fiskulturës, pishinat, zonat e rekreimit brenda dhe jashtë, që nuk involvojnë automjete dhe alarme të zjarrit
Të Paklasifikuara	a) Teatri b) Lunaparqet, Parqet e argëtimit (c) Rrobalarëset (d) Pompat e benzinës (e) Sallonet e veturave (f) Zyrat për huazim të veturave dhe për taksit shërbim (g) oborret, deponitë, distribuimi i mbeturinave metalike dhe pjesëve të automjeteve



Plani i Përgjithshëm i Qytetit të Prizrenit është paraparë që të mbulojë periudhën prej vitit 2003-2013.

Fazën e parë në përpilimin e planit të Përgjithshëm e përbën procesi i grumbullimit të të dhënave relevante, vektorizimi i të gjitha planshetave, krijimi i grupeve përkatëse të ekspertëve në bashkëpunim me Drejtoratet pranë KK të Prizrenit, si dhe përpilimi i strategjisë hapsirore. Kjo fazë u finalizua deri në fund të vitit 2002.

Procesi vijues në hartim të Planit filloi në fillim të vitit 2003. Drafti i parë i është dorëzuar KK të Prizrenit në prill 2003, ndërkaq prezentimi publik i këtij drafti u organizua në qershor 2003. Ky plan u finalizua në fund të vitit 2003.

Synim yni gjatë kohës së përpilimit të planit ishte që t'i përmbahemi parimit qenësor të metodologjisë së përzgjedhur bashkëkohore për përpilim të Planit të Përgjithshëm të Qytetit i cili kërkon vlerësimin e qëndrueshmërisë gjatë gjithë fazave të përpilimit të Planit.

Ne konsiderojmë se Plani i Përgjithshëm i Qytetit të Prizrenit në fakt do të ishte më i qëndrueshëm për periudhë kohore 2005-2015, për arsytet e cekura më poshtë:

- se orientimet e këtij Plani do të funksionalizohen pasi të jetë përfunduar hartimi i tij.
- se pasqyra e gjendjes ekzistuese do të kristalizohet pasi të jenë bërë publike të dhënat e regjistrimit të popullatës (i planifikuar në vitin 2004).

Orientimet e këtij plani konsiderohen të jenë udhëzues për zhvillimin e Prizrenit deri dhe pas viti 2015. Me qëllim që baza e këtyre orientimeve të jetë e mbështetur në arsyeshmëri, ne konsiderojmë se orientimet e këtij Plani do të rishqyrtohen, rivlerësohen dhe harmonizohen konform dokumentacionit gjegjës qeveritar për planifikim hapësiror të Kosovës, si dhe të dhënave dalë nga monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së kualitetit të rrethinës njerëzore në Prizren.

Deklarata e Hartuesit të Planit të Përgjithshëm (Gjeneral), Prizren 2003-2013

duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se hartimi i një Plani Gjeneral për qytetin e Prizrenit paraqet një sfidë të madhe, sidomos në aspektin profesional, ...

duke e pasur të njohur faktin se është hera e parë që pas luftës bëhet një projekt i tillë, ...

... i jemi qasur konkurrimit për hartimin e Planit Gjeneral për Qytetin e Prizrenit duke e koncentruar gjithë potencialin tonë profesional, i cili në disa aspekte fillimisht ishte pjesërisht i papërvojë në lëminë e planifikimit të përmasave çfarë kërkohej në këtë Plan. Prandaj strategjia e jonë e punës kërkonte maksimumin e përqëndrimit dhe punë disafish më të madhe se në kushtet e kapaciteteve plotësisht të ngritura.

Themi se puna jonë në këtë projekt ishte shumëfish më e madhe dhe ndonjëherë edhe e mundimshme, dhe këtë e mbështesim në faktin se të dhënat e nevojshme për prezentim (dhe hartim të vizioneve për Prizrenin) ishin ose të vjetëruara ose të pjesërishtme e herë herë mungonin fare. Në fakt, gjatë periudhës së përpilimit të Planit është ndërmarrë vlerësimi i qëndrueshmërisë gjatë gjithë fazave të përpilimit të tij e që e përfshin edhe dimensionin e infrastrukturës ligjore e cila po ndërtohej gjatë kësaj kohe, bashkë me udhëzuesit dhe raportet relevante të dala nga qeveria e Kosovës. Një gjë e tillë ka diktuar që në momente kritike të hartimit të këtij projekti të ndalemi, të presim, të këthehemi pas dhe të bëjmë rishqyrtimin e të gjithë kapitujve dhe orientimeve, dhe t'i harmonizojmë ato me ligjet, udhëzuesit qeveritarë, raportet apo të dhënat më të reja.

Qëllimi ynë është...

... qytetarët të jenë bartësit kryesor të ndërrimeve kapitale, të propozuara me këtë plan dhe të pranuar nga shumica e komunitetit. (gjatë hartimit të këtij projekti në veçanti janë marrë në konsideratë mendimet e prizrenasve në forma të ndryshme)

... që të hartohet një projekt i cili për herë të parë do t'i përmbledhte më vete standardet e aplikueshme ndërkombëtare, për një arsye të vetme dhe madhore: që qytetit të lashtë të Prizrenit t'i këthehet imazhi i humbur vite më parë, dhe njëherit

... që të ofrohet një perspektivë e qëndrueshme për qytetin e Prizrenit – si të pranueshëm ndërkombëtarisht për tërë potencialin të cilin e ka. Se a e kemi arritur këtë, koha e tregon të veten....

Vështirësitë do të paraqiten edhe më tej gjatë implementimit të këtij plani por përqëndrimi dhe vlerat të cilat mendojmë se do t'i ketë ky projekt është pikërisht një vision i ri i zhvillimit të Prizrenit në aspektin urb-arkitektonik, trashëgimor, ekonomik, etj.

Përmes Orientimeve të këtij plani, besojmë t'a bëjmë Prizrenin qytet me një veçori të posaçme në nivel rajonal e më gjerë, me një turizëm, si krah i fuqishëm i zhvillimit të tij të gjithëmbarshtëm.

LITERATURA

- Planin Regjional Hapësinor i Regjionit të Kosovës 1976,
- Planin Regjional Hapësinor të Rafshit të Dukagjinit 1976,
- Planin Regjional Hapësinor i Kosovës, 1979,
- Planin Gjeneral Urbanistik të vitit 1981,
- Autostrada Durrës-Kukës-Prishtinë-Merdarë, 2002
- Ligji i Kosovës mbi Planifikimin Hapësinor, 2003
- Ligji i Kosovës mbi Mbrojtjen e Mjedisit, 2003
- Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, 2002
- Ligji i Kosovës mbi Rrugët, 2003
- Ligji i Kosovës për Telekomunikacionin, 2003
- Projektligji për shëndetësinë në Kosovë
- Projektligji për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore
- Ligji mbi Mbrojtjen e Përmendoreve të Kulturës, 1979
- Elaborati gjeneral i Mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe historike të Prizrenit, 1968 (fletore 1,2 dhe 3)
- Programi investiv i valorizimit të trashëgimisë kulturore të qytetit të Prizrenit, 1970
- Raporti mbi gjendjen ambientale në Kosovë, 2003 – Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH)
- Raporti mbi gjendjen ekzistuese në planifikimin dhe menaxhimin urban në Komunitet e Kosovës, 2002 – MAPH
- Raporti i Punës dhe analizë e përgjithshme krahasuese e gjendjes në edukimin parashkollor-parafillor vitet 2000/01-2001/02, MASHT
- Plani Strategjik, Sektori i Arsimit të Lartë (2003-2007), -MASHT
- Korniza e kurikulit të Ri të Kosovës, 2001 - MASHT
- Strategjia Shëndetësore për Kosovën, 2001- JIAS
- Pasqyrim i gjendjes së MKRSCJR, 2003 - Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
- Statistikat e Punës dhe Punësimit, 2002 - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Rregullorja mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve, 2001

- Orto-fotot nga Enti Kadastral i Kosovës
- Zhvillimi Ekonomik Lokal i Komunës së Prizrenit 2003-2006, KK Prizren
- Profili socio-ekonomik dhe fizik i Prizrenit, 2000, KK Prizren
- Të dhënat nga Enti Statistikor Prizren
- Të dhënat nga Drejtoratet pranë Kuvendit Komunal të Prizrenit
- Të dhënat nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Prizren
- Të dhënat (vitit 2000) nga International Management Group (IMG),
- Propozim-qëndrimi për Zonat dhe Monumentet e Mbrojtura për Komunën e Prizrenit, 2000
- Historijsko-Geografska Analiza Urrbanih Funksoa Prizrena, 1985, Prof.Dr.Esat Haskuka
- Ura, çarshia, xhamia dhe lagjia Arasta, 1999, Prof.Dr.Esat Haskuka
- Prizreni i Lashtë, Morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale, 2001, Muhamet Shukriu
- Prizreni, udhëtim nëpër Kohë, 2002, Selaidin Krasniqi
- Perlat e Etnisë Shqiptare në Prizren, 2002, Shpresë Siqeca
- Antikitetet e Kosovës, vëllimet 1, VI, VII, X, XI, Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Prihtinë, (vitet e botimit 1961, 1972-73)
- Burra Charter, Australia ICOMOS 1988
- International Survey of Architectural Values in the Environment, 1997 (InterSave) Denmark
- Ekstrakt nga artikulli "Prizren-remek delo nepoznatih majstora", ark. Bashkim Fehmiu
- Municipality of Prizren , Development Agenda, 2002 - UNOPS
- How to Deal with Domestic Waste – a Guide Book, YTV Waste Management, Jatehuolto,
- www.sok-kosovo.org
- www.unmikonline.org

si dhe

- të gjitha standardet ndërkombëtare planifikuese të zbatueshme të nivelin komunal,
- të gjitha dispozitat tjera në fuqi, në nivel Evropian.